



INNOVATION FACTORY
www.universitetipolis.edu.al

ALBANIA 2030 MANIFESTO

A NATIONAL SPATIAL DEVELOPMENT VISION
NJË VIZION ZHVILLIMI HAPËSINOR KOMBËTAR

BESNIK ALIAJ, ERANDA JANKU, LEDIO ALLKJA, SOTIR DHAMO

TIRANË 2014



MANIFESTI “SHQIPËRIA 2030”

Një Vizion për Zhvillimin Kombëtar Hapësinor

- Çfarë është planifikimi hapësinor?
- Cilat janë mjetet teknike dhe grafike për të përgatitur një plan hapësinor?
- Cilat janë disa ide dhe inspirime fillestare për të zhvilluar një plan të tillë për Shqipërinë?

“ALBANIA 2030” MANIFESTO


A National Spatial Development Vision

- *What is Spatial Planning?*
- *What are the technical and graphical tools for representing a spatial plan?*
- *What are some of the initial ideas and inspirations for developing such a plan for Albania?*



INNOVATION FACTORY

www.universitetipolis.edu.al



MANIFESTI “SHQIPËRIA 2030”,
Një Vizion për Zhvillimin Kombëtar Hapësinor

- Çfarë është planifikimi hapësinor?
- Cilat janë mjetet teknike-grafike për të përgatitur një plan hapësinor?
- Cilat janë disa ide dhe inspirime fillestare për të zhvilluar një plan të tillë për Shqipërinë?

“ALBANIA 2030” MANIFESTO
A National Spatial Development Vision

- *What is Spatial Planning?*
- *What are the technical-graphical tools for representing a spatial plan?*
- *What are some of the initial ideas and inspirations for developing such a plan for Albania?*

Autorë: B.Aliaj, E.Janku, L.Allkja, S.Dhamo
Këshillimi: D.Shutina, R.Toto, A.Gjika, A.Di Raimo, Sh.Lushaj

© POLIS University
IF, Innovation Factory
IKZH, Research and Development Institute
Co-PLAN, Institute for Habitat Development
Metro_POLIS Architecture Studio

ISBN: 978-9928-175-45-8

Shtypur nga: Shtypshkronja Pegi
Radaktimi: B.Aliaj (Shqip), E.Janku (English)
Layout & Design : E.Janku

Kontakt:
Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar
Kodi Postar 1051, Kutia Postare 2995
Tiranë, Albania
Tel: +355.(0)4.2407420 / +355.(0)4.2407421
Fax: +355. (0)4.2407422
Mob: +355 (0)69.40.88111
Email: contact@universitetipolis.edu.al
Website: www.universitetipolis.edu.al

Tiranë, Nëntor 2014

Mirënjohje / Acknowledgements

Kushtuar gjithë stafit të Institutit Co-PLAN dhe Universitetit POLIS, që gjatë gjithë këtyre viteve, nga 1995 në 2014, kanë vënë energjitë e tyre profesionale e intelektuale në funksion të misionit qytetar për krijimin e një shkolle alternative të planifikimit në Shqipëri, dhe ëndrrës për një vend modern!

To all the people of Co-PLAN Institute and POLIS University, who from 1995 to 2014 have been putting their own professional and intellectual energy to the cause of creating a new alternative planning school in Albania, and to the dream for a better country!

PËRMBAJTJA :

PARATHËNIA.....	10
KAPITULLI 1: Sfondi i Përgjithshëm.....	14
KAPITULLI 2: Bërthama Teorike.....	32
KAPITULLI 3: Gjuha Hartografike dhe Vizualizimi.....	70
KAPITULLI 4: Shqipëria 2030, Një Vizion për Zhvillimin Kombëtar Hapësinor.....	88
KAPITULLI 5: Konkluzione dhe Rekomandime.....	156
REFERENCA.....	167

CONTENT :

PREFACE.....	11
CHAPTER 1: Background.....	15
CHAPTER 2: Theoretical Core.....	33
CHAPTER 3: Cartographic Language and Visualization.....	71
CHAPTER 4: Albania 2030, A National Spatial Development Vision.....	89
CHAPTER 5: Conclusions and Recommendations.....	157
REFERENCES.....	167

Pejzazh Rural, Veriu i Shqipërisë / Rural Landscape, North of Albania, N.Xhufka, 1990



PARATHËNIE

Ky studim inovativ është realizuar në kuadër të njëjësive kërkimore të Universitetit POLIS: “IF, Innovation Factory” dhe “R&DI, Instituti për Kërkim dhe Zhvillim”. Ai tenton të përmbledhë për herë të parë në Shqipëri disa baza teorike, praktike dhe ide konkrete mbi çështje të vizionimit, planifikimit dhe zhvillimit territorial-hapësinor në nivel kombëtar.

Planifikimi i territorit në tërësi është një shkencë relativisht e re edhe për vendet më të zhvilluara, dhe lidhet kryesisht me proceset historike dhe konsekuencat e industrializimit dhe urbanizimit. Ndërsa Planifikimi dhe Politikat Hapësinore të Zhvillimit Kombëtar përfaqësojnë një fushë akoma më të re dhe të paeksploruar edhe për ekonominë më të fuqishme të botës. Por ndërkohë ato përfaqësojnë absolutisht një instrument inovator dhe shumë të fuqishëm për modernizimin e vendit, të performacës së tij ekonomike, dhe të vetë qeverisjes së mirë. Në këtë aspekt, dhe përtej modestisë, ky dokument përfaqëson një moment unikal, dhe pothuaj historik për Shqipërinë, duke konsideruar faktin se edhe autoritetet e vendit kanë kuptuar më në fund rëndësinë e tij dhe kanë ndërmarrë edhe ata nisma konkrete.

Ne shpresojmë që Manifesti “Albania 2030” do të shërbejë si një gur i parë kilometrik për hartimin e këtij plani ambicioz, në bazë edhe të ‘feedback-ut’ që Universiteti POLIS dhe Co-PLAN japin sot në kuptimin metodologjik mbi pikëpyetjet që ekzistojnë se: Çfarë është vetë plani hapësinor? Cilat janë instrumentat e tij vizualizues? Dhe cilat janë disa nga analizat dhe projektionet potenciale e inspiruese për zhvillimin e Shqipërië, për dy dekadat në vijim?

Grupi i autorëve Prof.Dr. Besnik Aliaj, MSc. Eranda Janku, MSc. Ledio Allkja dhe Doc. Sotir Dhamo, me mirënjohje njohin kontributin e mjaft kolegëve të stafit akademik-kërkimor, studentëve diplomantë dhe PhD, etj. Në pamundësi për t’i përmendur të gjithë ne duam të evidentojmë faktin se ky dokument natyrisht reflekton edhe mjaft ide konkluzive dhe mësimë të jashtëzakonshme të nxjerra nga përvoja dhe historia e evoluimit ciklik të bërthamës intelektuale autoktone prej Co-PLAN, tek Universiteti POLIS.

Prof. Dr. Besnik Aliaj
Doc. Sotir Dhamo
MSc. Eranda Janku
MsC. Ledio Allkja

PREFACE

This innovative study was undertaken on the framework of the research units of POLIS University, namely: “IF, Innovation Factory” and “R&DI, Research and Development Institute”. It tries to summarize for the first time in Albania some theoretical-practical bases, and concrete ideas over the issues of spatial-territorial visioning, planning and development.

Territorial planning in general is a relatively new science even for the most developed countries, and is mainly related to the historic processes and consequences of industrialization and urbanization. Meanwhile the field of “National Development Spatial Planning and Policies” represents a newer and unexplored science of application, even for the most powerful economies of the world. Meanwhile it absolutely represents an innovative and very powerful instrument for a country’s modernization, its economic performance, and for the good governance. In this aspect, and beyond modesty, such document represents a unique moment, and almost historic for Albania, considering the fact that authorities finally understood its importance and have already undertaken similar initiatives, which are still under process. We hope that “Albanian 2030” Manifesto will serve as a first milestone for drafting such ambitious plan, based on the ‘feedback’ that POLIS University and Co-PLAN are offering today, at the methodological context, answering some critical questions like: What does spatial planning represent? Which are the visualization instruments that relate to it? And above all which are some potential analysis and inspiring projections for the development of Albania in the coming 2 decades?

The group of authors: Prof.Dr. Besnik Aliaj, MSc. Eranda Janku, MSc. Ledio Allkja and Doc. Sotir Dhamo, recognize with high gratitude the contributions of many colleagues of the academic-research staff, thesis researchers and PhD students, etc. Not being able to mention all of them we intend to underline the fact that such document also reflects many conclusive ideas and extraordinary life experiences extracted from the experience and history of cyclic evolution of the local professional and intellectual core, from Co-PLAN to POLIS University.

Prof. Dr. Besnik Aliaj
Doc. Sotir Dhamo
MSc. Eranda Janku
MsC. Ledio Allkja



KAPITULLI 1: SFONDI I PËRGJITHSHËM

1.1 Hyrje: Planifikimi në Shqipëri

1.1.1 Modelet e Zhvillimit Urban në Periudhën 1945-1990

Nga fillimi i viteve '90-të Shqipëria ishte ende një nga ekonomitë më ekstreme të planifikimit të centralizuar, ku autoritetet ishin praktikisht përgjegjese për çdo gjë dhe kontrollonin të gjitha format e zhvillimeve territoriale. Dy kritere kryesore karakterizonin zhvillimin urban dhe të gjithë procesin dhe strukturën e urbanizimit në vend deri në këtë periudhë: një kombinim mes përqendrimit të zhvillimeve të vendbanimeve dhe qëndrësive së zhvillimit hapësinor (Aliaj 2003). Instrumenti kryesor i planifikimit gjatë kësaj periudhe ishte i ashtuquajti "Plan Rregullator" për zonat urbane të banimit, i cili në vetvete ishte shumë i ngurtë dhe nuk bënte asgjë më shumë, se sa thjesht të tregonte se ku dhe çfarë përdorimi kishte çdo strukturë, me një aplikim shumë të dobët të standardeve arkitektonike. Ndërsa në zonat rurale territori qeverisëj kryesisht nga politikat dhe instrumentat e sektorit të bujqësisë dhe mbrojtjes, kombinuar me transportin publik interurban.

Edhe pse gjatë kësaj periudhe akoma nuk mund të flitej për një plan kombëtar hapësinor të mirëfilltë, ndërhyrjet dhe politikat e ndërmarra nga autoritetet e kohës përfaqësonin deri diku edhe hapat e parë drejt një konceptimi kombëtar të planifikimit hapësinor, edhe pse kjo praktikë u realizua në bazë të parimeve centralizuese nga lartë-poshtë dhe objektivave për përqendrimin e zhvillimit urban. Kjo përjasje shprehej përmes synimeve dhe objektivave të qeverisë për zhvillimin e ekonomisë së vendit të lidhur kryesisht me ngritjen dhe zhvillimin e industrive të reja, të cilat orientonin në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe zhvillimin e territorit. Në themel të kësaj politike ekonomike qëndronte parimi i vendosjes së zonave të reja industriale në afërsi të lëndës së parë, pranë burimeve termo-energjitike, si dhe pranë qendrave të konsumit. Në të shumtën e rasteve kjo praktikë u pasua me themelimin e qyteteve të reja industriale. Në këtë kontekst prioritetet kryesore të qeverisë së kohës ishin: sigurimi i zhvillimit harmonik të industrisë dhe bujqësisë në favor të zhvillimit të përgjithshëm të zonave rurale, si dhe mbështetja e intensifikimit të prodhimit bujqësor. Ndërkohë në këtë periudhë u investua për përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat me rendiment më të ulët: për sa i përket bujqësisë përmes politikave të subvencionimit; ndërsa fuqia punëtore u përqëndrua në rajonet më produktive, në mënyrë që të stimulohej zhvillimi i bujqësisë

CHAPTER 1: BACKGROUND

1.1 Introduction: Planning in Albania

1.1.1 Urban Development Models 1945-1990

From the beginning of the 1990s Albania was one of the most centralized planned economies, where government practically owned everything and controlled all forms of territorial developments. Two main criteria characterized the urban development and the whole process and structure of urbanization in the country: the combination of concentration and centrality (Aliaj, 2003, "Making Cities Work"). The main planning instrument during this period was the so-called "Regulatory Plan" for living urban areas, which was very rigid and did nothing more than showing where and what was the use of each building, with very poor appliance of architectural standards.

Even though an official national spatial plan was still not to be mentioned, the interventions and policies taken by the authorities of the time were somehow the first steps toward a national spatial planning conception. Although, this was done on the basis of top-down principles and centralizing objectives. This was represented by the government's aims on the economy of the country, which was directly related with territorial impact and development. The government's top aims were to set-up and prioritize the development of new industries. Based on this economic policy, the main principle for taking the decisions in relation with the industrial allocation, were by setting up these industries nearby raw-material and thermo-energy sources, as well as near the consumption centers, which in most of the cases was followed with the foundation of new industrial cities. On this context the main priorities of the government of the time were to ensure the harmonious development of industry and agriculture, in favor of the general progress of the countryside, and the support of the intensification of agricultural production. Related to this last intervention, the government aimed to use it as a barrier for preventing urbanization. Authorities neither wanted, neither could afford quick urbanization and its consequences. But this accumulated and exploded after the '80s. Meanwhile, before this period the government aimed to improve the living conditions in less-favored agricultural areas, and to concentrate the resources in well-suited regions of high productivity, in order to keep the population there and occupied with the agricultural activities. But during the '80s the sustainability of such centralized spatial planning system collapsed totally.

(Aliaj, Dharmo, Shutina, 2009). Në këtë mënyrë synohej të parandalohet urbanizimi i shpejtë dhe pasojat e tij, të cilat qeveria e kohës as nuk i donte, e as nuk mund t'i përballonte. Por me fillimin e viteve '80-të qëndrueshmëria e këtij sistemi planifikimi hapësinor ekstremisht të qëndëruar dështoi tërësisht, duke u bërë shtrati ideal i zhvillimeve kaotike që ndodhën me rënien e "Murit të Berlinit", edhe në Shqipëri.

1.1.2 Tranzicioni i Sistemit të Planifikimit gjatë viteve 1991-2014

Në fillimin e viteve '90-të Shqipëria u bë një vend më i hapur dhe më demokratik. Në vrazhdën e ndryshimeve drastike Parlamenti Shqiptar miratoi dy ligje për planifikimin e territorit, të ashtuquajtura "Ligji për Urbanistikën", përkatësisht Ligji Nr.7693 i vitit 1993, dhe Ligji Nr.8405 i vitit 1998, të cilët qenë objekt ndryshimesh e amendimesh të vazhdueshme në vitet e mëvonshme. Të dy këto ligje parashtrojnë rregullat e përgjithshme të zhvillimit urban, të vendndodhjes dhe arkitekturës së objekteve në të gjithë territorin e Shqipërisë, me përjashtim të tokave bujqësore. Por edhe pse ligji i dytë solli disa ndryshime të reja në praktika dhe bëri disa përmirësime në krahasim me atë të mëparshmin, ai sërish nuk arriti të ishte i suksesshëm në lidhje me njohjen e ndryshimeve të ndodhura në territor gjatë dekadës së parë të tranzicionit post-komunist. Për më tepër ky ligj injoronte fenomenin në rritje të ndërtimeve informale dhe problemet që ekzistonin me ndryshimin e sistemit të pronësisë, nga pronë shtetërore në private (Toto, 2010). Ndër të tjera, ligji dështoi edhe në lidhje me vendosjen e objektivave për të adresuar çështjet e zhvillimit dhe planifikimit kombëtar hapsinor.

Megjithatë duhet të theksohet se deri në vitin 2006 planifikimi i territorit në Shqipëri ishte përgjithësisht i bazuar në traditën mesdhetare të ashtuquajtur të "Urbanizmit", me karakter autoritar dhe me kulturën "blueprint" të planifikimit që përfaqësohej nga objektiva me karakter fizik. Në vitin 2006 influencuar nga dy forca kryesore: (i) së pari presioni nga poshtë-lart, i cili vinte nga iniciativat komunitare dhe profesionale lokale, ku mund të veçohet Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, një OJF e inspiruar nga shkolla hollandeze e planifikimit; (ii) dhe së dyti influencat politike të partnerëve ndërkombëtarë në Shqipëri, përgjithësisht të përfaqësuar nga programet e asistencës për zhvillim si Banka Botërore, UNDP, USAID dhe asistencë teknike Austriake e Hollandeze në Shqipëri (Aliaj 2008); autoritetet vendosën të reformojnë thellësisht legjisllacionin e planifikimit urban, për të lëvizur drejt rregullave e principeve më abstrakte të vendimmarrjes në lidhje me territorin, përfshi planifikimin hapësinor e rajonal, dhe politikën kombëtare të planifikimit të territorit në tërësi.

Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe reforma për legjisllacionin për herë të parë artikuloi termin "planifikim hapësinor". Por përveç njohjes së nevojës për hartimin e këtij instrumenti, hartimi real i një "Plani Hapësinor" dhe "Dokumenti Politikash Territoriale" nuk arriti të materializohej. Në vend të tij u draftua një 'dokument politikash', i cili gjithsesi nuk u shndërrua dot kurrë në një dokument ligjor dhe në një plan hapsinor. Për më tepër programet për ngritjen e kapaciteteve nuk e asistuan më tej këtë iniciativë, në mënyrë që të përgatisnin autoritetet vendore dhe rajonale të qeverisjes, të cilët nuk gëzonin asnjë eksperiencë në të këtë drejtim dhe nuk ishin të gatshëm të përballëshin më konceptet e reja të planifikimit hapsinor (Toto, 2012).

Ndërkohë, paralel platformës për reformë mbi planifikimin hapësinor depozituar dhe debatuar në Parlament nga Co-PLAN gjatë 2003-2005, në vitin 2007 u aprovua gjithashtu një tjetër ligj me impakt territorial, ai për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve informale, i ndjekur ky edhe nga procesi për vetë-deklarimin e këtyre ndërtimeve. Në të njëjtën kohë u realizua edhe fotografimi i parë ajror kombëtar në vend dhe u ngrit sistemi i të dhënave bazë sipas sistemit GIS (Sistem Gjeografik i të Dhënave), i cili u shoqërua me ngritjen e regjistrit kombëtar për planifikimin e territorit dhe dhënien e lejeve për zhvillim.

1.1.2 Transition of Planning System 1991-2014

From the beginning of the '90s Albania became a more open and a democratic country, so on the following years the Albanian Parliament approved two planning laws, namely "Laws of Urbanism", No. 7693 (1993) and No. 8405 (1998), which changed many times on the later years. Both these laws presented the general regulations for the development, location and architecture of the structures, based on the land use. Even though the second law made some new changes and improvements compared to the first one, it still didn't succeed on recognizing the recent changes of the territory: the informal developments and the ownership transference, from the state to the private sector, otherwise known as the "privatization process". Therefore, yet, failing to set national spatial planning and development objectives.

However it must be specified that until 2006 territorial planning in Albania was mainly based on the tradition of the so called "Urbanism", with the culture of "blueprint" authoritarian planning, mostly with physical objectives. In 2006 the government decided to reform legislation and move towards more abstract rules and principles of decision making related with spatial planning, regional planning and national policies, influenced by two main forces: (i) the bottom up pressure coming from the local initiatives, mainly represented by Co-Plan, Institute for Habitat Development, a local NGO inspired by the Dutch Planning Schools; (ii) and the political influence of the international partners/donors in Albania, mainly represented by the development assistance programs like World Bank, UNDP and USAID, and the Dutch and Austrian Technical Assistance in Albania. The 2006 Legalization Reform, for the first time articulated the term "Spatial Planning", but despite the recognition of such need, no Spatial Plan was drafted indeed. Instead, a policy document was drafted, but never turned into a legal document and a spatial plan. Furthermore, capacity building programs did not associate the initiative, in order to prepare the un-experienced local/regional governments, which were not yet able and trained to cope with the new spatial concepts (Toto, 2012).

However, despite the new reform law, which was approved by the parliament, in 2007 a law for the formalization and integration of the informal settlements in Albania was approved, also associated by a process of self-declaration of the informal constructions. In addition, a national areal survey, and the respective GIS applications developed into a national system, including a national registry of planning initiatives and development permits.

In 2009 the parliament approved the new "Territorial Planning" law, which was a framework law for emerging spatial planning concepts and development processes, but it was still very detailed on some other aspects, and its implementation was totally depended by the relevant bylaws and specific regulations, which were yet not fully completed. It's also important to recognize that the present Territorial Planning Law is a legal instrument, which brought new spatial development concepts and practices in comparison to the previous laws. These new concepts amongst other include the introduction of new compulsory development instruments such as the detailed local instrument/ plan (Albanian: PDV/ IDV), in order to avoid the plot based development and allow for the transference of development rights, etc. Few changes were made to this law for electoral purposes during 2013, but there still remain the same concepts for the territorial planning law in Albania (Çobo, Toto, 2010).

On 2014 the new government initiated the reform for the administrative and territorial reorganization of the country, which started with proposals to consolidate existing local governments and reorganize regions. So far the government has been on favor of the proposal with the 61 LGU and there is still no decision made regarding the reorganization of the country in regions, although several proposals have been taken in consideration. However it is very important to mention the 5 main priorities that the government has on drafting: (1) the National Plan of Albania; (2) the Plan of the Albanian Riviera; (3) the Durrana Plan; (4) the Plan of the North Region of the Alps of Albania; (5) and to formulate the Program for the Revitalization of the Urban

Në vitin 2009 Parlamenti miratoi ligjin e ri për “Planifikimin e Territorit”, i cili në krahasim me ligjet e mëparshme solli bashkë praktika dhe koncepte të reja për zhvillimin hapësinor. Por ky ligj u konsiderua të ishte një ligj kornizë për disa nga këto koncepte dhe procese që prezantonte, dhe zbatueshmëria e tij varej plotësisht nga aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse (Shutina, 2010). Disa nga këto koncepte të reja ndër të tjera përfshijnë Planet e Detajuara Vendore (ose IDV), të cilat janë të mirëpërcaktuara me ligj; instrumenta të veçanta të kontrollit të zhvillimit; lejet e zhvillimit dhe proceset e lejeve të tjera për punime ndërtimore (Toto, 2010). Më vonë gjatë vitit 2013 për arsye elektorale ky ligj pësoi disa ndryshime, por në thelb vazhdojnë të mbeten të njëjtat koncepte dhe praktika për planifikimin e territorit në Shqipëri. Edhe projekt-ligji më i fundit (2014) në këtë fushë riorganizohet rreth të njëjtave koncepte, prezantuar që gjatë reformës së 2009-s.

Në vitin 2014, autoritetet iniciuan edhe reformën për riorganizimin administrativ dhe territorial të vendit, proces i cili nisi me hedhjen e propozimeve për konsolidimin e njësjive ekzistuese vendore dhe riorganizimin e rajoneve. Gjatë procesit të hartimit të reformës u propozuan disa versione për riorganizimin e njësjive të qeverisjes vendore, ndër të cilët u votua në Parlament nga mazhoranca versioni me 61 njësi të reja, por nuk ka ende asnjë vendim në lidhje me riorganizimin e rajoneve, për të cilët gjithashtu janë hedhur disa propozime mbi tryezë. Përkrah këtyre iniciativave qeveria ka bërë të ditur synimin edhe për disa projekte kryesore planifikimi strategjik në shkallë të madhe, duke përfshirë hartimin e: (1) Planit Kombëtar Hapësinor; (2) Planit të Rivierës Bregdetare në jug të vendit; (3) Planit të Korridorit Durrana për zonën metropolitane Durrës-Tiranë; (4) Planit të Rajonit Verior të Alpeve të Shqipërisë; (5) Programin e Rivalizimit të Qendrave Urbane të qyteteve kryesore të vendit, etj.

Si përfundim, mund të thuhet se pas ndryshimeve të viteve '90-të e deri në ditët e sotme Shqipëria është zhvendosur nga një ekstrem në tjetrin. Kaluam një periudhë, kur vendi ishte një nga ekonomitë më liberale të Europës Lindore, ku praktikisht nuk bëhej fjalë për politika të zhvillimit hapësinor dhe ku autoritetet qeverisëse nuk gëzonin pothuajse fare autoritet dhe kontroll mbi zhvillimin e territorit. Me gjithë përpjekjet për reformimin e legjislatcionit të planifikimit, me përjashtime të vogla pothuajse asgjë nuk pati sukses në zbatim, veçanërisht në nivel rajonal e kombëtar, dhe me gjithë përpjekjet e vazhdueshme gjatë viteve të fundit, qeverisja dhe zhvillimi territorial ende mbeten të keqkuptuara nga profesionistët dhe të keqpërdorura nga politikanët (Aliaj, Dhama, Shutina, 2010).

Centers of the main cities of Albania.

As a conclusion, after the changes of early '90s till now-days, Albania practically shifted to another extreme. It has been one of the most liberal economies of the former Eastern Europe, with practically no spatial planning policies and no control of authorities over the territory. Despite several attempts to reform the planning legislation, almost nothing has been working on the ground level, especially at national scale. In spite of efforts made over the last decades, territorial development and administration still remain misunderstood by professionals and mishandled by politicians. (Aliaj, Dhama, Shutina, 2010). The planning system will continue to go into further changes, because of regular political changes and economic recession. Therefore its instability will remain a main issue for the coming years, until a balance is reached from inertial pressures of transitional developments. However the big urbanization and construction boom, as well as consequences of informality are coming at ease, thanks to the relatively small size of the country and “completion” of urbanization as well.



Kontrasti midis qendrave të kuruara politikisht dhe dramës së strehimit me punë vullnetare / The contrast between the ideologically curated urban centers, and the drama of housing on the peripheral neighborhoods

Natyrisht sistemi i planifikimit do të vazhdojë të pësojë ndryshime për aq kohë sa vendi vijon të kalojë përmes transformimesh të vazhdueshme politike, sociale dhe ekonomike. Ndaj dhe qëndrueshmëria e këtij sistemi do të mbetet një problem në vitet e ardhshme, deri në momentin kur të arrihet një ekuilibër ndaj presioneve të brendshme që vijnë nga evolimi i procesit të zhvillimit. Megjithatë urbanizimi i deritanishëm masiv dhe bumi i ndërtimeve që e pason, po ashtu edhe pasojat e informalitetit po vijnë duke u qetësuar, falë madhësisë së vogël të vendit si dhe falë “konsumimit” të urbanizimit të egër të vendit.

1.1.3 Problemet e Planifikimit dhe Pasojat

Gjatë 20 viteve të fundit i ashtuquajtur “urbanizim” tradicional, në kuptimin e zbatimit strikt të parimeve të “kodeve dhe distancave”, është shndërruar më shumë në një lloj alibije administrative për densifikimin dhe mbi-shfrytëzimin korruptiv të tokës, se sa një mjet për manaxhimin urban. Njërit morën situatën në duart e tyre duke ndërmarrë zgjidhje individualiste dhe të paorganizuar, me qëllimin e vetëm për të shmangur çmimet e larta, si dhe procedurat shpesh herë të korruptuara të administratës publike (Aliaj, Dhamo, Shutina, 2010).


Kjo praktikë nxiti iniciativa kaotike dhe shtyu më tej informalitetin në të gjithë vendin. Si pasojë sot, rreth 90% e bizneseve dhe 80% e pronave vlerësohen të kenë të paktën një shkallë të caktuar ekstra-legaliteti (Qeveria Shqiptare, ILD Peru / UNDP, 2007). Ky fenomen dominues ka rezultuar në probleme serioze mjedisore, në zhvillimin e një sistemi arbitrar të pronësisë, në mbi-densifikimin e qendrave kryesore të banimit, si dhe në humbjen e tokës kryesore bujqësore në vend.

Ndaj edhe përpjekjet e planifikimit hapësinor, sidomos në shkallë urbane kanë dështuar, si pasojë e mungesës së instrumenteve të planifikimit, mungesës së vizionimit rajonal e kombëtar, dhe për më tepër si pasojë e konfuzionit që ekziston midis njësive të nivelve të ndryshme të qeverisë dhe kompetencave që ato gëzojnë. Proçesi radikal i ndryshimeve nëpër të cilin kemi kaluar, stimuloi dhe inkurajoi më tej urbanizimin e pakontrolluar, si dhe ndryshimin e strukturave ekonomike, duke rrezikuar potenciale të pazëvendësueshme hapësinore dhe natyrore të vendit tonë.

1.1.3 Planning problems and consequences

During the last 20 years the so considered traditional “urbanism”, in the sense of strict application of the principles of “codes and distances”, has become more a kind of “administrative alibi” for the corruptive over-exploitation and densification of land, rather than an urban management tool. People have taken matters into their own hands, undertaking extreme individualistic solutions, and aiming to avoid inflated prices and often corrupt procedures of public administration (Aliaj, Dhamo, Shutina, 2010). So in the overall, this led to chaotic initiatives and informality, which spread all over the country. Practically 90% of businesses and 80% of properties are considered to have at least a certain degree of informality (Albanian Government, ILD Peru/ UNDP, 2007). This resulted in serious environmental concerns, development of an arbitrary property system, over-densification of the main living centers, and loss of agricultural land.

Therefore, efforts of spatial planning, especially at the urban scale have been failing, among others, because of the lack of planning instruments and lack of national/ regional visioning, as well as confusion among different ministries over such competency. Such a radical process of changes has been promoting further urbanization and displacement/changes of economic structures, while threatening irreplaceable spatial and natural potentials of the country.



1.1.4 Realitetet e Reja Territoriale dhe Sfidat

Në këto kushte, në prag të anëtarësimit të saj në BE Shqipëria u përball me një realitet të ri territorial. Sipas të dhënave të fundit të Censurit të Popullsisë dhe Banesave (INSTAT 2011), rajonet më periferike në veri dhe në jug të Shqipërisë janë zonat me përqindjen më të lartë të popullsisë së braktisur, ndërsa ultësira perëndimore që përkon në pjesën më të madhe me zonën metropolitane dhe më të zhvilluar të vendit, edhe pse ka qenë zona më dinamike në lidhje me rritjen ekonomike-urbane, sërish nuk ka arritur të ruajë një intensitet të qëndrueshëm të rritjes së kësaj popullsie. Ndërkohë që popullsia në këto zona ka pësuar një trefishim gjatë 10 vjeçarit të parë, gjatë dekadës së fundit, zhvillimi i tokës është dyfishuar pa iu siguruar infrastruktura e duhur fizike dhe sociale, duke krijuar kështu një model urban problematik (Aliaj, Dhamo, Shutina, 2010). Kjo në anën tjetër ka dëmtuar zhvillimin e ardhshëm të vendit, duke vënë në rrezik potencialet e pazëvendësueshme bujqësore, turistike dhe energjitike. (Aliaj, 2008).

Për më tepër, më shumë se 2 dekada pas ndryshimeve sociale dhe politike të pas viteve '90-të, administrata shqiptare akoma nuk ka arritur të krijojë dhe aprovojë një vizion kombëtar hapësinor për vendin, pa përmendur këtu edhe mungesën e kapaciteteve profesionale për hartimin e metodologjisë së hartimit të këtij vizioni strategjik si dhe materializimit të tij grafik për një komunikim transparent publik. Kjo si pasojë ka dëmtuar rritjen ekonomike dhe prosperitetin në vend. Gjendja është rënduar akoma më shumë edhe nga dështimi i autoriteteve për të krijuar një sistem të qëndrueshëm kombëtar të regjistrimit të pronësisë dhe të kthimit të pronave historike, probleme këto të trashëguara nga e kaluara. Autoritetet duhet të inkurajojnë kapacitetet autoktone shqiptare të hartojnë politika të kuptueshme politikisht, dhe të përkthyer në materiale të qarta vizualizuese teknike publike, në mënyrë që ato të kuptohen më lehtë nga institucionet dhe audienca e synuar, për të lehtësuar sidomos procesin e zbatimit të tyre.

Deri tanimë pak-kush ka kontribuar në këto aspekte, ndaj është shumë e rëndësishme që të punohet në të dy drejtimet: hartimin e instrumentave dhe politikave të vizionimit, dhe identifikimin e teknikave dhe instrumentave të vizualizimit të këtyre politikave. Kjo përfshin përdorimin shkencor të bazës statistikore, duke i shtuar kësaj të fundit në mënyrë shumë konstruktive një "dozë krijuese", në mënyrë që të realizohet siç duhet analizimi dhe ngritja e propozimeve inspiruese, si dhe sintetizimi i skenareve të mundshme për realizim lidhur me zhvillimin ekonomik, social, mjedisor dhe hapësinor të vendit.

Si përfundim pavarësisht faktit se Shqipëria ka hyrë në një proces ndryshimi rrënjësor dhe të shpejtë, dhe pavarësisht se momentalisht kemi të bëjmë me një kombinim problematikash të trashëguara ndër vite, arsyeja kryesore që ka vënë në rrezik zhvillimin e qëndrueshëm të vendit ka qenë pikërisht mungesa e planeve dhe politikave kombëtare për zhvillimin hapësinor territorial. Kjo vjen si rezultat i mungesës së të kuptuarit të rëndësisë së çështjes në nivelet më të larta politike e vendimmarrëse, si dhe nga mungesa e kapaciteteve profesionale në institucionet e specializuara dhe përgjegjëse. Në këto kushte vlen të theksohet se është tejet e rëndësishme dhe urgjente të bëhet një kapërcim kualitativ e strategjik në këtë aspekt. Draftimi dhe zbatimi i një plani hapësinor kombëtar duhet konsideruar si hapi i ardhshëm strategjik, për një vizion të unifikuar zhvillimi për Shqipërinë, duke plotësuar kështu edhe kushtet për aderimin tonë në familjen Europiane.

1.1.4 New Territorial Realities and Challenges

On these conditions, Albania met with a new reality over its territory at the brink of EU accession. According to the latest INSTAT, Population and Housing Census of 2011, peripheral regions in the north and south of Albania have been nearly abandoned, while the central and western ones, although have been more dynamic on the urban growth perspective, they still have not kept pace with population growth. Whereas the population has tripled in the capital region, and developed land has doubled without proper physical and social infrastructure, thereby creating a problematic urban model (Aliaj, Dhamo, Shutina, 2010). This in return harms future development of the country, especially high expectations on tourism, agriculture and energy developments (Aliaj, 2008).

On top of that, more than 2 decades after the social-political changes of early '90-s, Albanian administration has not been able yet to develop and approve a spatial vision at the national scale, not mentioning the total lack of professional capacities on the way this vision must develop and be visually represented. This consequently harms economic growth and prosperity and is worsened by the failure of authorities on establishing a stable property registration system, and fair property restitution inherited by the past. Authorities need to also learn how to formulate understandable policies and translate them properly into policy and cartographic representations, in order to ease their implementation and easily address them to their aimed institutions and audience.

So far no one has been contributing to these aspects, so it's crucial to work on both directions: the instruments of visioning, and techniques of visualizing. This includes the use of statistical basis, with a constructive "dose of creativity", in order to synthesize and reach to aimed scenarios and proposals regarding the national economic, environmental and spatial development.

In conclusion despite the fact that Albania has entered a radical and quick process of change, and that there has been a combination of a set of inherited problems, it must be emphasized that the lack of national spatial development policies and plans has been seriously harming the sustainable growth of the country. This is a result of both, lack of understanding at political/ decision-making levels, as well as poor professional capacities at specialized institutions. Therefore the sustainability of future growth and the solution of the accumulated problems need now a qualitative jump at strategic level. The drafting and implementation of a national spatial development plan is considered as the next strategic step to be undertaken by Albania, to adapt to the standards of the EU family.

E.Janku, 2014: Sarandë, Rritje e Paplanifikuar / Saranda, Unplanned Growth





1.2 Qëllimi i këtij dokumenti

Në shumë vende janë autoritet kombëtare ato që ndërmarrin nismën të hartojnë sisteme pro-aktive dhe të integruara të planifikimit hapësinor për të inkurajuar investimet dhe për të lehtësuar zhvillimin e tyre të qëndrueshëm (Alterman 2001, Komisioni Evropian 1997). Dhe në të vërtetë është fakt që pikërisht mungesa e këtyre iniciativave ndër të tjera ka shkaktuar zhvillime kaotike dhe ka nxitur manifestimin e informalitetit e shpërhapjen urbane në shumë nga vendet e Europës Jug-Lindore, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

Frymëzuar nga konteksti shqiptar dhe nevoja për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen, ky dokument ka si qëllim të draftojë një seri konceptesh hapësinore, në ndihmë të hartimit të një vizioni kombëtar hapësinor për zhvillimin territorial. Gjithashtu duke qenë se ndër vite ka qenë pjesërisht problem edhe vizualizimi jo cilësor, ai që ka penguar kuptimin drejtë të politikave të zhvillimit, rrjedhimisht kjo ka impaktuar edhe nivelin e cilësinë e zbatimit të këtyre politikave në territor. Ndaj ky dokument tenton të prezantojë gjithashtu disa udhëzime për të kryer një vizualizim të qartë të politikave hapësinore të zhvillimit të territorit kombëtar.

1.3 Metodologjia

Deri më tani nuk është kryer asnjë punë kërkimore për të adresuar apo mbështetur krijimin e një vizioni kombëtar hapësinor për zhvillimin territorial të Shqipërisë. Ndaj edhe ka qenë shumë e rëndësishme që puna për krijimin e këtij dokumenti të nisej me studimin e disa rasteve, ku zbatimi i politikave të zhvillimit hapësinor është kryer relativisht suksesshëm. Për këtë arsye jemi bazuar në dy metoda kërkimore:

• Faza e Parë e Kërkimit ('Desk Study'):

- Studimi për mbledhjen e të dhënave parësore (kryerja e intervistave, diskutimeve në grup, pjesëmarrja në konferenca etj.);
- Studimi i teorive ndërkombëtare dhe raporteve e materialeve vendore për këtë fushë (të dhënat sekondare);
- Studimi i rasteve krahasimore të së njëjtës natyrë me atë që ky dokument kërkon të krijojë (të dhënat terciare).

Rishikimi i literaturës së specializuar në lidhje me aplikimin e politikave hapësinore në disa nga vendet e Bashkimit Evropian që janë pionere në këtë fushë, dha inute për të kuptuar se si funksionon planifikimi hapësinor, dhe se si mund të aplikohet ai në kontekstin tonë. Në këtë pikë, të kuptuarit e debatit të ngritur për atë që ndodh në shkallën kombëtare, duke kryer intervista me persona kyç, profesionistë dhe vendim-marrës ka qenë tejet i rëndësishëm. Pjesë e rëndësishme e kësaj faze ka qenë edhe pjesëmarrja në konferenca, workshope e takime që lidhen me këtë temë, apo çështje të tjera të ndërlidhura në kuadrin e integritit tonë Evropian.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e punës kërkimore për hartimin e këtij dokumenti ishte edhe analizi i raporteve vendore dhe ndërkombëtare për të identifikuar përpjekjet e bëra në lidhje me zhvillimin hapësinor. Duke ju referuar kontekstit të vendit, krahas literaturës së shkruar, dy burime të rëndësishme informacioni ishin: (i) Instrumentet Statistikore zyrtare nga viti 1990, deri më sot, sidomos dy Censuset e fundit të Popullsisë dhe Banesave; (ii) Hartat dhe Fotografimet Ajrore të para viteve '90-të dhe deri më sot, sidomos fotografimi ajror i vitit 2007 gjatë procesit të legalizimit, i ndërmarrë nga Agjencia ALUIZNI.

1.2 The aim of this document

National governments in some countries, take the lead on creating a proactive and integrative spatial planning system that can encourage investment and facilitate more sustainable development (Alterman, 2001; European Commission, 1997). Indeed it is a common fact for most of the Southeastern European countries (including Albania), that the lack of such initiative results nowadays in sufferings from chaotic growth and informal developments manifested in sprawl of urbanization.

Inspired by the Albanian context and its need for future sustainable development, this document aims to help on drafting a series of national spatial concepts, which will be used to formulate an overall national spatial development vision for the territorial development. Since there is a lack of understanding of planning policies regarding the poor communication and poor cartographic language, which also affects their implementation, the product of this research is also followed by some guidelines on how to make a proper and understandable translation of spatial planning policies into clear cartographic materials and well-visualized documents.

1.3 Methodology

So far, there has been no research work done to address or support the creation of a spatial development vision for Albania, so it was quite essential to first start the work with the observation of other cases, where spatial development policies have been implemented. In order to collect this information, the work was based on two types of research methods:

• First Phase of Research ('Desk Study'):

- *Field study (interviews, group discussions, meetings, conferences, etc. also considered as primary data);*
- *Reading and reviewing of local/international reports and literature (secondary data);*
- *Case studies (tertiary data).*

The revision of the specialized literature on the applied spatial policies in the EU countries and other cases, which are leading on this aspect, gave input on learning how spatial planning works, and how to apply it on our context. At this point, evidencing the progress of such debate on the national scale, by interviewing key-stakeholders, professionals and decision makers was very crucial. An integral part of this phase was also the participation in conferences, workshops and meetings organized in Albania on this subject, or other related issues, on the framework of EU integration of the country and national spatial development policies.

The reading and reviewing of local/international reports and literature, was particularly important for identifying the international efforts made on this subject. Regarding the Albanian situation related with this topic, despite the published written materials, there were also two main local sources that provided the necessary information: (i) Statistical instruments from the official data since the 1990's; especially the 2001 and 2011 Population and Housing Censuses; (ii) Maps and areal images before the '90s and up to date, especially the maps of during late '80-s of the National Institute of Military Topography; and the national areal survey of 2007, during the legalization process undertaken by ALUIZNI.

Two case studies were also taken in consideration: the case of The Netherlands and the one of Italy, as two European examples that have applied Spatial Planning policies. Meanwhile, the research considered also Kosovo and Macedonian examples, as local practices. Inspirations were also drawn from the "America 2050" of

Gjithashtu janë marrë në konsideratë dy raste studimore: (i) rasti i Holandës; (ii) dhe ai i Italisë; si dy shembuj Europianë të zbatimit të politikave të planifikimit hapësinor. Ndërkohë, hulumtimi konsideron gjithashtu praktika rajonale nga vende si Kosova dhe Maqedonia. Më tej është konsideruar edhe vizioni “Europa 2020” dhe “Amerika 2050” hartuar nga Shoqata Amerikane e Planifikimit Rajonal, e cila shërbeu si një mjet inspirimi dhe reference, në lidhje me planifikimin e infrastrukturës kombëtare dhe programin e politikave që lidhet me një sërë çështjes që kanë të bëjnë me transportin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik në shek. XXI.

• Faza e Dytë e Kërkimit (‘Action Research’):

Pas mbledhjes së të dhënave në fazën e parë të kërkimit puna konsistoi në formulimin e një sërë parimesh të rëndësishme të vlefshme për vizionimin në kontekstin shqiptar. Kjo më tej u pasua me draftimin e një serie konceptesh hapësinore, të cilat derivonin nga principet e sipër-përmendura. Rezultatet u sintetizuan në një vizion të vetëm të përgjithshëm hapësinor kombëtar, i cili adreson veçanërisht tre fusha kryesore: (i) çështjet e zhvillimit të territorit, (ii) çështjet e ekonomisë; (iii) dhe ato sociale. Përmes përdorimit të metodave të vizualizimit çdo hap pune është ilustruar dhe pasuruar me bazë kartografike në mënyrë që të jetë sa më i kuptueshëm dhe lehtësisht i aplikueshëm, si nga profesionistët dhe autoritetet qeverisëse, por gjithashtu edhe nga publiku i gjerë e njerëzit e thjeshtë.

Pas përfundimit të produktit të parë të këtij dokumenti u organizuan një seri takimesh dhe prezantimesh me profesionistë të ndryshëm, ekspertë të huaj, kërkues, praktikues dhe studentë, në mënyrë që puna të mund të merte komente konstruktive për përmirësime e pasurime të mëtejshme. Tre faza përfaqësojnë këtë hap të punës:

- Testimi i rezultateve me një panel të ngushtë e të përzgjedhur ekspertësh në një diskutim grupi të fokusuar në formën e ‘këshillit teknik’ (eksperte nga Universiteti Polis, nga Instituti Co-PLAN, dhe Studioja Metro_Polis, në periudhën Maj-Qershor 2014);
- Mbajtja e një workshopi me studentë të programeve PhD dhe MSc të profilit Planifikim Urban, për të testuar kuptueshmërinë e dokumentit të përfunduar dhe për të marrë komente (periudha Shtator 2014);
- Testimi final i produktit të dokumentit me një grup të gjerë ekspertësh dhe praktikuesish (periudha Shtator-Tetor 2014), në kuadër të debateve të Bienales Ndërkombëtare të Arkitekturës në Tiranë: TAW, Tirana Architecture Weeks.

1.4 Kontributi për Teorinë e Fushës dhe Shqipërinë

Kjo punë kërkimore përqipet të ndërtojë përkundrejt vakumit të krijuar në Shqipëri në kushtet e ekonomisë së tregut dhe lirisë së veprimit, si pasojë e mungesës së traditës së hartimit të politikave dhe planeve kombëtare për zhvillimin hapësinor kombëtar. Elementët e mëparshëm, të cilët preknin sado pak aspektet kombëtare të zhvillimit të vendit nuk kanë qenë të qëndrueshme për shkak se janë aplikuar nga sisteme autoritare, duke mos u konsideruar si nevoja të vërteta të vendit dhe shoqërisë. Në këtë mënyrë zhvillimi lokal kombëtar është përballur me konkurrencën gjithnjë në rritje në shkallë globale midis shteteve të ndryshme. Kjo është përkeqësuar më tej me rënien ekonomike për shkak të reçensionit global, dhe humbjen e mjaft aseteve e burimeve kombëtare për shkak të mungesës së zgjidhjeve kreative dhe inovative.

Ndaj edhe puna kërkimore që sjell ky dokument, edhe pse një kontribut modest, është për momentin një produkt unik praktik dhe teorik, me shpresën që të jetë i dobishëm për autoritetet shqiptare gjatë ndërmarrjes së vendimeve në shkallë kombëtare. Ndërkohë vetë propozimi lidhur me vizionin kombëtar hapësinor mund të shërbejë si një laborator edukues mbi shkencën e re të planifikimit hapësinor në Shqipëri e rajon.

Regional Plan Association’s national infrastructure planning and policy program, which provides leadership on a broad range of transportation, sustainability, and economic-development issues impacting America’s growth in the 21st century.

• **Second Phase of Research (‘Action Research’):**

After the output of the first phase of the research process, the work consisted on formulating a set of principles relevant for visioning on the Albanian context. Then the work continued with the drafting of a series of spatial concepts deriving from this set of principles. The results were after synthesized on a general national spatial development vision, which addresses especially three main fields: territorial, economic and social issues. Through the use of visualization methods, each working step was visually illustrated and cartographically represented, in order to be understandable and easy to use, not only by the practitioners and professionals, but also by the mass audience and lay people.

As soon as the first outcome-product was ready, there were organized a series of meetings and workshops with professionals, practitioners and students, in order to test the results, get feedback and improve the material. This consisted on:

- *Testing the results with a selected panel of experts, on a focused group discussion;*
- *A one day workshop organized with students to observe their understanding and reaction to the outcome;*
- *Final testing and discussions with experts and practitioners.*

1.4 Contributions to Theory and Society

This document tries to build against the vacuum that is created in Albania by the lack of tradition of national spatial development policies and plans, on the conditions of market economy and freedom. Previous elements of national visioning have not been sustainable in the long run, due to the fact that they have been imposed by authoritarian means and not understood as a real need of the country and society, facing growing competition among nations at global scale, and the need for creative solution, facing economic recession and waste of national resources.

Therefore this work is a modest practical and theoretical contribution for Albania with a hope that it could be useful also for the Albanian authorities, while undertaking action at such level. In return the Albanian case of national spatial visioning might serve as an interesting learning laboratory for the new science of spatial planning in Europe and beyond.

MetroPolis, 2013: Parku Rajonal Dajt-Adriatik/ Dajti- Adriatic Regional Park



KAPITULLI 2: BËRTHAMA TEORIKE

2.1 Planifikimi Hapësinor

2.1.1 Çfarë është Planifikimi Hapësinor?

Shumica e vendeve sot përballen me probleme që lidhen me mënyrën se si ato janë zhvilluar dhe rritur, sidomos në varësi të karakteristikave si industrializimi, urbanizimi, fragmentarizimi, vështirësitë ekonomike, segregimi social si dhe probleme të tjera të lidhura me këto çështje. Një prej mjeteve dhe aktiviteteve kryesore që ka lidhje me këtë fushë zhvillimi dhe kontekstin përkatës gjithëpërfshirës, e që ka të bëjë me vendimarrjen në vende dhe aktivitete të caktuara është planifikimi hapësinor. Ky i fundit mbetet një disiplinë e re dhe sfiduese, jo vetëm për Shqipërinë por gjithashtu edhe për vendet e tjera Europiane dhe jo-Europiane. Vlerat, principet objektivat e planifikimit hapësinor dhe perspektivat e ardhshme të tij, janë të debatueshme dhe të diskutueshme në të gjithë botën, në pikëpamje të ndryshme.

Por më kryesorja është se njerëzit, kryesisht planifikuesit urbanë dhe profesionistë të tjerë duhet të kuptojnë se çfarë është në të vërtetë planifikimi hapësinor, sa i dobishëm është ai dhe se si mund të aplikohet sukseshëm për të arritur rezultate më të mira jo vetëm në nivel lokal por edhe atë rajonal dhe kombëtar. Kjo sepse planifikimi hapësinor i referohet metodave të përdorura nga sektori publik për të influencuar ndarjen e njerëzve dhe aktiviteteve në hapësira në shkallë të ndryshme (European Commission, 1997), dhe në këtë mënyrë, ai ka një impakt nga një shkallë e vogël në një shkallë më të madhe, nga perspektiva territoriale, në probleme më të thella që impaktojnë territorin. Në këtë pikë, është e rëndësishme të theksohet rëndësia e planifikimit hapësinor si një disiplinë shkencore, një teknikë administrative, dhe si një politikë e zhvilluar si një qasje shumë disiplinare dhe gjithëpërfshirëse (Këshilli Europës, 2013). Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të përmendet se çështje të tjera si përdorimi i tokës, rajonalizimi, transporti dhe planifikimi mjedisor, janë disiplina të tjera profesionale, të cilat përfshijnë dhe e adresojnë planifikimin hapësinor.

Sot mund të thuhet se Planifikimi Hapësinor është një instrument kyç në themelimin e kornizave të qëndrueshme për zhvillimin social, territorial dhe ekonomik brenda dhe midis shteteve (UNECE, 2008). Pra, kjo nënkupton sipërmarrjen për krijimin e një organizimi territorial racional të përdorimeve të tokës, si

CHAPTER 2: THEORETIC CORE


2.1 Spatial Planning

2.1.1 What is Spatial Planning?

It's a fact that most of the countries today are facing severe problems with the way they have developed and grown, characterized by fragmented urbanization, economic difficulties, social segregation, and many other related and consequent problems. As one of the main tools and activities concerned with working on such a comprehensive field and context, relating decision-making to specific locations and activities, spatial planning still remains a new scientific discipline and a challenge, not only for Albania, but also for most of the other European, or non-European countries. Spatial planning values, its principles and objectives, and other prospects for the future, are debated and discussed worldwide, from different perspectives.

But what's crucial, is that people and especially planners and other practitioners, should understand what really spatial planning is, how it is useful and how to contextualize and successfully apply it, for meeting aimed results and better realities, not only locally, but also regionally and nationally. And this because spatial planning refers to methods used by the public sector to influence the future distribution of people and activities in spaces of various scales (European Commission, 1997), and as such, it has an impact from a small scale to a big one, from a territorial perspective, to more deep problem-related issues, that impact these territories. At this point, is also important to emphasize the importance of Spatial Planning as a scientific discipline, an administrative technique and a policy developed as an interdisciplinary and comprehensive approach (Council of Europe, 2013). On the mean time, it's important to mention that land use, regional, transport and environmental planning, are other professional disciplines, which involve and address spatial planning.

As such, spatial planning is a key instrument for establishing long-term, sustainable frameworks for social, territorial and economic development, both within and between countries (UNECE, 2008). According to this, it is undertaken with the aims of creating a more rational territorial organization of land uses and the linkages between them, to balance demands for development, with the need to protect the environment and to achieve social and economic development objectives.



Fushat që adresojnë dhe adresohen nga Planifikimi Hapësinor
Fields that address and are addressed by Spatial Planning

dhe lidhjen midis tyre për të balancuar kërkesat për zhvillim, me nevojën për të mbrojtur mjedisin me synimin për të arritur objektiva zhvillimi sociale dhe ekonomike.

Në vijim mund të themi se planifikimi hapësinor është një instrument planifikimi që ka një funksion rregullues dhe zhvillues. Ai është një mekanizëm rregullator, qeverisës (në nivel lokal, rajonal ose kombëtar) që duhet të japë aprovim për aktivitetet e ndryshme në territor. Planifikimi hapësinor është edhe një mekanizëm zhvillimi që duhet të elaborojë mjetet e zhvillimit për të siguruar shërbime dhe infrastrukturë për të themeluar orientime për zhvillimin urban, për të ruajtur burimet kombëtare në territor, dhe për të krijuar incentiva për investimet, etj (UNECE, 2008).

2.1.2 Rëndësia e Planifikimit Hapësinor

Planifikimi hapësinor është një mjet tepër i rëndësishëm për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të përmirësuar cilësinë e jetesës. Si një qasje ndërdisiplinore dhe gjithpërfshirëse, ai siguron hapësirë për të konsideruar çështjet ekonomike, sociale dhe mjedisore, në një balancë ku çdo komponent ndikon të tjerat, dhe të gjitha sëbashku ndikojnë mënyrën se si ne zhvillojmë territorin. Planifikimi hapësinor është i rëndësishëm për të arritur përfitime ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke krijuar kushte më të qëndrueshme dhe të parashikueshme për investimet dhe zhvillimin, duke siguruar përfitime për komunitetet nga zhvillimi si dhe nga përdorimi i kujdesshëm i tokës dhe burimeve natyrore për zhvillim (UNECE, 2008).

Bazuar tek UNECE*, planifikimi hapësinor përmban tre lloje përfitimi të cilat konsistojnë në çështje ekonomike, sociale dhe mjedisore:

Përfitimet ekonomike të planifikimit hapësinor konsistojnë në marrjen e vendimeve në mënyrë më efçente dhe konsistente, duke promovuar kështu zhvillimin, i cili u përgjigjet nevojave të komuniteteve lokale dhe mbështet cilësitë mjedisore në zonat urbane e rurale, të cilat në vetvete nënkuptojnë më shumë kushte të favorshme për investim dhe zhvillim. Duhet të përmendim gjithashtu se planifikimi hapësinor ndihmon në identifikimin e tokës në zona të caktuara, për t'iu përgjigjur nevojës për zhvillim ekonomik; duke siguruar që kjo tokë është e mirëpozicionuar në lidhje me rrjetin e transportit dhe fuqinë punëtore, duke promovuar rigjenerim dhe rinovim urban e social. Synimi i përgjithshëm i planifikimit hapësinor, parë në këndvështrimin ekonomik, është që të sigurojë më shumë qëndrueshmëri dhe besim për investime.

UNECE- United Nations Economic Commission for Europe

To continue, as a planning instrument Spatial Planning has a regulatory and a development function. As a regulatory mechanism, governments (at local, regional and/or national levels) have to give approval for given activities. As a development mechanism, governments have to elaborate upon development tools for providing services and infrastructure, for establishing directions for urban development, for preserving national resources, and for establishing incentives for investment, etc. (UNECE, 2008).

2.1.2 Importance of Spatial Planning

Spatial Planning is a very important tool for promoting sustainable development and improving quality of life. As an interdisciplinary and comprehensive approach, it provides space for social, economic and environmental consideration, on a balance where each component affects the others, and all together affect the way we develop. Spatial Planning is critical for delivering economic, social and environmental benefits by creating more stable and predictable conditions for investment and development, by securing community benefits from development, and by promoting prudent use of land and natural resources for development (UNECE, 2008).

According to UNECE spatial planning shares three main benefits that consist on the economic, social and environmental approaches:

*The **economic benefits** of Spatial Planning consist on making decisions in a more efficient and consistent way, promoting development, which meets the needs of local communities and supports environmental quality in both urban and rural areas, which means more favorable conditions for investment and development. We should also mention that Spatial Planning helps on identifying land in appropriate locations, to meet the need for economic development; ensuring that this land is well placed in relation to the transport network and the labor force; and also promoting regeneration and renewal. At the very end, the overall goal of Spatial Planning, seen on the economic perspective, is to provide more stability and confidence for investment.*

*The **social benefits** of Spatial Planning start with the consideration of the needs of local communities in policy development, and how spatial planning as a tool improves accessibility, when considering the location of the new developments. Other benefits consist on spatial planning being a promoter of the re-use of vacant and derelict land, particularly where it has a negative impact on quality of life and economic development potential.*

Përfitimet sociale të Planifikimit Hapësinor fillojnë me konsiderimin e nevojave që komunitetet kanë në zhvillimin e politikave humane, dhe se si ky planifikim përmirëson aksesin për njerëzit e bizneset, duke konsideruar pozicionin me efikas të zhvillimeve të reja. Përfitime të tjera konsistojnë edhe në promovimin e ripërdorimit të tokave vakante, vecanërisht atje ku ka një impakt negativ në cilësinë e jetës dhe potencialin e zhvillimit ekonomik.

Për të konkluduar me **përfitimet mjedisore**, përfitimet e planifikimit hapësinor janë të lidhura fort me promovimin e rigjenerimit urban e mjedisor si dhe përdorimin e duhur të tokës, ndërtesave dhe infrastrukturës. Kështu mundësohet ripërdorimi i tokave të zhvilluara më herët, për të minimizuar ndërtimin në zonat e tjera të “shëndetshme”. Përfitime të tjera konsistojnë në konservimin e aseteve të rëndësishme mjedisore, historike e kulturore, si dhe mbrojtjen e zonave për rekreacion dhe pasuri natyrore. Në këtë perspektivë planifikimi hapësinor inkurajon edhe eficientë energjitike në kornizën e zhvillimit dhe siguron që të adresohen rrisqet potenciale mjedisore.

2.1.3 Nivelet e Planifikimit Hapësinor

Planifikimi hapësinor shpërndan role dhe përgjegjësi midis niveleve lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllimin për të siguruar orientim për metoda të përshtatshme vendim-marrjeje, dhe shpesh rezultojnë në krijimin e planeve hapësinore. UNECE nënvizon tri nivele si më poshtë:

Niveli Lokal

Vendim-marrja përshkallëzohet nga niveli lokal në atë rajonal, ndërkohë aplikimi i politikave dhe vendimeve vjen nga lart në nivelin lokal dhe është kjo shkalla në të cilën merren vendimet më së shumti. Të përkthyer në plane të detajuar këto vendime adoptohen në këtë nivel, ku qeveria lokale duhet të bashkëpunojë në përgatitjen e procesit, për të siguruar mbulimin e zonave urbane, si dhe të ndërtojë burime dhe aftësi të mjaftueshme. Partneriteti me autoritetet rajonale është gjithashtu i rëndësishëm sepse i siguron përshtatjen e politikave lokale me strategjitë rajonale.

Niveli Rajonal

Megjithëse rajonet mund të variojnë në madhësi, ato duhet të jenë territore të mëdha me karaktere të njëjta, për të adresuar çështje zhvillimi funksional në mënyrë konsistente. Në shkallën rajonale, qëllimi i planifikimit hapësinor konsiston në interpretimin dhe adoptimin e politikave nacionale dhe prioriteteve në këtë shkallë të caktuar, duke siguruar një plan strategjik të përgjithshëm për të adresuar ndërlidhjet funksionale planifikuese dhe paternat e zhvillimit duke siguruar orientim dhe asistencë për autoritetet lokale për të krijuar instrumente të caktuara planifikimi. Planet hapësinore në nivelin rajonal janë parë edhe si mjete të rëndësishme për të siguruar koherencën dhe integrimin nëpërmjet strategjive të fushave të ndryshme, siç është zhvillimi ekonomik, burimet mjedisore, zhvillim i qëndrueshëm, zhvillim rural, mbrojtja e trashëgimisë e kulturës, dhe zhvillimi i turizmit.

Niveli Kombëtar

Qeveritë kanë për qëllim të krijojnë një kornizë referuese për planifikimin hapësinor, e cila siguron një sistem më proaktiv dhe integruar, me qëllimin për të ndihmuar zhvillimin e qëndrueshëm. Qeveritë zakonisht themelojnë një kornizë të mjeteve të planifikimit dhe procedurave për të orientuar punën dhe për të përcaktuar kompetencat midis nivelit qëndror dhe lokal, duke u siguruar që këto njësi të bashkëpunojnë konform kufijve gjeografikë dhe sektorialë.

To conclude with the **environmental benefits**, Spatial Planning's benefits are strongly related with the promotion of regeneration and the appropriate use of land, buildings and infrastructure, also promoting the use of previously developed (brown-field) land, to minimize the development on green-field lands. Other benefits consist on conserving important environmental, historic and cultural assets, and as well on protecting and enhancing areas for recreation and natural heritage. On this wide environmental perspective, Spatial Planning encourages energy efficiency in the layout and design of development and makes sure to address potential environmental risks.

2.1.3 Levels of Spatial Planning

Spatial planning divides and shares roles and responsibilities between local, regional, national and transnational levels, with the intention of providing guidance for appropriate methods of decision-making, and often results on the creation of spatial plans. As the UNECE indicates, these three levels work as below:

Local Level

Scaling from national to regional levels, the application of policies and decisions comes to the local level, and is at this scale that most of the planning decisions are made. Translated on frameworks or detailed plans, these decisions adopt to this level, where local governments should collaborate on the preparation process, to ensure coverage of contiguous urban areas and to build sufficient resource and skills. Partnerships with regional authorities are also very important, as they ensure conformity of local policies and decisions, with regional strategies.

Regional Level

Although regions may vary in size, they should be large territories of relatively consistent character, in order to address functional spatial development relationships in a consistent manner. On regional scale, the scope of spatial planning consists on interpreting and adapting national policies and priorities on this specific scale, providing an overall strategic plan to address functional planning relationships and development patterns, and providing guidance and assistance to local authorities on the creation of specific local planning instruments. Spatial plans on regional level, are also seen as important tools for ensuring coherence and integration among strategies of different-fields, such as economic development, environmental resources, sustainable development, rural development, heritage, culture and tourism.

National Level

National governments aim to create a reference framework for spatial planning, which provides a more proactive and integrative system, in order to facilitate the sustainable development. These national governments establish a framework of planning tools and procedures to guide the work and determine competences between the regional and local levels, making sure also, that these units cooperate and work in conformity with each other across geographical and sectorial boundaries.

Transnational Level

Another important level, on which Spatial Planning works, is the transnational one, represented by the transnational perspectives. These approaches have grown on importance in spatial planning and territorial development policy at different scales, and it's clearly visible especially through the increase of cross-border and transnational cooperation, within the planning and policy arena between individual countries, in macro-regions and in Europe (ESPON, 2011). This is an imperative also for spatial planning in Albania, because we are

Niveli Ndërkombëtar

Një nivel tjetër i rëndësishëm, në të cilin planifikimi strategjik punon, është ai ndërkombëtar, i cili përfaqësohet nga “perspektivat ndërshtetërore”. Kjo qasje ka rritur rëndësinë e planifikimit hapësinor dhe politikave të zhvillimit të territorit në nivele të ndryshme, dhe është qartësisht më e dukshme në rastet e rritjes së bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar, apo në arenën e politikave të planifikimit nëpërmjet shteteve të ndryshme në rajone të mëdha dhe në Europë (ESPON, 2011).


Kjo është një domosdoshmëri edhe për planifikimin hapësinor në Shqipëri, sepse jemi një komb me një popullsi gjysma e së cilës jeton jashtë kufijve shtetërorë, duke përfshirë shtetet kufitare si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Greqia.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, është se bashkë me dokumentet politike për çdo nivel, del në pah gjithashtu edhe përkthimi grafik i këtyre politikave dhe planeve. Kontekste dhe shtete të ndryshme përfaqësojnë ndryshime në proceset e planifikimit dhe metodologjive të aplikuara, ndryshime të cilat janë të bazuara në nivel planifikimi, në nivel detajesh, si dhe në ndryshimet e metodave të vizualizimit.

Këto diferenca tregojnë gjithashtu se si kuptohet dhe kryhet planifikimi në sisteme dhe nivele të ndryshme qeverisjeje, dhe se si kjo më vonë përkthehet nga dokumenta politikash në materiale grafike dhe formash të tjera vizuale, të përdorshme për orientimin dhe implementimin në nivele të ndryshme planifikimi. Duke kaluar nga niveli ndërkombëtar në atë kombëtar dhe lokal, në të njëjtën kohë nënkuptohet edhe kalimin nga harta më të përgjithësuara, në harta dhe grafika më të detajuara. Është shumë e rëndësishme për të kuptuar se si duhet të bëhet ky kalim, dhe se si të krijohen materiale grafike të kuptueshme, me qëllim për t'i bërë ato më të përdorshme në çdo nivel qeverisjeje, nga të gjithë aktorët e përfshirë.

a nation with almost half of population living outside the state borders, including bordering countries like Kosovo, and adjacent communities and minorities in Macedonia, Montenegro and Greece.

Last, but not least, together with the policy documents for each level, come also the graphical representations of these policies and plans. Different contexts and countries represent also differences in the planning processes and methodologies applied, and of course based on each given planning level, the levels of detailing and visualization methods change. This also indicates differences in how planning is understood and conducted in different planning systems and levels, and how this is later translated from policy documents into maps and other visualization means, useful for guidance and implementation at regional and national levels. Shifting from transnational and national levels, into the local level, of course means also shifting from more generalized and abstract maps, into clearer and more detailed maps and graphics. It's very important to understand how this shift should be done, and how to create understandable cartographic materials, in order to make them useful on each governance level and by all the actors and/or practitioners.



*Nivelet e Planifikimit Hapësinor
Spatial Planning Levels*

2.2 Sistemet e Planifikimit në Europë

2.2.1 Katër Klasifikimet Kryesore

Në kontekstin Europian, çdo shtet anëtar menaxhon e rregullon zhvillimin e vetë hapësinor si dhe përdorimin e tokës, me synimin për të arritur objektivat e synuara, nëpërmjet sistemeve respektive rajonale dhe kombëtare, ku sistemet e planifikimit sëbashku me transportin, bujqësinë dhe mjedisin luajnë një rol shumë të rëndësishëm në pikturën e madhe të vendit. Sot kemi një kompleks shembujsh të sistemeve të planifikimit hapësinor në Europë, kështu që është tepër e rëndësishme të kuptojmë se si ato funksionojnë, për të mundur të realizojmë më pas analiza krahasuese. Ndërkohë sistemet hapësinore të planifikimit në familjen Europiane klasifikohen duke u bazuar në dy qasje kryesore: (i) në klasifikimet e sistemit ligjor e administrativ, me të cilat planifikimi operon; (ii) dhe në aplikimin e kriterëve, të inspiruara nga tradita e tipologjive territoriale ideale (Nadin, Stead, disp 172.1/2008). Bazuar në këtë argument, mund të thuhet se sot ekzistojnë katër shkolla të sistemeve të planifikimit që adresojnë klasifikimin në mënyra të ndryshme.

Megjithëse shtete të ndryshme të Europës kanë sisteme të ndryshme planifikimi hapësinor, adaptimi i vazhdueshëm i tyre (duke përfshirë këtu adaptimin e marrëveshjeve ndërkombëtare territoriale me impact për planifikimin hapësinor kombëtar) ka adresuar sfida të përbashkëta për konkureshmërinë globale dhe qëndrueshmërinë lokale. Kjo tendencë në fakt po na çon drejt një konvergjençe të përgjithshme të vetë konceptit dhe shkollës së planifikimit hapësinor.

Midis ndryshimeve të shumta që po ndodhin, disa duken të jenë çështje të natyrës institucionale dhe legjislative, dhe disa të tjera reflektojnë një “transformim më të përgjithshëm të llojit të planifikimit hapësinor” (Nadin, Stead disp 172.1/ 2008). Si rezultat i kësaj, duke konsideruar variacionet që lidhen me kushtet ekonomike, sociale dhe politike ndërmjet shteteve të ndryshme anëtare të BE-së, mund të thuhet se një qasje universale ose një model i vetëm Europian i planifikimit hapësinor në praktikë është gati e pamundur. Por nga ana tjetër, përafrimi sa më i madh i modelit duket si një nevojë për forcimin e elementëve të përbashkët, veçanërisht ata, të cilët janë në qendër të debatit Europian në planifikim “si një metodë, e cila siguron konvergjençën dhe bashkëpunimin midis politikave sektoriale të ndryshme” (Raporti për Politikën e Komunitetit dhe Planifikimit Hapësinor, 1999).

Orientimet e dhëna nga BE për politikën e planifikimit hapësinor, natyrisht konsiderojnë faktin që ato duhet të përshtaten, që t’iu përgjigjen nevojave të çdo shteti. Por është e rëndësishme që kjo përshtatje të konsiderojë dhe procesin kontekstualizues, prandaj autoritetet duhet të themelojnë një vizion të përbashkët dhe orientim konsistent për zhvillimin hapësinor. Kjo duhet të bazohet në përdorimin eficient të burimeve, qeverisjen e mirë, partneritetin publik-privat, si dhe vendimarrje efektive për sa i përket investimeve.

2.2 Spatial Planning Systems in Europe

2.2.1 The 4 main classifications

On the European context, every member state manages and regulates spatial development and land uses for meeting the agreed objectives, through their national and/ or regional planning systems, where the Spatial Planning system, alongside others like transport, agriculture and environment, plays a very important role on the bigger picture. Today we have several examples of the EU spatial planning systems, so it's very important to understand how they work, and to start the work on the basis of a comparative analysis.

To start with, the Spatial Planning systems in the European family are classified according to two main approaches: beginning from the other classifications of the legal and administrative systems within which planning operates; and by seeking to apply a wider set of criteria, producing a similar set of ideal types (Nadin, Stead, disp 172.1/ 2008). Based on these criteria, four main studies of the planning systems address the classification differently.

Although the different countries of the EU might have different spatial planning systems, the continuous adaptation (including the adaptation of the formal national arrangements for planning to address common challenges of global competition and sustainability) is leading to a general convergence. Among the changes, some seem to be detailed institutional and legislative matters, and some others reflect a more general “transformation of the style of spatial planning” (Nadin, Stead, disp 172.1/ 2008).

As a result, also considering the variations in political, cultural and economic conditions between the different member states, a single universal approach, or a single European model of Spatial Planning is not possible. But on the other hand there seems to be a strengthening of the common elements, particularly those that are central to the European debate on planning as “a method of securing convergence and coordination between various sectoral policies (Report on Community Policies and Spatial Planning 1999). Guidelines given for Spatial Planning policies, must be adapted to suit the needs of each country, and it's important that after this adaptation and contextualization processes, authorities should establish a shared vision and consistent direction for spatial development, based on the efficient use of resources, good governance, public-private partnerships, and effective decision making with regards to investments.

Davies et al. (1989)		Common law England		Napoleonic Codes DK, DE, FR, NL		DAVIES, 1989 Don't give specific name to the 2 groups, but contrast England and other systems based on their legal frameworks.
Newman, Thornley (1996)	Nordic DK, FL, SE	British IE, UK	Germanic AT, DE	Napoleonic BE, FR, IT, LU, NL, PT, ES	East Europe	NEWMAN, THOMLEY, 1996 Concentrates on a classification of planning systems according to legal and administrative structures, drawing on five European legal families.
CEC 1997	Comprehensive Integrated AT, DK, FI, DE, NL, SE	Land Use Regulations IE, UK, BE	Regional Economic FR, PT, DE	Urbanism GR, IT, ES, PT		CEC, 1997 Identifies 'ideal types' of planning traditions. Each country may exhibit combinations of ideal types of different degrees.
Farinosi Dasi (2007)	Comprehensive Integrated AT, DK, FI, DE, NL, SE, BG, EE, HU, LV, LT, PL, RO, SL, SV (BE, FR, IE, LU, UK)	Land Use Regulations BE, IE, LU, UK (PT, ES, CY, CZ, MY)	Regional Economic FR, DE, PT, (IE, SE, UK) HU, LV, LT, SK	Urbanism GR, IT, ES, CY, MT		FARINOSI DASI, 2007 The ESPON project took the EU Compendium traditions as a starting point and examined how countries, including the transition states of central and eastern Europe, were moving between them.

Klasifikimi i Familjeve të Planifikimit në Europë
Classification of Planning Families in Europe

2.2.2 Familjet e Planifikimit sipas C.E.C*

Ky klasifikim sjell katër tradita kryesore të planifikimit dhe në këtë rast fjala 'traditë' është përdorur për të theksuar mënyrën sesi forma të ndryshme të planifikimit janë konsoliduar thellësisht në kushtet komplekse historike të çdo vendi. Katër traditat e planifikimit Europian janë lloje ideale të sintezës së kompleksitetit miks e real të fenomenit observues. Ato shërbejnë si masa ndaj realitetit që mund të krahasohet, si përshembull: në një moment të caktuar në kohë dhe hapësirë, një akt planifikimi në një vend të caktuar mund të prezantohet cilësitë e një tradite të vetme ose një kombinim traditash. Në disa raste, vetë kriteri i aplikuar adreson edhe natyrën e sistemeve në operim, por gjithsesi tipologjitë ideale, akoma theksojnë strukturën formale të planifikimit.

Qasja gjithpërfshirëse e integruar

Korrespondon me familjen ligjore të planifikimit në atë zonë gjeografike që ajo mbulon. Vetë emri sugjeron se sistemi i planifikimit kërkon të sigurojë në mënyrë të qartë një masë të integritetit vertikal e horizontal të politikave midis sektorëve dhe juridiksioneve të ndryshme territoriale.

Planifikimi i përdorimit të tokës

Korrespondon me familjen ligjore e administrative 'britanike', dhe ka si qëllim kryesor rregullimin e ndryshimeve të përdorimit të tokës.

Qasja e planifikimit ekonomik rajonal

Ndëthuret me familjet 'napoleonike' dhe 'gjermane' (Francë dhe Gjermani).

Tradita e Urbanizimit

Lidhet me traditën 'napoleonike', por fokusohet vetëm në Europën jugore e mesdhetare.

2.2.2 Planning Families according to C.E.C

This classification brings four main planning traditions and on this case the word tradition is used to emphasize the way that forms of planning are deeply embedded in the complex historical conditions of particular places. The four traditions of spatial planning are ideal types that are a synthesis of the real complex mixture of observable phenomena. They serve as measures against which reality can be compared, such that at a point in time and space, a planning action might exhibit features of more than one ideal type/ tradition. To some extent, the criteria also addresses the nature of systems in operation, though the ideal types still emphasize the formal structure of planning.

The Comprehensive Integrated Approach

Corresponds quite well to the Scandinavian legal family in the geographical area it covers. The name suggests that the planning system explicitly seeks to provide a measure of horizontal and vertical integration of policies across sectors and jurisdictions.

Land Use Planning

Corresponds well to the British legal and administrative family and has the much narrower scope or purpose of regulating land-use changes.

The Regional Economic Planning Approach


Cuts across the Napoleonic and German legal families (France and Germany).

The Urbanism Tradition

Falls within the Napoleonic tradition, but for southern Europe only.

2.2.3 Familjet e Planifikimit sipas ESPON*

Studimi i ESPON nis me klasifikimin e C.E.C në bazë të “tipeve ideale” të familjeve Europiane të planifikimit dhe përpiqet të bëjë një kategorizim të ri, sipas ndryshimeve dhe levizjeve në këto familje planifikimi. Ky studim i jep rëndësi më të madhe ndarjes së kompetencave të lidhura me planifikimin në nivele të qeverisë, me një analizë të mirë të strukturave të shtetit, decentralizimin e kompetencave, veçanërisht të formave të ndryshme të qeverisjeve lokale, rajonale dhe qendrore. Është fakt që tashmë familjet e planifikimit po shpërndajnë shumë informacione e dije në sajë të procesit të europianizimit, duke udhëhequr një proces të shëndetshëm konvergjence edhe në vetë familjet e planifikimit. Gjithashtu është mjaft e rëndësishme të thuhet që megjithëse këto familje planifikimi marrin shumë nga njëra-tjetra, ato sërish mbeten unike dhe me dallime të qarta.




Në të majtë, klasifikimi i familjeve Europiane të planifikimit në 4 tradita të planifikimit hapësinor, bazuar në Kompendium; Në të djathtë, lëvizjet mes stileve të planifikimit hapësinor dhe karakteristikeve të shteteve të reja, brenda familjeve të planifikimit.

On the left, Classification of the EU 15 in the 4 traditions of spatial planning, according to the Compendium; On the right, Movement within the EU 15 between the Styles of spatial planning and characterization of New Member States.

2.2.4 Sistemi Planifikimit Shqiptar përballë Klasifikimeve Europiane

Që prej vitit 2000, kur Shqipëria u njoh zyrtarisht nga Bashkimi Europian si një vend kandidat potencial, vendi ynë nisi negociatat për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim, e cila u arrit në vitin 2006. Megjithëse Shqipëria i përmbushi herët të gjitha kriteret për t'u bërë një vend kandidat, aprovimi zyrtar mbeti pezull gjatë, deri në vitin 2013 për shkak të një politike të paqartë midis dy partive kryesore politike. Edhe pse gjatë kësaj pune kërkimore, ka ndodhur ky evoluim, duhet të jetë e qartë se rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshi edhe Shqipërinë, do të bëhen pjesë e Bashkimit Europian rreth viteve 2020. Siç u përmend edhe më sipër Shqipëria ka një mundësi të perspektivave të zhvillimit dhe planifikimit hapësinor, një cilësi tipike për të gjithë Ballkanin Perëndimor. Madje Shqipëria nuk mund të përcaktojë në mënyrë të qartë, as se cilës nga familjet e planifikimit i përket. Megjithatë duke u bazuar në krahasime relative mund të thuhet që deri në vitin 2006 planifikimi territorial në Shqipëri është bazuar në shkollën e “traditës së urbanizmit”, e cila përgjithësisht konsideron dimensionet e planifikimit fizik e dizajnit urban. Por që prej vitit 2006 dhe në vazhdim, autoritetet e reformuan legjislacionin bazuar në traditën e “integritimit gjithëpërfshirës”, e cila kërkon të krijojë një set të plotë të rregullave dhe principeve abstrakte për planifikimin hapësinor dhe rajonal, rrjedhimisht edhe politikën kombëtare.



DECENTRALIZATION

DECONCENTRATION

Vizualizimi i Koncepteve Decentralizim dhe Dekocentrim / Visualization of the Concepts of Decentralization and Decoconcentration.

2.2.3 Planning Families according to ESPON

The ESPON study starts from the C.E.C classification of “ideal types” and tries to make a new categorization according to the changes and the movements in the EU planning families. It gives more emphasis to the distribution of powers relevant to planning among levels of government with a finer analysis of state structures and the decentralization and devolution of competences, especially the varying forms of regional governance and local powers. There is enough evidence that spatial planning families are sharing a lot of information and knowledge due to Europeanization processes, thus leading to a convergence in planning families as well. But it's also important to say that although they take a lot from each other, they still remain unique

2.2.4 Albanian Planning System versus EU Classifications

Since the 2000 Albania was officially recognized by the EU as a potential candidate country and it started negotiations on a SAA- Stabilization and Association Agreement, which was successfully agreed and signed on 2006. Although Albania has completed all the conditions to become a candidate country, its official approval has been kept pending for the last few years, because of an internal political back-clash between the two main political parties. Although a positive answer is expected during the time this research will be developed, it must be clear that the Western Balkan region, including Albania, are expected to jump into the EU only by 2020.

As it's said above Albania lacks national spatial planning and development perspectives, a feature, which is typical for the whole Western Balkan. As such we can't make a clear definition regarding the planning family, where we might belong. However based on relative comparison it could be said that until the 2006 territorial planning in Albania was based on the school of “Urbanism” tradition, which generally considers the dimensions of physical planning and urban design. But from 2006 and on, authorities reformed the legislation according to the “Comprehensive Integrated” tradition, which seeks to create a complete set of abstract rules and principles for the spatial and regional planning, as well as the respective national policies.

2.3 Raste Studimore

Ky nën-kapitull do të ilustrojë dy traditat e familjeve të planifikimit hapësinor në BE: (i) “rasti holandez”, i cili është konsideruar botërisht si ushtrimi më i avancuar i planifikimit hapësinor në shkallë kombëtare; (ii) dhe “rasti Italian”, si një nga përvojat më të shtresëzuara administrative të një suksesi relativ në kontekstin e traditës mesdhetare. Nëse rasti i parë paraqet një “objektiv të fundëm” për t’u arritur, rasti i dytë është një referencë rajonale më e afërt për Shqipërinë, jo vetëm në kontekstin a hartimit të planeve por edhe të zbatimit.

2.3.1 Rasti Gjithëpërfshirës dhe Integrues i Holandës

Me një sipërfaqe prej rreth 41,864 km² dhe popullsi prej rreth 17 milion njerëz, Holanda përfshin në vetvete 3 territore përbërëse: a) Territori në Europën kontinentale, b) Antilet e Holandës, c) dhe Aruba. Shumica e vendit përbëhet nga ultësirat përgjatë detit, apo tokë e rimarrë prej këtij të fundit, sepse një e katërta e vendit gjendet nën ose në nivelin e detit.

Holanda është e njohur për rajonin “Randstad”, që është një strukturë supra-ubane (konurbacion) përbërë nga qytetet kryesore holandeze si: Amsterdam, Rotterdam, Hagë dhe Utrecht. Randstad mbulon 26% të territorit të vendit, dhe në të jeton 46% e të gjithë popullsisë së tij. Vendimet e planifikimit hapësinor merren në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Vizionet hapësinore e qeveritare, krahinat dhe komunat nuk përshkruajnë vetëm pritshmëritë e zhvillimeve hapësinore, por edhe se si do të drejtohen këto zhvillime dhe si zbatohen ato në çdo nivel.

Qeverisja

Qeveria lokale në Holandë është e përbërë nga 12 provinca dhe 418 komuna, një numër i cili erdhi si rezultat i bashkimit e konsolidimit nga 431 njësi në vitin 2009. Pavarësisht kësaj strukture, Holanda ka edhe lloje të ndryshme të organizmave administrativo-rajonale, që përbëhen nga komuna të shumta të cilat funksionojnë si qytete-rajone. Shteti përqendrohet dhe është përgjegjës për çështjet, të cilat janë me rëndësi strategjike e kombëtare, të tilla si sigurimi dhe përmirësimi i aksesit, qendrueshmëria, etj. “Vizioni

2.3 Case Studies

This sub-chapter will illustrate two traditions of spatial planning families in EU: the Dutch case, which is considered globally as the most advanced exercise of spatial planning at national scale; and the Italian case, as one of the most stratified experiences of relative success for the Mediterranean basin. If the first one can be considered as an “end-objective”, the second one represents the nearest neighboring reference for Albania.

2.3.1 Comprehensive Integrated example of The Netherlands

With a surface of about 41,864 km² and population of approximately 16.74 million people, The Netherlands comprises 3 constituent territories: the territory in continental Europe, the Netherlands, Antilles and Aruba. Most of the country consists of either lowlands along the sea, or reclaimed land, with one-quarter of the country at, or below sea level. The Netherlands is known for the Randstad region, which is a conurbation made up by the Dutch cities of Amsterdam, Rotterdam, The Hague and Utrecht, and it covers 26% of the country, where lives 46% of the whole population. Spatial planning decisions are made at the national, regional and local levels. The spatial visions of the government, provinces and municipalities describe not only the expected spatial developments, but also how these developments will be directed or implemented on each level.

Governance

Local government is comprised of 12 provinces and 418 basic municipalities, a number, which came as a result of merger, decreasing from 431 of 2009. Despite this structure, diverse types of regional administrative organizations composed of multiple municipalities have developed (city-regions). The state focuses and is responsible for issues, which are of national importance, such as providing and improving accessibility. The Spatial Vision on Infrastructure and Spatial Planning represents all these national issues of interest. As for the local level governance, the provinces focus on provincial interest, such as landscape management, urbanization and the preservation of green spaces. All these issues are framed on the Provincial Spatial Visions. But the spatial planning policy and its implementation are shaped at the municipal level, where the municipalities are able to set appropriate regulations based on their knowledge of the local situation. In continuation, land-use plans represent the most important tools in spatial planning, because of their role on setting down, where

Hapësinor për Infrastrukturën dhe Planifikimin Hapësinor” në rastin holandez, përfaqëson të gjitha këto çështje kombëtare me interes strategjik. Ndërkohë qeverisja e nivelit vendor dhe provincat përqendrohen në interesat e nivelit të provincës, të tilla si: menaxhimi i peizazhit, urbanizimi, ruajtja e mjedisit dhe e hapësirave të gjelbëra. Të gjitha këto çështje janë të përshtatura në detaje pastaj në “Vizionet Provinciale Hapësinore” të çdo rajoni. Sidoqoftë politika e planifikimit hapësinor dhe zbatimi i tij formulohen në nivel komunal, ku komunat janë në gjendje për të vendosur rregullat e duhura në bazë të njohjes që ato kanë për situatën vendore, ndërkohë që provincat koordinojnë dhe integrojnë.

Në vazhdim të kësaj praktike, “planet e përdorimit të tokës” paraqesin instrumentin më të rëndësishëm për planifikimin hapësinor, për shkak të rolit të tyre në vendosjen se ku do të ndërtohet, cila do të jetë madhësia e strukturës dhe cili do të jetë përdorimi i saj. Këto plane të shfrytëzimit të tokës vijnë me dy komponentë kryesorë fiks: a) rregullat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me një fushë të caktuar, b) dhe një ilustrim apo hartë të planifikimit që tregon dhe shpjegon zonat e ndryshme.

Sistemi i Planifikimit Hapësinor

Përjekjet holandeze për krijimin e planit hapësinor datojnë që nga viti 1901 me “Aktin e Strehimit”. Për faktin se ky vend është i përbërë dhe i rrethuar nga uji, Holanda ka zbatuar tradicionalisht politika gjithëpërfshirëse kombëtare hapësinore për gjetjen e zgjidhjeve që i shërbejnë gjithë shoqërisë. Shembull tipik është krijimi i sistemit të digave dhe liqeneve pas përmbytjes të vitit 1916, dhe “Plani Delta” pas përmbytjes së vitit 1953. Shembulli tjetër lidhet me faktin se sidomos pas Luftës II Botërore theksi i zhvillimit hapësinor ka qenë mbi rindërtimin e dëmeve të luftës, dhe gjetjen e zgjidhjes në mungesë të strehimit. Ndërkohë që çështjet e problemet kryesore kanë ndryshuar vazhdimisht, që nga viti 1960 qeveria filloi të publikojë politikën e saj hapësinore, prioritet e të cilës gjitashtu kanë evoluuar duke lëvizur nga strehimi drejt temave si: zhvillimi i qendrave të rritjes urbane jashtë zonës metropolitane, dhe politikat urbane të orientuara drejt tregut.

Për këtë arsye në vitin 1965, “Akti i Planifikimit Hapësinor”, i cili trajtonte planifikimin hapësinor dhe atë urban veçmas nga çështjet dhe politikat e strehimit, u bë një dokument ligjor. Ndërkohë nga viti 2006, vendi vendosi theksin tek rajonet mbështetëse, të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik kombëtar, me qëllim rritjen e konkurrencës dhe nxitjen e inovacionit.

Pra sa i përket kompetencave të planifikimit kombëtar, qeveria kombëtare holandeze është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të “planifikimit hapësinor”. Provincat në një farë mënyre vizionojnë “planet rajonale”, të cilat mbulojnë territore e rajone të gjera. Komunat kryejnë “planet strukturore” dhe ato të “përdorimit të tokës” apo “planet e zonimit”, të cilat kërkojnë miratim të provincës. Qeveritë e nivelit më të ulët i përmbahen vendimeve më të rëndësishme të planifikimit kombëtar dhe planeve të provincës-rajonit.

Që pas Luftës II Botërore, politikat hapësinore kombëtare synuan të përforconin “Randstadin”. Për këtë qëllim udhëzuesi i politikave hapësinore kombëtare u ripërgatit katër herë që nga viti 1960 deri më sot. Gjatë viteve ‘60-të qeveria holandeze synonte të kishte thjesht një plan të përgjithshëm kombëtar për vendin. Por ky plan u përball me një krizë të thellë mjedisore në vitet ‘70-të, ndaj për këtë arsye planit hapësinor kombëtar iu shtua “planifikimi i peizazhit”. Gjatë viteve 80-të me thellimin e krizës ekonomike, sistemin e planifikimit në Holandë e përfshiu një fazë revolucionare gjatë së cilës zona metropolitane e Randstadit do të referohej si “Delta-Metropolis”. Kjo njësi e re e madhe do të konsiderohej se përbëhej nga dy zona të mëdha metropolitane: Krahu Verior (Amsterdami e Utrehti) dhe Krahu Jugor (Roterdami e Haga). Të dy krahet përfaqësonin pika të rëndësishme ekonomike: a) Amsterdami si një qendër kulturore e rëndësishme me aeroportin më të madh në vend; b) dhe Roterdami një qendër e rëndësishme industriale me portin më të madh.


construction will take place, what will be built, the size of the structure and its use. These land-use plans come with two main fixed components: the rules and regulations related with a specific area, and an illustration or planning map that indicates and explains the various zones.

Spatial Planning System

In order to avoid this complexity and better communicate the main objectives to the communities and broad public, it is necessary to articulate simple and understandable graphical tools. Despite the differences that exist in the planning traditions, there should be a common ground for the different kinds of visualization and cartographic language. Putting cartographic standards could be a solution to this problem, and the example of the grille chorématique of Roger Brunet, could be a good reference to start drawing images that derive from the planning policies. Drawn images are used to support verbal statements of policies, statistical facts, etc., or they directly express policies (Faludi, 1996a), and through their communicative power and clarity might "contribute more to achieving certain political goals, than legal and financial instruments" (Kunzmann, 1996: 144).

Cartographic representations can be powerful instruments in strategic planning processes, and in communicating the key objectives of the spatial strategy. However, at EU level we must also be aware, that according to Dühr, "despite the potential of cartographic representations in spatial planning, visualization has been difficult and a controversial exercise, because of the different factors rooted in the mentality of different planning traditions, and by the variety of EU member states' experiences and cultures with visualizing". This explains

në planifikimin hapësinor, vizualizimi ka qenë i vështirë dhe një ushtrim i diskutueshëm, për shkak të faktorëve të ndryshëm të rrënjësor në mentalitetin e traditave të ndryshme të planifikimit, dhe nga varieteti i përvojave dhe kulturave të shteteve anëtare në BE, me vizualizimin". . . Kjo shpjegon përse dhe se si shtete të ndryshme përdorin paraqitje simbolike dhe kartografike të ndryshme në procesin e planifikimit hapësinor, dhe se si ai ndikon mbi një proces të përgjithshëm hartëzimi ndërkombëtar. Sidoqoftë, edhe në një kontekst të vetëm kombëtar, rëndësia dhe roli që paraqitet kartografike dhe vizualizimet luajnë është shumë i madh, sidomos kur bëhet fjalë për përkthimin e vizionit dhe objektivave të derivuar për zhvillimin e një shteti.

Kështu, për të ndihmuar përmirësimin e impaktit që vizualizimet kanë, është gjithashtu shumë e rëndësishme futja e paraqitjeve kartografike sa më herët në proces, për të ndihmuar në strukturimin dhe fiksimin e axhendës, në cilindo nga nivelet në të cilët ato paraqiten. Pra, paraqitjet kartografike mund të luajnë një rol shumë më të rëndësishëm, nëse procesi i planifikimit organizohet rreth tyre; dhe me shumë gjasa kështu mund të shmangen edhe shumë keqkuptime (Dühr, 2007).

Ka disa shembuj të mirë të përdorimit të saktë të grafikave, simboleve dhe kartografisë në favor të planifikimit të mirë dhe të zbatueshëm, si metodologjia e hartëzimit mendor ("mental mapping") në BE, apo teoria e "Imazhit të qytetit" të Kevin Lynch në SHBA, e cila edhe pse është e aplikuar në shkallë qyteti, falë metodologjisë mund të jetë një referencë e mirë për të filluar eksperimentimin inovativ edhe në shkallë dhe vende të tjera. Të gjithë këta shembuj mund të shërbejnë si një pikënisje e mirë për të ndërtuar më shumë, por duhet të jemi të vetëdijshëm se për të qenë të suksesshëm, ata kërkojnë kuptim të mentalitetit dhe ndryshim të perceptimit.




Larissa Fassler, Hartëzim Mendor, Berlin
Larissa Fassler, Mental Mapping, Berlin

why and how different countries use symbolic and cartographic representations in spatial planning processes, and how it affects on an overall transnational mapping process. However, even on one single national context, the importance and role that cartographic representations and visualizations play, is quite big when it comes to translating the vision and derived objectives for the development of the country.

So as, to help improving the impact that visualizations have, it's also very important to introduce cartographic representations early in the process, in order to help structuring the discussion and setting the agenda, on any of the levels that they're introduced. Thus, cartographic representations can play a much more powerful role, if the planning process is organized around them, and possibly this way many misunderstandings could be avoided (Dühr, 2007).

There are good examples of the proper use of graphics, symbols and cartography in favor of good and implementable planning, like the mental mapping methodology in EU, or the theory of "The Image of the City" of Kevin Lynch in the USA, which although is applied on a city-scale, thanks to its methodology can be a good reference to start experimenting on other scales as well. All these examples can be a good starting point for building more, but we should be aware that in order to be successful they require understanding of the mind-sets and change of perceptions.



Elementët e një qyteti, Kevin Lynch / rasti i Boston-it.
The elements of a city, Kevin Lynch / the case of Boston.

3.1.2 Vizualizimi për Audienca dhe Kontekste të Ndryshme

Nga studimi dhe analizimi që Dühr bën mbi gjuhën vizuale të planifikimit hapësinor, ne mësojmë se forma dhe stili i paraqitjeve kartografike në planet hapësinore strategjike, tregojnë se për kontekste dhe shtete të ndryshme, ka ndryshime domethënëse në mënyrën se si planifikimi kuptohet dhe administrohet në sisteme të ndryshme, dhe kjo ndikon gjithashtu edhe mbi përmbajtjen dhe faqosjen e hartëzimeve të planit.

Në këtë pikë, është shumë e rëndësishme të kuptohet se krijimi i hartave dhe paraqitjeve kartografike, nuk është një detyrë e lehtë kopjimi dhe aplikimi, nga praktika të ngjashme (apo të ndryshme). Ai kërkon inteligjencë, inovacion, kreativitet, adaptim dhe kontekstualizim, duke konsideruar edhe llojin e politikave mbi të cilat bazohet, apo se ku vihet më shumë theksi. Gjithashtu, ai varet fuqishëm edhe nga niveli i kompleksitetit që trajton, i cili së bashku me faqosjen e përgjithshme të paraqitjeve kartografike të strategjive hapësinore, duhet të jetë një reflektim i audiencës së synuar.

Sipas Dühr, kjo është ajo që Söderström (1996) e ka quajtur “efiçencë e brendshme të paraqitjeve kartografike në planifikim”, e cila nënkupton se nëse strategjia i drejtohet një publiku më të gjerë, duke përfshirë njerëzit e thjeshtë, më shumë vëmendje duhet t’i jepet aspekteve komunikative dhe kompleksitetit të limituar në hartëzimin e vizualizimit e planit.

3.1.3 Sfidat e Vizualizimit në Rastin e Shqipërisë

Duke qenë se kjo është përpjekja e parë për të krijuar një vizion hapësinor kombëtar për Shqipërinë, dhe pavarësisht vështirësisë në krijimin e një baze teorike e të dhënash, është mjaft sfiduese edhe në aspektin e paraqitjes vizuale. Deri më tani, qeveritë vendase janë munduar të vizualizojnë harta dhe diagrama për të paraqitur vizionet dhe objektivat e planeve të tyre lokale, por ato kanë qenë të limituara dhe tepër minimaliste, ndonjëherë edhe konfuzë e të vështira për t’u kuptuar.

Megjithatë, ekziston edhe një numër referencash të mira për përkthimin e dokumenteve politike të këtij lloji, në vizionime grafike, edhe pse ato ofrojnë grafika minimaliste e të thjeshta. Në çdo rast ato janë konsideruar si një pikënisje për atë sa paraqesin vizione të mira e të kuptueshme, dhe vizatime konceptuale mbi territorin e Shqipërisë.

Disa nga këta shembuj janë:

- Skema e zhvillimit për zonën Metropolitane të Shqipërisë (Co-PLAN 2003), dhe e bashkive Elbasan e Fier (Co-plan 2005);
- Plani strategjik nga PADCO, SHBA, 2003, për zhvillimin e Rajonit të Tiranës të Tiranës së Madhe, e cila përpiket të vërë kufij për urbanizimin dhe shpërhapjen e kryeqytetit, dhe paraqet për herë të parë idenë e “rripit të gjelbër” rreth qytetit;
- “Tirana Metropolis Vision - Durana (Durrës-Tirana) regional city concept”, nga Instituti Berlage, Rotterdam, Holandë, 2003;
- Koncepti rajonal-bashkiak i Planit Urban të Bashkisë Tiranë, nga Urban Plan, Zvicër (2007), i cili paraqet konceptin e zhvillimit të përqendruar dhe urbanizimit, në mënyrë që të parandalohet mbishfrytëzimin e territorit dhe shpërhapjen urbane. Plani integron gjithashtu edhe rripin e gjelbër rreth dhe përmes qytetit;
- Vizioni “Universi Tetova” në Maqedoni (U-Polis 2009); si dhe vizionet rajonale-turistike të Universitetit Polis në rajonet e Jugut (2012), Alpeve (2013) të Shqipërisë; si dhe ato në proces në korridoret kulturore-pejzazhistike të: i) Myzeqe-Berat-Skrapar; ii) bregdetit të Rivierës Shqiptare; iii) dhe parkut rajonal Dajti-Adriatik (2014).

3.1.2 Visualizing for different audiences and contexts

From the study and analysis that Dühr makes on the visual language of spatial planning, we learn that the form and style of cartographic representations in strategic spatial plans, show that for different contexts and countries, there are significant differences in how planning is understood and conducted in the different systems, and this also affects the content and layout of the ‘plan maps.’

At this point, it is very important to understand that creating maps and cartographic representations is not an easy task of copy pasting from similar (or other) practices. It takes adaptation and contextualization, depending also on the kind of policies on which a vision is based on, or where it puts more emphasis. It also strongly depends on the level of complexity, which together with the general layout of cartographic representations of spatial strategies should be a reflection of the intended audience. According to Dühr, this is what Söderström (1996) has called the ‘external efficacy’ of cartographic representations in planning, which implies that if the strategy is directed at a wider audience, including lay people, more attention needs to be given to communicative aspects and limited complexity in the ‘plan maps.’ This is a very important argument to convince also the skeptics, on why we need graphical instruments to better articulate and communicate simple and to the point spatial plans.


More technical maps, which deal with the availability and comparability of data, considering spatial analysis maps that have been prepared with GIS software, still continue to be understood and considered by many as unbiased and objective representations of the territory, which represent truthful and factual information (Dühr, 2007). On the meantime, other graphic tools can be used to represent works in progress, which do not necessarily offer certainty, but generalize and simplify the concepts. Here we consider the representation of proposals or ideas for the spatial vision, or spatial concepts on a more abstract way, using sketch-like depictions, schematizations, diagrams, high levels of generalization, or pale colors, mental maps, alternative territorial readings, etc.

3.1.2 The visualization challenges in the case of Albania

Since this is the first attempt to create a national spatial vision for Albania, despite the difficulty on building a theoretical basis, it’s very challenging also on the visual representation perspective. So far, local governments have tried to visualize maps and diagrams to represent their own local plans’ visions and objectives, but they’ve been limited and quite minimalistic, sometimes even confusing and difficult to understand. However, there are few good references for the translation of such policy documents into graphical visioning, and although they offer simple and minimalistic graphics, they still represent good understandable visions and stand for the first conceptual drawings made upon the Albanian territory.

Some of these examples are:

- The 2003 development concept for the Metropolitan area of Albania by Co-PLAN in 2003;
- The 2003 large-scale strategic plan for the development of Tirana Region, which tries to put limits for the urbanization and sprawl of the capital and presents for the very first time the idea of the “green belt” around the city, by PADCO, USA;
- “Tirana Metropolis Vision”-Durrana regional city concept”, Berlage Institute, Rotterdam, Holland, 2003;
- The regional and municipal concept of Tirana Municipal plan of 2007, by Urban Plan, Switzerland, which presents the concept of concentrating development and urbanization in order to prevent overexploitation of territory and urban sprawl. The plan integrates also the green belts around and across the city;
- “Tetovo Univers” in Macedonia (U-Polis, 2009); and other regional-touristic visions of Polis University on the South Region (2012), the Alps of Albania (2013). Also other on-going visioning works based on i) the Albanian Riviera; ii) Myzeqe-Berat-Skrapar Corridor; iii) Regional Park of Dajti-Adriatic (2014).




Prizren

Kosovo

Kaaja


Shkupi



"Universi Tetovë" / "Totovo Univers"
K.Cari, B.Aliaj, S.Dhamo, Polis University, 2009

Planifikimi i mirë nënkupton jo vetëm politika të mira, por edhe të qenurit i aftë që të ofrojë planifikimin me autoritetet e komunitetet, duke përgatitur mjete planifikimi sa më të të kuptueshme dhe të zbatueshme. Në këtë rast përdorimi i përshtatshëm i mjeteve grafike dhe teknikave të vizualizimit luajnë një rol thelbësor. Në këtë aspekt, siç u tha më sipër, një referencë e rëndësishme ndërkombëtare është teoria e "koremove" e Roger Brunet.

Në përfundim, konkluzioni kryesor është se shumë shtete kanë veçori të politikave kombëtare të planifikimit hapësinor, por mënyra se si ato politika janë përkthyer në dokumente kartografike për publikun e gjerë, nuk ka patur bazë të përbashkët. Në vend të kësaj baze të përbashkët, çdo shtet përdor mjete grafike dhe instrumenta vizualizuese totalisht të ndryshme, gjë që i bën iniciativat të tilla të pamundura për t'u krahasuar, apo për të përfituar nga njëra-tjetra. Kjo është qartësisht çështje tradite dhe kulturore. Në të kundërt, kjo ka krijuar shpesh një keqkuptim të madh në ushtrimin e iniciativave të planifikimit hapësinor. Prandaj, investimi në këtë drejtim do t'i ndihmojë të gjithë shtetet e BE-së të përfitojnë nga njëri-tjetri dhe të ndërtojnë një sistem të përbashkët metodash vizualizimi.





Koncept Zhvillimi për Zonën Metropolitane, Co-PLAN, 2003
Development Concept of the Metropolitan Area, Co-PLAN, 2003.



"Universi Tetovë" / "Totovo Univers"
K.Cari, B.Aliaj, S.Dhamo, Polis University, 2009

Good planning means not only good policy, but it also means being able to bring planning near authorities and communities by preparing understandable and implementable planning tools, and in this case the use of appropriate graphical tools and visualization techniques plays quite an important role. On this perspective an important international reference is the theory of "choremes" of Roger Brunet.

The main conclusion is that many countries have features of national spatial planning policies, but the way they are translated into cartographic documents for the broader public has no common ground. Instead, they use totally different graphical tools and visual instruments, which makes such initiatives unable to be compared, or benefit from each other. In contrary this has created a big misperception on the existence of spatial planning initiatives. Therefore investing on this direction will help all the EU countries to benefit from each other and to build a common system of visualization manners.



Majtas: Koncept Rajonal dhe Bashkiak i planit të Bashkisë Tiranë, 2007, Urba Plan.

Left: Regional and Municipal concept of Tirana Municipal plan of 2007, Urba Plan.

Djathtas: Plani strategjik për zhvillimin e rajonit të Tiranës, PADCO, USA, 2003

Right: The large-scale strategic plan for the development of Tirana Region, PADCO, USA, 2003.


3.2 Koremat e Roger Brunet, një Shembull Reference

3.2.1 Koremat - Shkenca e Analizës

Koremat, apo termi i ashtuquajtur “la chorématique”, i propozuar në 1980 nga Roger Brunet, nuk është gjë tjetër veçse shkenca e analizave. Fjala vjen nga fjala greke “choros”, që do të thotë “hapësirë, rajon, shtet” dhe prapashtesa “eme” përcakton elemente dhe strukturë të një sistemi. Korema lejon njohjen e rigorozitetit dhe qëndrueshmërisë në procesin e zbulimit të strukturave hapësinore të fshehura dhe elementët e tyre bazikë. Pa kërkuar një gjuhë shumë të specializuar që është e arritshme vetëm për profesionistët apo të brendshmit, korematika përpiket të vendosë disa rregulla bazë leximi të strukturës hapësinore (Belhedi, 2005). Korematika, siç i referohet Roger Brunet, “përdor imazhe dhe kërkon imagjinatë, por nuk është brenda imagjinare”. Dhe vërtetë, modelet përfundimtare janë të përbëra nga imazhe që paraqesin realitetin. Është pikërisht në këtë pikë, ku shfaqet imagjinata, sepse kompozimi i këtyre imazheve shpesh kërkon pak imagjinatë, për të arritur një përkthim dhe kuptim të mirë të realitetit, të cilin ata paraqesin. Por organizmat hapësinore janë shumë të pasura dhe komplekse, kështu që interpretimi dhe përkthimi i tyre nëpërmjet imazheve mund të variojë nga shenjat apo karakteret e thjeshta, deri në ato më komplekset. Në këtë situatë koremat prezantojnë një praktikë shkencore për përkthimin vizual, e cila ndjek një rregull të caktuar për të sjellë qartësi në atë që duket të jetë një kaos i vërtetë.

Në fjalë të tjera, korema mund të konsiderohet edhe si leximi i formave hapësinore për dekodimin dhe përkthimin e forcave shtytëse social-ekonomike. Ajo përdor modele hapësinore të lidhura me strategjitë hapësinore, në mënyrë që të kuptojë këto strategji dhe efektet e tyre. Kështu, korema shërben për të identifikuar çelësin e mundshëm për të zbrëthyer dhe implementuar një “gramatikë hapësinore” për kuptimin dhe ndërtimin e strukturave hapësinore, dhe më pas përmes këtyre strukturave të përfundojë me strategji hapësinore. Korema në fund të fundit bën të mundur shprehjen e realitet gjeografik, zbulimin dhe prioritizimin e ngjarjeve të mëdha në hapësirë, si dhe prodhimin e organizmave dhe institucioneve hapësinore. Metoda është nevojshëm deduktive dhe ofron mundësinë e verifikimit (Belhedi, 2005).

Duke qenë se korema konsiston në zhvillimin e një modeli të caktuar, është e rëndësishme të shënohet se ky model është i bazuar mbi hipoteza dhe shqyrtime. Ai është rezultati i një zgjedhjeje dhe nuk shpjegon të gjithë realitetin. Përkthimi dhe dizajimi i territorit si një model, kap strukturat që përbëjnë bazën, dhe bazohet në kompozimin dhe mbi një kontekst specifik. Kjo shërben për të theksuar korniza dhe rrjeta, nyje, qendra, boshte, fasada dhe kufij, si dhe kombinimet e tyre që krijojnë të gjithë specifikimin dhe dinamikën e vetë hapësirës. Kështu, kjo shkencë dhe praktikë përfaqëson thjeshtësinë. Ajo fillon në mënyrë të thjeshtë dhe bazike, dhe arrin të krijojë kompleksin dhe kompleksitetin. Interesi i saj qëndron në thjeshtësinë logjistike. Ajo është një mjet, jo një doktrinë dhe bazohet mbi analizën, kuptimin, kërkimin dhe komunikimin. Është një mjet koherent i adaptuar sipas objektit që përfaqëson dhe mbi të cilat ndërton, dhe krijon një gjuhë të përbashkët mes kërkuesve dhe palëve të interesuara, apo grupeve dytësore të interesuara, me qëllim lehtësimin e dialogut.



3.2. The Choremes of Roger Brunet, a reference example

3.2.1 The chorématique, the science of analysis


The choremes, or the so called “la chorématique” term proposed in 1980 by Roger Brunet, is the science of analysis. The term comes from the Greek word “choros”, meaning space, region, country and the suffix “eme” designates element and structure of a system. The chorématique allows introducing rigorosity and consistency in the process of unveiling hidden spatial structures and their basic components. Without seeking a highly specialized language that is accessible only to the professionals or insiders, the chorématique tries to establish some basic reading rules of spatial structures (Belhedi, 2005).

The chorématique, as Roger Brunet refers, “uses images and it requires imagination, but it is not within the imaginary”. Indeed, the resulting models are made of images representing reality and it’s at this point, where the imagination comes along, because the composition of these images often requires a little imagination, in order to make the proper translation and understand the reality, which they represent. But the spatial organizations are very rich and complex, so their interpretation and translation through images might vary from simple signs or characters, into a very complex ones. On this situation the chorématique represents a scientific practice of visual translations, which follows a certain rigorosity to bring order in what appears to be a total chaos.

In other words the chorématique, also considered as the reading of spatial forms for decoding and translating the social driving forces, uses spatial models associated with the spatial strategies, in order to understand these strategies and their effects. The chorématique thus serves to identify the possible key to implement a “spatial grammar” for understanding and building spatial structures, and then through these spatial structures to conclude with social strategies. The chorématique ultimately enables to express the geographic reality, discover and prioritize major events on space, and produce spatial organizations. The method is necessarily deductive and offers the possibility of verification (Belhedi, 2005).

Since the chorématique consists on developing a certain model, it’s important to note that this model is based on hypothesis and check-up. It is the result of a choice and it does not explain the whole reality. The translation and design of the territory as a model grasps the structures that underlie, and it is based on composing on a specific context. This is to highlight frames and meshes, nodes, hubs, axles, fronts and boundaries, processes of diffusion and polarization in their interaction, and their combination, which creates all the specificity and dynamics.

So this science and practice stands for the simplification. It starts simple and basic, and it reaches to build the complex and complexity. Its interest lies in logistical simplicity. It is a tool, not a doctrine and it is based on analysis, understanding, research and communication. It is a coherent tool adapted to the object it represents and upon which it builds, and provides a common language for researchers and related stakeholders, or other interested second party, in order to facilitate the dialogue.



3.2.2 Qasja Metodologjike


Sipas studimit të Belhedi-t, dy janë metodat kryesore që përdorin teorinë e koremës:

a. Rritja e Njohurive të Fituara nga Ekspertiza

Kërkuesi studion hapësirën dhe e përdor njohurinë e tij të akumuluar në mënyrë autodidakte nga eksperiencia e tij, për të kuptuar fenomenin specifik që studion. Pastaj ai elaboron një interpretim të bazuar mbi kombinimin e formave të koremave, duke zëvendësuar parashikueshmërinë e individit në një vizion të përgjithshëm. Modeli i gjeneruar është një produkt referencë. Kjo lejon, për shembull, lokalizimin e njohurive specifike kornizë të përgjithshme. Modeli grafik bëhet operativ kur shpreh qartësisht atë që kërkuesi dëshiron të transmetojë, dhe kur ka të njëjtin kuptim për të gjithë, pra si të shprehet nëpërmjet një gjuhe të përbashkët.

b. Një Metodologji e Gjenezës së Njohurive

Kërkuesi studion një hapësirë, e cila sistematikisht i referohet rrjetit të koremës, të cilën ai e aplikon mbi situatën që është duke studiuar. Ai njih strukturën hapësinore të caktuara dhe bën supozime se ato shfaqin të njëjtat fenomene. Pastaj ai kontrollon vlefshmërinë e hipotezës. Kjo është një metodë e shpejtë për të marrë njohuri, sepse nuk kërkon mbledhjen e eksperiencës së fushës, të përmendur më sipër, por kërkon vetëm aftësinë për të punuar me rrjetin e koremës. Ky është një problem metodologjik: korema duhet të konsiderohet si një element në një grup ndërtimi. Në mënyrë që të jetë e vlefshme ajo duhet të kontrollohet më parë, në mënyrë që struktura hapësinore (modeli grafik i koremës) korrespondon me kuptimin që ne i japim (me fenomenin që përfaqëson).



*Të dy imazhet: Qasja metodologjike e Koremave.
Both images: The methodological approach of the Choremes.*

3.2.2 Methodological Approach

According to the study of Belhedi, there are two main methods that use the choremes theory:

a. Enhancement of knowledge acquired by expertise

The researcher studies the space and uses his knowledge know-how accumulated by his experience to understand the specific phenomenon he observes. Then he elaborates an interpretation based on the combination of the choremes forms, replacing the contingency of the individuality in a general vision. The model generated is a reference product. This allows for example to locate specific knowledge in a general framework. The graph model becomes operative when it expresses clearly what the researcher wants to transmit, and when it has the same meaning to everyone, so as when it is expressed in a common language.

b. A methodology of the genesis of knowledge

The researcher studies a space, which systematically refers to the chorematic grid, that he applies to the situation he is observing. He recognizes certain spatial structure and makes the assumption that they reveal the same phenomena. Then he checks the validity of this hypothesis. This is a quick method to acquire knowledge, because it does not require the prior accumulation of field experience, but it only asks for ability in order to work with the chorématique grid. It is a methodological problem: the chorématique should be considered as an element in a set of construction, and the method of using the chorématique provides us the rules of construction. In order to be valid it should be checked beforehand, so the spatial structure (the graph model of the choremes) corresponds to the meaning that we give to it (the phenomenon is represents).

3.2.3 Figurat e thjeshta të Koremës

Shkenca e Koremës bazohet në forma shumë të thjeshta dhe në një numër të kufizuar rregullash kompozimi. Për Brunet, ekzistojnë shtatë forma bazike që lehtësojnë kuptimin e modeleve që paraqesin koremën:

- Zona (sipërfaqja, madhësia, forma...)
- Pika (vendi, nyja, sheshi, shtëpia, shtylla...)
- Linja (kontakti, këputja, lidhja, korridori kufizues, marrëdhënia, aksi...)
- Rrjedha ose rrjeti (lëvizja dinamike, simetria, intensiteti...)
- Kalimi apo bashkimi (ura, ndërprerja, kryqëzimi, tuneli, vëzhgimi...)
- Polarizimi apo variacioni (fokusimi, dinamika, hierarkia...)
- Gradienti (asimetria, tërheqja, potenciali i shtytjes...)

Ndërkohë, nga këto forma bazike formohen tre shenja bazike nga përdorimi i pikave, linjave dhe sipërfaqeve, ndërsa kompozimi i tyre çon drejt rrjetit. Këto forma modulohen sipas shtatë zonave, duke i dhënë rëndësi matricës së teoremës (3x7), duke çuar drejt formave më të larmishme në realitet: (i) Rrjeta; (ii) Rrjeti koordinativ; (iii) Gravitimi; (iv) Kontakti; (v) Tropizmi; (vi) Dinamika; (vii) Hierarkia.




Tabela e Koremave, Paraqitja e Strukturave
The Choremes Chart, The Representation of the Structures.


3.2.3 The simple figures of the chorématique

The science of the chorématique is based on very simple shapes and a limited number of composition rules. For Brunet, there are seven basic forms that facilitate the understanding of the models that represent the chorématique:

- The area (surface, size, shape...)
- Point (place, knot, square, home, pole...)
- Line (contact, rupture, link, border corridor, Relationship, axis...)
- The flow or network (dynamic movement, symmetry, intensity...)
- The passage or joint (bridge, intersection, junction, tunnel, watch...)
- Polarization or variation (focusing, dynamic, hierarchy...)
- The gradient (asymmetry, attraction, repulsion potential...)


Meanwhile three basic signs are formed by the use of point, line and surface, while their composition leads to the network. These forms are modulated according to seven areas, giving rise to the matrix choremes (3 x 7), leading to the most varied forms in reality: (i) The Mesh; (ii) The Grid; (iii) Gravitation; (iv) Contact; (v) Tropism; (vi) The Dynamic; (vii) The Hierarchy.

Vazhdimi i Tabelës së Koremave, Paraqitja e Proçeseve.
Continuation of the Choremes Chart, The Representation of the Processes.





Co-PLAN / MetroPolis, 2013: Ekosistemi Durrës-Vorë; Koncepti i Zhvillimit Linear Gishtor.
Co-PLAN / MetroPolis, 2013: Durrës-Vorë Ecosystem; Linear Finger Development Concept.



MetroPolis, 2013: Vizionimi i Rajonit Mat-Krujë-Tiranë.
MetroPolis, 2013: Visioning of the Region Mat-Krujë-Tirane.

KAPITULLI 4: ALBANIA 2030, NJË VIZION PËR ZHVILLIMIN KOMBËTAR HAPËSINOR

Zhvillimi i një vizioni kombëtar hapësinor dhe formulimi i koncepteve hapësinore në një kontekst si Shqipëria, ku nuk ka pasur punë kërkimore të mëparshme që adreson këto çështje, është tejet sfiduese. Sidoqoftë është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë fakti që gjatë periudhës së ekonomisë së centralizuar politikat territoriale të aplikuara në vend ishin përgjithësisht të orientuara drejt zhvillimit të bujqësisë, duke thelluar gjithnjë e më shumë politikat antiurbane. Përpos këtij fakti, me rënien e “Murit të Berlinit” dhe gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria e inkurajuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë përmes asistencës teknike-financiare është fokusuar sidomos në përdorimin e potencialeve turistike, bujqësore dhe të burimeve natyrore, si energjia dhe industria minerare. Praktikisht deri në këtë moment janë marë në konsideratë vetëm çështjet të cilat lidhen me zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe turizmit, por edhe këto nuk janë adresuar dhe konsideruar plotësisht si një set potencialesh dhe as nuk janë parë si të ndërlidhura me procesin e urbanizimit.

Në këtë pikë, duhet të theksojmë se vizioni kombëtar hapësinor duhet të adresojë të tilla çështje, duke hartuar politika dhe koncepte përkatëse hapësinore për të mbrojtur dhe përdorur siç duhet potencialet, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm territorial, ekonomik dhe social. Ndaj edhe koncepte si “planifikimi ekologjik” që ofrojnë praktikën e “shabllonit” për një marrëdhënie të re e të shëndetshme mes mjedisit të ndërtuar dhe natyrës, bëhen mjaft të rëndësishme (Ian McHarg, 1969).

Në anën tjetër, është shumë e rëndësishme të vemë në praktikë teorinë krahasuese të planifikimit (Faludi, 1973). Dy rastet studimore që ky kërkim shkencor merr në konsideratë ndihmojnë në bërjen e një vlerësimi mbi atë se si çdo metodë planifikimi ka funksionuar në secilin nga kontekstet, çfarë prioritetesh janë marrë në konsideratë, dhe se si këto prioritete janë përkthyer në veprime konkrete. Në këtë mënyrë e kemi të qartë se si duhet të kryejmë ekzaminimin e situatës aktuale në Shqipëri dhe se si më tej të ngrejmë një set prioritetesh për zhvillimin e vendit. Për të arritur këtë kemi nevojë të:

CHAPTER 4: ALBANIA 2030, A NATIONAL SPATIAL DEVELOPMENT VISION

Developing a national spatial vision and formulating spatial concepts in a context like Albania, on which no previous attempts have been made, and planning has not been working properly, makes it challenging. It's very important to take into the account the fact that during the period of centralized economy, territorial policies aimed mainly at agricultural purposes, while anti-urban policies were regular practices in the country.

On top of such tradition, during the last 2 decades Albania was also pushed by the international partners towards an assistance, which aimed the use of agricultural potentials and natural resources (like energy and mining). Practically at this moment are considered only development issues of agriculture, forestry and tourism, but they have not been fully addressed and considered, as a complete set of potentials. Let alone they were never seen interrelated with the urbanization process.

At this point, the national spatial development vision should address specifically such issues, formulating policies and related spatial concepts for protecting and using them properly, in order to provide territorial, social, economic and sustainable development. At this point working on the basis of “ecological planning” concepts, which offer practical blueprint for a new, healthier relationship between the built environment and nature, is quite essential (Ian McHarg, 1969).

On the other hand, having put to practice the comparative planning theory (Faludi, 1973) it's very important and helpful. The case studies of Italy and the Netherlands helped making an evaluation on how each planning method worked on a specific context and what priorities were taken in consideration, or even how they translated each priority into action. This way, we know how to proceed with the examination of the present situation in Albania, and learn how to create our own set of priorities for the development of the country. And in order to do so, we need to:

- Përcaktojmë se cilat çështje duhet të adresojë një vizion për zhvillimin kombëtar hapësinor;
- Kryejmë ekzaminimin e situatës aktuale sociale, ekonomike dhe territoriale në vend;
- Krijojmë një set principesh dhe konceptesh hapësinore për vizionimin kombëtar hapësinor;
- Të draftojmë vizionin kombëtar hapësinor mbi bazën e gjetjeve të mësipërme.

- Define what issues should be addressed by the national spatial development vision;
- Examine the social-economic-and physical context in Albania;
- Establish a set of principles for visioning and explain each through the use of spatial concepts;
- Draft a national spatial development vision based on the previous findings.



Fotografi ajrore, Fushë-Krujë
Aerial photography, Fushë-Krujë

4.1 Çështjet për t'u Adresuar në Shkallën Kombëtare

Gjatë formulimit të një vizioni kombëtar hapësinor duhet të adresohen disa çështje kritike:

- Nevoja për të ngritur një sistem të dhënash statistikore, bazuar në ato indikatorë që mund të lejojnë profesionistët dhe vendimmarrësit të kryejnë kërkime, mbi bazën e të cilave më pas të mund të adresojnë problematikat ekzistuese;
- Për të krijuar një sistem hapësinor afatgjatë është e nevojshme të ngrihet gjithashtu një sistem i mirëfilltë dhe i saktë të dhënash gjeografike, i cili të lejon të përpunosh materiale të ndryshme grafike në bazë të të dhënave ekzistuese;
- Legjislacioni kombëtar i planifikimit dhe procedurat e ndërlidhura duhet të inkurajojnë dhe forcojnë krijimin dhe implementimin e vizioneve kombëtare, të cilat shërbejnë si instrumente bazë mbështetëse për një qeverisje të mirë hapësinore vendore, rajonale dhe qendrore;
- Praktikën e planifikimit duhet të mbështeten gjithashtu në shkollën ose traditën e caktuara në lidhje me draftimin dhe dizajnimin e politikave kombëtare hapësinore mbi bazën e teknikave dhe mjeteve vizualizuese. Kjo është e rëndësishme sepse profesionistët të cilët punojnë në shkallën kombëtare të planifikimit, dhe praktikuesit që arrijnë deri në shkallë më të vogla, duhet të kenë një gjuhë të përbashkët në mënyrë që të mund të kuptojnë instrumentat dhe politikën që duhet të ndjekin;
- Së fundmi, një plan hapësinor kombëtar duhet të ndërlidhet me plane të tjera në shkallë më të vogla me rëndësi hapësinore për vendin, të cilat trajtojnë më në detaje çështje sektoriale si: planet e infrastrukturës kombëtare, planet e përdorimit të tokave, planet e zhvillimit të qëndrueshëm, planet mjedisore, planet e zhvillimit social-ekonomik, etj. Duhet theksuar se rëndësia e planifikimit hapësinor në shkallë kombëtare nuk duhet të ulë rëndësinë e planifikimit hapësinor në shkallë më të vogla (rajonale ose vendore), sepse vetëm kombinimi dhe plotësimi i planifikimit në të tre këto shkallë siguron një zhvillim të qëndrueshëm në terma afatgjatë dhe sjell rritjen pozitive social-ekonomike.

4.1 Issues to Address on a National Scale

In order to establish a national spatial vision one might address several critical issues:

- The need to establish a good system of statistical database, based on the same indicators, which can allow professionals and decision makers to make research and on that basis to take the right decisions to address existing problems;
- In order to establish a long term spatial system is necessary to establish also good geographical information systems, which allows to draw different graphical outcomes, which are helping better management of territorial and spatial potentials;
- The national planning legislation and procedures must encourage and enforce the design and implementation of national visions, which serve as an instrument for central, regional and local governments for good spatial governance;
- Therefore the planning practice needs also to have a school and tradition on how to draft, design a national spatial plan, on basis of well accepted technical and graphical tools. This is important because professionals at national scale and decision makers must establish a common language and understanding of such instrument;
- Last but not least, the spatial plan at national scale must be associated with sub plans of spatial importance for the country, which treat in details sectoral issues like: national trunk infrastructure plans, land use plans, environmental and sustainable development plans, social economic development plans etc. However it does not mean that the importance of spatial national plan can overshadow the importance of planning at other levels of planning (regional and local), because a combination and complementation of planning tools at three levels, can be the only solution for a long term sustainable development and positive social economic growth.

4.2 Analiza e Kontekstit

Përcaktimi i parimeve mbi të cilat do të bazohet vizioni hapësinor kombëtar dhe më pas hartimi i këtij vizioni kanë nevojë për një mbështetje analitike që lidhet me faktorët territorialë, socialë dhe ekonomikë në vend. Analizat e mëposhtme do të shoqërohen edhe me sintheza dhe konkluzione, sipas kategorive përkatëse.

4.2.1 Çështjet e Zhvillimit Social

Dendësia e Popullsisë

Bazuar në llogaritjet e Censurit të vitit 2011 për Popullsinë dhe Banesat, popullsia banuese në Shqipëri është 2,821,977 dhe krahasuar kjo me përlogaritjet e Censurit të vitit 2001, ku popullsia ishte 3,069,275 kemi një rënie prej rreth 8%. Duke iu referuar një dendësie mesatare të popullsisë prej 97.4 banorë / km², popullsia e Shqipërisë është e përqëndruar kryesisht rreth zonës metropolitane, ku qarku i Tiranës vlerësohet të ketë një dendësi prej 453.61 banorë / km². Më pas vijon qarku i Fierit me 164.20 banorë / km², i cili gjithashtu duket të jetë tejet i përqëndruar kryesisht për shkak të aktivitetit të pasur bujqësore që ofron kjo zonë. Dendësia bie në 82.73 banorë / km² në qarqet e Elbasanit, Beratit dhe Lezhës; dhe në 53.0 banorë / km² në qarqet e Shkodrës, Dibrës, Korçës dhe Vlorës. Dy zonat më pak të populluara janë Kukësi dhe Gjirokastra, me një vlerësim të dendësisë së popullsisë me 25.03 banorë / km².

Popullsia Urbane

54% e popullsisë shqiptare jeton në zonat urbane. Duke krahasuar të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe llogaritjet e mëvonshme, Shqipëria duket të ketë një rritje të popullsisë urbane me 5% nga viti 2008. Ka një dallim të madh në mes qarqeve, që ndryshojnë nga 73% popullsi urbane në 18%, dhe me një raport max / min me 4. Qarqet si Tirana (73%), Vlora (69%) dhe Durrësi (57%) kanë normat më të larta të urbanizimit, si qendrat kryesore pritëse, dhe si rezultat i migrimit të lartë të popullsisë rurale. Ndërkohë zonat me përqindjen më të ulët të urbanizimit janë ato të Dibrës (18%), Kukësit (23%), Lezhës (32%), Fier (32%) dhe Elbasanit (36%).

4.2 Context Analysis

In order to start setting up a set of principles and then visioning, is very important to understand the context in Albania, regarding the social-economic-and territorial components. The document took in consideration several main indicators for each interest field, and for each group of analysis there was made also a synthesis with conclusions.

4.2.1 Social Development Issues

Population Density

Based on the calculations of the 2011 Population and Housing Census the resident population in Albania was 2,821,977, and compared to the previous 2001 Census, where the population was estimated to be around 3,069,275, it has decreased by around 8%. Referring to an average population density of 97.4 inhabitants/km², the population of Albania is highly concentrated mainly around the metropolitan area, where the qark of Tirana is estimated to have a density of 453.61 inhabitants/km². Then this area is followed by the qark of Fier with 164.20 inhabitants/km², which also seems to be highly concentrated mainly because of the rich agricultural activity that this area offers. The density drops to 82.73 inhabitants/km² on the qarks of Elbasan, Berat and Lezha; and to 53.0 inhabitants/km² on the qarks of Shkodra, Dibra, Korça and Vlora. The two least populated areas are Kukësi and Gjirokastra, with a population density rating at 25.03 inhabitants/km².

Urban Population

54% of the Albanian population lives in the urban areas. Comparing the data between the 2001 Census and the later calculations, Albania seemed to have an increase of the urban population by 2008, by 5%. There is a significant differentiation between qarks, varying from 73% to 18%, and with a max/min ratio of 4. The areas of Tirana (73%), Vlora (69%) and Durrës (57%) have the highest rates of urbanization, as the main receiving centers, and as a result of the high external migration of rural population. Meanwhile the lowest urbanized areas are the ones of Dibra (18%), Kukësi (23%), Lezha (32%), Fieri (32%) and Elbasan (36%).

Shpërndarja e popullsisë sipas lartësive

Niveli i urbanizimi relativisht i ulët, i vërejtur më sipër vjen së bashku edhe me një strukturë të fragmentuar dhe ineffiçentë të zonave të banuara, dhe rrjedhimisht edhe më një madhësi të vogël të NJQV (Njësive të Qeverisjes Vendore). Ka një seri faktorësh që kanë ndikuar në këtë lloj zhvillimi dhe strukturë të fragmentuar. Një nga këto argumente është edhe shpërndarja e popullsisë së NJQV brenda një qarku, sipas lartësive të ndryshme të territorit. Mbi këtë argument mund të listojmë si më poshtë:

- Numri më i lartë i NJQV të vendosura në zona me lartësi më shumë se 500m mbi nivelin e detit është gjetur në Korçë (37, ose e përkthyer në përqindje, 89% e tyre, të vendosura në zona mbi 800m); Dibra (26 ose 74%); Kukësi (20, ose 74%); Elbasani (21, ose 42%) i cili karakterizohet gjithashtu nga një shpërndarje më e balancuar e NJQV sipas lartësive të ndryshme. Ndërkohë mesatarja kombëtare llogaritet të jetë rreth 40%.

- Qarqet më të favorizuara janë Durrësi dhe Fieri me 75% dhe 62% të NJQV të ndodhura në lartësinë mesatare nën 100 metra mbi nivelin e detit, dhe më pas Tirana me 83% dhe Vlora me 85% të NJQV të pozicionuara nën 300m lartësi mesatare. Vlora, Tirana, Durrësi, Lezha dhe Fieri kanë më shumë se 90% të popullsisë së tyre në vendbanime të vendosura në lartësi mesatare nën 300m.

- Vendet me vendndodhjen më të vështirë, me lartësi mesatare 500m-800m dhe mbi 800m, janë në Korçë (100% e popullsisë jeton në zona në mbi 500m lartësi mesatare); Dibra (71%) dhe Kukësi (65%). Mesatarja kombëtare për këtë grup lartësie është 19%.

- Pjesa tjetër e qarqeve kanë një shpërndarje më të barabartë ndërmjet grupeve të ndryshme të lartësive mesatare mbi nivelin e detit.

Përqindja e banesave të lira

Sipas llogaritjeve Shqipëria ka një total prej 1,012,400 banesash. Nga ky total 56.6% të të gjitha banesave të banuara (pa ato kolektive) janë të përqendruara në zonat urbane dhe 43.4% në zonat rurale. Krahasuar me të dhënat e 2001, ka pasur një rritje të numrit të banesave të banuara në zonat urbane me 24.7% dhe një rënie në numrin e banesave të banuara në zonat rurale me 20.5%. Banesat e lira përbëjnë 21.7% të banesave konvencionale, nga të cilat 52.6% janë të vendosura në zonat rurale. Banesat e përdorura për qëllime sekondare apo sezonale përbëjnë 8.3% të banesave konvencionale dhe 52.3% janë në zonat rurale. Në qarqet e Vlorës dhe Gjirokastrës ka një përqindje të madhe të banesave konvencionale të lira, 32.4%, ndërsa shumica e banesave të përdorura për qëllime sekondare ose sezonale janë të regjistruara në qarkun e Durrësit me 16.5%, qarkun e Vlorës me 14.6% dhe në qarkun e Gjirokastrës me 12.6%. Korça dhe Durrësi janë dy qarqet me më pak banesa konvencionale të lira, me një vlerësim prej 19%.

Grup-moshat

Mosha mesatare e popullsisë është rritur nga 30.6 vjeç në vitin 2001, në 35.3 sipas llogaritjeve të vitit 2011. Tre kategorizime kryesore moshore dallohen: 0-14 vjeç, 15- 64 vjeç dhe mbi 64 vjeç, dhe në vlerësimin kombëtar ato qëndrojnë në përqindjet e 23%, 67% dhe 10% të popullsisë së përgjithshme. Kategoria 15-64 vjeç dominon në të gjitha njësitet e qeverisjes vendore të Shqipërisë. Edhe pse shkalla më e lartë e kësaj grupmoshe jeton në pjesën qendrore të vendit, veçanërisht në qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Elbasanit, dhe gjithashtu në qarkun jugor bregdetar të Vlorës. Shkalla më e lartë e 0-14 vjeç është kryesisht në pjesën veriore, qarqet e Shkodrës, Kukësit, Lezhës dhe Dibrës, ndërsa Shqipëria jug-lindore ka normën më të lartë të njerëzve të moshës mbi 64 vjeç.

Population distribution by altitude

The previously observed relatively low urbanization level comes along also with a fragmented settlement structure and low size of LGU (Local Government Units). There are a series of factors impacting this kind of development and the fragmented structure. One of these arguments can also be the distribution of LGU population by altitude among qarks, and according to the "Regional Disparities in Albania" calculations, we can list as below:

- *The highest no. of LGUs located on more than 500m above sea level is found in Korça (37, or 100% of them, of which 89% located above 800m); Dibra (26 or 74%); Kukës (20, or 74%); Elbasan has 21 LGUs above 500m, but only 42%) and is impacted by a more equal distribution of LGUs among the altitude groups. The national average for this altitude group is 40%.*

- *The best-located qarks are Durrës and Fier with 75% and 62% of the LGUs below 100m above sea level, and then Tirana with 83% and Vlora with 85% below 300m. Vlora, Tirana, Durrës, Lezha and Fier have more than 90% of their population in settlements located below 300m.*

- *The most difficult settlement locations are in Korça (100% of population above 500m); Dibra (71%) and Kukësi (65%). The national average for this altitude group is 19%.*

- *The rest of the qarks have a more equal distribution among altitude groups.*

Percentage of vacant dwellings

There is a total of 1,012,400 dwellings enumerated in Albania. From this total 56.6% of all inhabited dwellings (without collective ones) are concentrated in urban areas and 43.4% in rural areas. Compared with the data of 2001, there was an increased number of inhabited dwellings in urban areas by 24.7% and a decrease in the number of inhabited dwellings in rural areas by 20.5%. Vacant dwellings make 21.7% of the conventional dwellings, of which 52.6% are located in rural areas. Dwellings used for secondary or seasonal purposes make 8.3% of the conventional dwellings and 52.3% are in rural areas. The qarks of Vlora and Gjirokastra have the biggest percentage of conventional vacant dwellings, 32.4%, whereas most of the dwellings used for secondary or seasonal purposes are registered in the qark of Durrës by 16.5%, qark of Vlora 14.6% and in the qark of Gjirokastra by 12.6%. Korça and Durrës are the two qarks with the least conventional vacant dwellings, with an estimation of 19%.

Age groups

The average age of the population increased from 30.6 years in 2001 to 35.3 in 2011. However the three main age categorizations 0-14 years, 15- 64 years and over 64 years old have been calculated to stand at the rates of 23%, 67% and 10% of the total population. The 15-64 years old category dominates in all the local government units of Albania. Although the highest rate of this age group lives in the central part of country, particularly on the qarks of Durrës, Tirana and Elbasan, and also on the southern coastal qark of Vlora. The highest rate of 0-14 years old is mainly on the northern part, qarks of Shkodra, Kukësi, Lezha and Dibra, while the south-eastern Albania has the highest rate of people aged over 64 years old.

Educational attainment


The 2011 census shows that the illiteracy rate for the population 10 years and over is 2.8%. The people aged 75 years and over who constitute about 50% of the total illiterate people, in combination with the increased

Niveli i edukimit


Regjistrimi i popullsisë për vitin 2011 tregon se shkalla e analfabetizmit për popullsinë e moshës 10 vjeç e sipër është 2.8%. Njerëzit e moshës 75 vjeç e sipër përbëjnë rreth 50% të totalit të njerëzve analfabetë, dhe në kombinim me shpërndarjen e gjerë të kësaj grupmoshe të popullsisë në territor, kemi një shkallë relativisht të lartë të numrit të analfabetëve në vend. Qarku i Tiranës ndjekur nga qarqet e Durrësit dhe Kukësit kanë shkallën më të ulët të analfabetizmit, dhe qarqet e Lezhës dhe Elbasanit kanë shkallën më të lartë. Nga vlerësimet e regjistrimit të popullsisë për vitin 2011, 262,369 njerëz kanë përfunduar ose janë duke ndjekur universitetin, ose studimet pas-universitare. Ndërkohë që popullsia me arsim të lartë është rreth 10.7% e totalit, një rritje e konsiderueshme me 5.5% nga regjistrimi i vitit 2001, Gjithsesi, vetëm rajoni metropolitan me qarqet e Durrësit dhe të Tiranës kanë shkallën më të lartë të numrit mesatar të njerëzve me shkollën e mesme të përfunduar, ndërkohë pjesa tjetër e vendit është vlerësuar mesatarisht të kategorizohet në nivelin e ulët të arsimimit. Kjo shpjegohet me rritje social-ekonomik të rajonit metro-politan, që ka qenë edhe zona më tërheqëse e vendit deri tani.

share of this elderly age group in the total population, impact the relatively high rate and the large number of illiterates. The qark of Tirana followed by the qarks of Durrës and Kukës have the lowest rate of illiteracy and the qark of Lezha and Elbasan have the highest. From the 2011 Census estimations, 262,369 people have completed or are attending university or post-graduated levels. Meanwhile the population with tertiary education is about 10.7% of the total population 10 years and over, a significant increase from the 2001 census, by 5.5%. Anyhow, only the metropolitan region with the qarks of Durrës and Tirana have the highest average rate of people with the upper secondary school completed, meanwhile the rest of the country is estimated to categorize at the lower secondary level of education. This is explained by the social-economic boost of the metropolitan region, which has been the most attractive area so far.


POPULATION DENSITY (inh/km2)




URBAN POPULATION (%)




POPULATION DISTRIBUTION BY ALTITUDE (%)




PERCENTAGE OF VACANT DWELLINGS



AGE GROUPS



EDUCATIONAL ATTAINMENT



Hartat për analizat e çdo sektori: prodhuar në bazë të të dhënave të studimit të UNDP në 2010, "Regional Disparities in Albania", dhe në bazë të Censusit të Popullsisë dhe Banesave, të vitit 2011. Maps for the analysis of each section: produced based on the data of 2010 study of UNDP, "Regional Disparities in Albania", and on the 2011 Population and Housing Census.

4.2.2 Çështjet e Zhvillimit Ekonomik

Indeksi punësimi sipas sektorëve

Tre sektorët kryesorë të punësimi në Shqipëri janë sektori publik me një përllogaritje prej 18.1% të popullsisë së përgjithshme; sektori jo-bujqësor privat me 37.7%; dhe sektori bujqësor privat me 44.2% të punësimi total. Qarqet e Durrësit dhe Tiranës në rajonin metropolitan, ato të Korçës, Vlorës dhe Gjirokastrës në jug dhe jug-lindje të vendit, kanë normat më të larta të sektorit jo-bujqësor privat, dhe kjo për shkak se këto rajone përfaqësojnë ato pjesë të vendit, ku është vendosur dhe zhvillohet industria kryesore e lehtë dhe e ofrimit të shërbimeve në vend, duke pasur parasysh këtu industrinë e agro-biznesit dhe gjithashtu sektorin e turizmit (si atij malor dhe atij detar). Ndërkohë shkalla më e lartë e sektorit të bujqësisë private të gjendet në rajonet veriore të Shqipërisë (qarqet e Shkodrës, Kukësit, Lezhës dhe Dibrës) dhe në pjesën qendrore (në qarqet e Elbasanit, Fierit dhe Beratit), ku ndodhen edhe tokat më pjellore të vendit.

Vlerësimi i papunësisë

Shkalla e përgjithshme mesatare e papunësisë në vend është 13.1%. Bazuar në ndarjet e qarqeve, normat më të larta të papunësisë janë në Shkodër me 20.48% dhe në Durrës me 18.18%, ndërsa norma më e ulët e papunësisë është në Dibër dhe Kukës me 6.11% dhe 7.02%. Niveli mesatar i normës së papunësisë gjendet në Vlorë me 12.1%, në Korçë me 10.21% dhe në Tiranë me 13.83%.

Të ardhurat për frymë

Normat më të larta të të ardhurave për frymë janë llogaritur të jenë në qarqet e Tiranës dhe Durrësit të rajonit metropolitan me 8,992.65 lekë, ndjekur nga qarku i Vlorës me 7,647.71 lekë. Normat më të ulëta janë në qarqet e Beratit dhe Lezhës, me 3,091.2 lekë dhe 2,991.16 lekë.

Investimet për frymë, në nivel qarku

Mesatarja e investimeve për frymë në nivel qarku është 2,849 lekë. Ndërkohë shkalla më e lartë e investimeve për frymë është në qarkun e Gjirokastrës me 4,787.69 lekë, duke u pasuar nga qarku i Dibër me 4,083.51 lekë. Kjo shpjegohet me faktin se Gjirokastra është një nga zonat nën mbrojtjen e UNESCO-s, ku ndër vite është investuar dhe vazhdon të promovohet më tej zhvillimi i turizmit; dhe Dibra, si një nga zonat më pak të integruara e me zhvillimin më të ngadaltë. Në anën tjetër niveli më i ulët i investimeve për frymë është në qarqet Elbasan dhe Fier, përkatësisht me 2,125.35 lekë dhe 2,373 lekë.

4.2.2 Economic Development Issues

Employment by sector index

The 3 main employment sectors in Albania are the public sector with a share of 18.1% of the total population; the private non-agricultural sector with a share of 37.7% and the private agriculture sector, which leads the market economy by 44.2% of the total employment. The qarks of Durrës and Tirana in the metropolitan region, those of Korça, Vloa and Gjirokastra in the south and south-eastern part of the country have the highest rates of private non-agriculture sector, and this because the main services and industries are concentrated on this region, considering here the agro-business industry and the tourism sector of the country (both mountainous and sea tourism). Meanwhile the highest rate of the private agriculture sector can be found on the northern regions of Albania (the qarks of Shkodra, Kukësi, Lezha and Dibra) and on the central part (the qarks of Elbasan, Fier and Berat), where the richest agricultural land is.

Unemployment rate

The total average unemployment rate of the country is 13.1%. Based on the qark divisions the highest rates of unemployment are in Shkodra with 20.48% and in Durrës with 18.18%, while the lowest unemployment rate is in Dibra and Kukës with 6.11% and 7.02%. The average rates of unemployment are in Vloa with 12.1%, in Korça with 10.21% and in Tirana with 13.83%.


Own income p.c

The highest rates of own income p.c are calculated to be in the qarks of Tirana and Durrës in the metropolitan region with 8,992.65 lekë, followed by the qark of Vloa with 7,647.71 lekë. The lowest own income p.c rate relate to the qarks of Berat and Lezha, with 3,091.2 lekë and 2,991.16 lekë.


Investment at qark level p.c

The average investment p.c at qark level is 2,849 lekë. Meanwhile the highest rate of investment p.c is in the qark of Gjirokastra with 4,787.69 lekë, being followed by Dibra with 4,083.51 lekë. This is explained by the fact that Gjirokastra is one of the UNESCO sites, where tourism is developed, and Dibra is one the main remote areas of the country. On the other hand the lowest investments p.c at qark level are in Elbasan and Fier, with 2,125.35 lekë and 2,373 lekë.


EMPLOYMENT BY SECTOR INDEX (%)




UNEMPLOYMENT RATE (%)



OWN INCOME P.C (lek)



INVESTMENT P.C AT QARK LEVEL (lek)



4.2.3 Çështjet e Zhvillimit të Territorit

Terreni dhe lartësitë mesatare

Shqipëria karakterizohet nga një topografi kodrinoro-malore, e cila ndahet në tre kategori kryesore të bazuara në lartësitë mesatare: rrafshi perëndimor, me lartësi mesatare 0-300m (ku janë të vendosura shumica e tokave bujqësore dhe zonat më të urbanizuara); aksi qendror kodrinor, me lartësi mesatare 301-500m (i cili ka qenë disi një barrierë midis perëndimit dhe lindjes së vendit dhe përfaqëson edhe hapësirën më pak të zhvilluar të vendit); zona lindore malore, me lartësi mesatare 501-800m e sipër, ku ndodhen zonat me blegtorinë më të zhvilluar, ka sërish disa zona që merren me bujqësi, dhe shtrihen gjithashtu disa nga zonat më të urbanizuara të vendit, edhe pse në nivele më modeste se ato të ultësirës perëndimore.


Infrastruktura kryesore rrugore e vendit

Falë pozicionimit të saj strategjik Shqipëria ka qenë ndër vite një portë lidhëse mes Europës Perëndimore dhe asaj Lindore. Dy korridore kryesore Pan-Evropiane kalojnë në vend, Korridori Blu dhe Korridorit VIII. Një tjetër korridor i rëndësishëm kombëtar përshkon vendin, Rruga e Kombit, i cili sëbashku me rrugët e tjera të rëndësishme kombëtare krijojnë një sistem radial ndërlidhës që siguron lidhjen midis perëndimit dhe lindjes së vendit, dhe lidh gjithashtu Shqipërinë me vendet fqinje. Duke filluar nga zonat lindore ndër-kufitare dhe duke kaluar përmes këtyre koridoreve të rëndësishme infrastrukturore që përshkojnë vendin, ka një dalje të drejtpërdrejtë në det, gjë që e bën Shqipërinë të konsiderohet si një portë e rëndësishme për të siguruar zhvillimin e ekonomisë dhe shkëmbimeve, jo vetëm brenda vendit, por edhe me vendet fqinje e më gjerë në Ballkan e Europë.

Infrastruktura kryesore hekurudhore e vendit

Shqipëria ka një sistem ekzistues hekurudhor që shërben për transportin e mallrave dhe njerëzve, ndonëse jo plotësisht funksional dhe jo i mirëmbajtur. Linja ekzistuese dhe funksionale lidh Podgoricën e Malit të Zi me Shkodrën, duke vazhduar më tej në Lezhë, Tiranë dhe Durrës. Nga këto destinacione dalin dy linja të tjera që shkojnë drejt Pogradecit dhe drejt Vlorës. Por me arritjen e këtyre destinacioneve rrjeti hekurudhor ndërpritet, duke mos u lidhur me sistemin Ballkanik hekurudhor.

TERRAIN AND AVERAGE ALTITUDES (m)



4.2.3 Economic Development Issues

Terrain and average altitudes

Albania is characterized by a hilly-mountainous topography, which is divided on three main categories based on the average altitude: the western plains of 0-300m (where are located most of the agricultural lands and the most urbanized areas), the central hilly axis of 301-500m (which has been somehow a barrier between west and east of the country, and is also the least developed space), and the eastern mountainous area of 501-800 and over (where some other important agricultural and urban areas are, although less developed than the ones of the western plain).


Main national and local infrastructure, roads and railway

Thanks to its strategic positioning Albania has been a gate from Western Europe to the East. Two main Pan-European corridors cross through the country, the Blue Corridor and the Corridor VIII. Another important national corridor, the Road of Nation, together with other important national roads create a radial system, which ensures connection between the western plain and the eastern mountainous areas, also connecting Albania with the neighboring countries. Starting from the eastern cross border areas, passing through these main roads and corridors and ending to the main western sea ports, Albania stands for a very important territorial component, ensuring economy development and exchanges not only within the country, but also with the neighboring countries, and on a broader perspective too.

Main national and local infrastructure

There is an existing railway system in Albania, although not fully functional and not properly maintained. The existing lines connect Podgorica of Montenegro with Shkodra, continuing in Lezha, Tirana and Durrës, and from there deriving on two lines, one that goes towards Pogradec and the other that goes to Vlorë. But these lines stop on these destinations and do not connect with the Balkan railway system. The railway serves for the transport of both, goods and people.

MAIN INFRASTRUCTURE (ROADS)



MAIN INFRASTRUCTURE (RAILWAY)



Hartat: bazuar në analiza individuale.
Maps: based on individual analysis.

4.2.4 Sinteza e Analizave

Çështjet e Zhvillimit Social:

- Dendësia e popullsisë është më e lartë në pjesët qendrore të vendit, kryesisht në zonën metropolitane;
- Në bazë të lartësive mesatare, shpërndarja e popullsisë rritet duke nisur nga zonat e ulëta fushore (0-300m) në drejtim të zonave të ulëta e të mesme malore (301-800m), dhe drejt maleve të larta në mbi 800m lartësi;
- Popullsia urbane është më e lartë kryesisht në pjesët qendrore dhe jugore të vendit;
- Sipas grupmoshave, grupi i 15-64 vjeç dominon në të gjithë vendin, por megjithatë përqindja më e lartë për moshën 0-14 vjeç dominon në rajonet veriore, përqindja më e lartë e grupit 15-64 vjeç dominon në pjesën qendrore të vendit, dhe grupmosha më shumë se 64 vjeç dominon rajonet jugore.

Çështjet e Zhvillimit Ekonomik:

- Punësimi i popullsisë në jug-perëndim dhe zonën metropolitane përqendrohet kryesisht në aktivitetet jobujqësore;
- Këto zona kanë edhe normat më të larta të të ardhurave personale;
- Ndërkohë shkalla më e lartë e investimeve për person është kryesisht në zonat veri-lindore dhe jug-lindore të vendit, që përfaqësojnë edhe zonat më të varfra, por me potenciale të mëdha turistike, peizazhiste dhe mundësi për ngritjen e marëdhënieve ndërkufitare;
- Papunësia është më e ulët në zonat veri-lindore dhe më e lartë në zonat veri-perëndimore, të cilat kanë në të njëjtën kohë vlera të mëdha për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit. Kjo tregon për një mungesë të shfrytëzimit të potencialeve përfaqësuese të këtyre zonave përkatëse.

Çështjet e Zhvillimit Territorial:

- Portet detare luajnë një rol të rëndësishëm në shkëmbimin e mallrave me vendet fqinje, por gjithashtu edhe për sa i përket zhvillimit të turizmit;
- Për shkak të pozicionimit strategjik të vendit tonë, nisur nga këto pika të rëndësishme logjistike (portet) nisin rrugët kryesore kombëtare, të cilat shpërndajnë më tej flukset (e mallrave apo të njerëzve) drejt

4.2.4 Synthesis of Analysis

Social Development Issues

- *The population density is higher on the central parts of the country, mainly on the metropolitan area;*
- *Based on the altitude, the population distribution increases from the low plain areas (0-300m) towards the low and medium mountainous (301-800), and the high mountains of over 800m;*
- *The urban population is higher mainly on the central and southern parts of the country;*
- *According to the age groups, the group of 15-64 years old dominates in the whole country, but however the higher rate of 0-14 years is more accurate on the northern regions, while the higher rate of 15-64 years on the central parts, and the last group of over 64 years old has a higher rate on the southern regions.*

Economic Development Issues

- *The population of the south-west and the metropolitan area works mainly on the non-agricultural activities;*
- *These areas have also the highest rates of own income;*
- *Meanwhile the highest rate of investments p.c is mainly on the north-east and south-east areas (which are poorer, but with touristic, landscape and cross border cooperation potentials);*
- *Unemployment is higher on the north-west (agricultural and touristic values), and lower on the northeast areas.*

Territorial Development Issues


- *Sea ports play a crucial role on the import/export of goods and also on the touristic flows;*
- *From these points the main national roads distribute the flows (of goods or/and people) towards the other parts of the country, where the metropolitan area, the seaside west and south and the mountainous north and south are the most famous ones; the central inlands of the country are more abandoned, less developed and not well integrated with the rest of the country;*
- *The railway system could play a crucial role on connecting the less developed areas, but this infrastructural system is outdated and old, and does not play its role properly;*
- *The cross border areas are very important, because of the activity they generate and the opportunities they present for both parts of the territory, Albanian and/or not.*

pjesëve të tjera të vendit, ku zona metropolitane, bregdeti perëndimor e jugor, dhe zonat malore veriore e jugore janë edhe destinacionet më të rëndësishme. Ndërkohë duke ju referuar rrjetit infrastrukturor rrugor, thellësia qëndrore e vendit, ose ndryshe masivi qëndror paraqitet të jetë më i braktisur, më pak i zhvilluar dhe jo i mirë-integruar me pjesët e tjera të vendit.

- Sistemi hekurudhor nuk shfrytëzohet në potencialin e tij maksimal si pasojë e amortizimit dhe mos-rigenerimit të tij. Por nëse ky sistem do të rikonsiderohej ai do të mund të luante një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm për të realizuar një lidhje më të shpejtë mes zonave urbane, por do të integronte gjithashtu zonat më pak të zhvilluara dhe do të kishte në të njëjtën kohë një rëndësi të madhe ekonomike për vendin;


- Zonat ndërkufitare janë shumë të rëndësishme, për shkak të veprimtarisë ekonomike që gjenerojnë, si dhe mundësi që paraqesin për të gjitha pjesët e territorit, si brenda Shqipërisë, edhe përtej kufirit.

SOCIAL DEVELOPMENT DATA- SYNTHESIS MAP




Hartat: bazuar në analiza individuale.
 Maps: based on individual analysis.

ECONOMIC DEVELOPMENT DATA- SYNTHESIS MAP



TERRITORIAL DEVELOPMENT DATA- SYNTHESIS MAP



4.3 Parimet për Vizionimin

Analizimi i dy rasteve studimore që morëm në konsideratë, Holandë dhe Itali na ndihmojnë të kuptojmë se ngritja e një vizioni kombëtar hapësinor për vendin tonë ka nevojë për t'u mbështetur mbi disa principe/parime bazë, të cilat do të ndërtojnë mbi potencialet ekzistuese të vendit dhe do të sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

Pas përcaktimit të këtyre parimeve, do të jetë e nevojshme që secili prej tyre të shpjegohet konkretisht përmes një serie konceptesh hapësinore. Duke mësuar nga këto dy raste studimore ilustruese, si dhe duke u nisur nga përfundimet e nxjera gjatë analizës së kontekstit për vendin tonë arrijmë të formulojmë 4 principe bazë mbi të cilat mund të mbështetet vizioni jonë hapësinor kombëtar:

1. Rajonet dhe Zhvillimi Rajonal

• Këto dy koncepte bazohen në krijimin e njësive më të vogla territoriale, të cilat konsistojnë në implementimin dhe krijimin e institucioneve përkatëse që kanë identitete të caktuara dhe karakterizohen nga aktivitetet kolektive brenda një njësie/rajoni të caktuar gjeografik. Por gjithashtu këto koncepte mund të shihen edhe si ideologji politike, të cilat fokusohen në interesin e një ose disa njësive/rajoneve në të njëjtën kohë, qoftë kjo në mënyrën tradicionale ose formale.

Për rastin e Shqipërisë, kjo mund të përkthehet duke iu referuar "Platformës së Co-PLAN për Parlamentin Shqiptar në lidhje me Qeverisjen e Territorit" në vitet 2003-2005 (dokumentuar nga Aliaj në "Misteri i Gjashtë" 2008); si dhe "Platformës së Co-PLAN në vitin 2014" (Shutina, Toto, Gjika, 2014) me dy propozime për riorganizimin e qeverisjes rajonale dhe ndarjen administrative të Shqipërisë (Kuvendi i Shqipërisë, 2014), ku prezantohen dy alternativa për organizimin kombëtar hapësinor të territorit Shqipëtar në 4 deri në 6 rajone.

2. Policentrizmi dhe Polet e Zhvillimit

• Policentrizmi, bazuar në teorinë e Palmiro Togliatti-t (Itali), i referohet organizimit të një rajoni rreth disa qendrave politike, sociale e financiare. Një shtet quhet policentrik nëse popullsia e tij është e shpërndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në disa qendra të pjesëve të ndryshme të territorit të tij.

• Ideja kryesore që shpjegon "polet e zhvillimit" është se zhvillimi ekonomik, ose rritja, nuk është uniforme mbi të gjithë rajonin, por zhvillohet rreth një poli të caktuar, ose mer formën e një aglomerimi (Rodrigue, Comtois, Xhoko, 2013).

Për rastin e Shqipërisë, kjo mund të përkthehet duke iu referuar modelit të Aliaj (Misteri i Gjashtë, 2008), i cili konsideron disa pole zhvillimi në vend, duke iu referuar rëndësisë së tyre historike, prezencës së traditës së administratës dhe shërbimeve rajonale, afërsisë me vendet fqinje, ose polet e tjera të rritjes, etj. Në këtë kontekst krahas rajonit metropolitan Tiranë, Durrës, Elbasan, janë identifikuar edhe 6 pole të tjera zhvillimi, të cilat ndërlidhen edhe me potencialet e zhvillimit të marrëdhënieve ndër-kufitare:

- Poli i Shkodrës (Shkodër-Lezhë + Ulqin-Podgoricë)
- Poli i Kukësit (Peshkopi-Kukës-Has-Tropojë + Gjakovë-Prizren-Dibër).
- Poli i Korçës (Korçë-Pogradec + Strugë-Ohër-Bitola-Konicë)
- Poli i Gjirokastrës (Gjirokastrë-Sarandë + Korfuz-Igumenicë-Janinë).
- Poli i Vlorës (Lushnjë-Berat-Fier-Vlorë + Bari).
- Poli i Tiranës (Tiranë-Durrës-Elbasan-Krujë + Bari).

4.3 Set of Principles

Looking into the spatial planning process of Italy and The Netherlands, the formulation of a spatial vision for Albania needs to be supported by a set of principles, which builds on existing potentials and ensures sustainable development. These principles will be then explained and translated through a series of spatial concepts.

Learning from the Dutch and Italian illustrative cases and deriving from the context analysis we are guided to four main principles, which are very important to be taken in consideration while planning on a national spatial development scale:

1. Regions and Regional Development

• *Based on the foundation of regions of different importance within a country, which consists on the creation and implementation of institutions that express a particular identity and shape collective action within a geographic region, and also as a political ideology that focuses on the interests of a particular region, or group of regions, whether traditional or formal.*

For the Albanian case, this could be translated referring to the the platform of Co-plan for the Parliament 2003-2005, documented by Aliaj, "Misteri i Gjashtë", 2008; and the platform of Co-plan 2014 (Shutina, Toto, Gjika, 2014) with proposals for the re-organization of regional governance and administrative division of Albania (Parliament of Albania, 2014), where two alternatives are feasible, spatially organizing the national territory on 4 to 6 regions.

2. Polycentrism and Growth Poles

• *Polycentrism, based on the theory of Palmiro Togliatti refers to the organization of a region around several political, social or financial centers. A country is said to be polycentric if its population is distributed almost evenly among several centers in different parts of the county.*

• *The central idea of the growth poles theory is that economic development, or growth, is not uniform over an entire region, but instead takes place around a specific pole, or cluster (Rodrigue, Comtois, Slack, 2013). For the Albanian case, this could be translated referring to the model of Aliaj (Misteri i Gjashtë, 2008), which considers several growth poles of the country, referring to their historical importance, presence of regional administration and services, proximity to the neighboring countries growth poles etc. In this case despite the capital metropolitan region (Tirana, Durrës, Elbasan), there are identified also 6 growth poles, which interrelate also with cross border growing potentials:*

- Shkodra Pole (Shkodra-Lezha + Ulcinj-Podgorica)
- Kukësi Pole (Peshkopia-Kukësi-Hasi-Tropoja + Gjakovë-Prizren-Dibër)
- Korça Pole (Korça-Pogradeci + Struga-Ohrid-Bitola-Konitsa)
- Gjirokastra Pole (Gjirokastra-Saranda + Corfu-Igoumenica-Ioannina)
- Vlora Pole (Vlora-Fieri-Lushnja-Berati + Bari)
- Tirana Pole (Tirana-Durrës-Elbasan-Kruja + Bari)

3. Development Corridors and Free Economic Areas

• *Development Corridors provide connections between different nodes or hubs of urbanized and economic agents along a defined geography, and they work as a system, or in terms of the network effects, that they include.*

3. Koridoret e Zhvillimit dhe Zonat e Lira Ekonomike

• Korridoret e Zhvillimit sigurojnë lidhje midis nyjeve dhe qendrave të ndryshme ekonomike ose të urbanizuara, përgjatë një zone të caktuar gjeografike. Ato funksionojë si një sistem i vetëm, ose sipas kushteve të caktuara të rrjetit në të cilin bazohen.

• Zonat e Lira Ekonomike i referohen caktimit të zonave të pajisura mirë me infrastrukturë dhe shërbime, në të cilat kompanitë e ndryshme që operojnë tashmë shumë pak, ose aspak për të nxitur aktivitetin ekonomik.

Për rastin e Shqipërisë, kjo mund të përkthehet duke iu referuar modeleve të Aliaj dhe Toto (Universiteti Polis: Laboratori i "Planifikimit Rajonal" dhe Studio e "Planifikimit të Qëndrueshëm" 2010-2014). Kjo qasje konsideron potencialet më të rëndësishme historike, natyrore dhe trungun kryesor të infrastrukturës, si instrumente të rritjes së orientuar në formën e një koridori. Kontribut shtesë për këtë parim kanë dhënë edhe "Ministria e Transportit" dhe "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës", të cilat kanë identifikuar në vitin 2007 shtatë zona ekonomike, ose të ashtuquajtura "parqe industriale", ku përfshihen: Shkodra, Kopluku, Shëngjini, Lezha, Spitalë-Durrës, Elbasani dhe Vlora.

4. Potencialet Natyrore dhe Koridoret e Gjelbërta

• Në anën tjetër termi i "Koridoreve të Gjelbra" përfaqëson zona-habitat, të cilat lidhin popullsitë e kafshëve të egra, të ndara si rezultat i zhvillimit urban dhe aktiviteteve njerëzore. Në rastin e fundit është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë komponenti "ekologjik" që i referohet atyre koncepteve të planifikimit që sigurojnë një marrëdhënie të shëndetshme midis mjedisit të ndërtuar dhe të natyrës (McHarg, Design with Green, 1969).

Për rastin e Shqipërisë kjo mund të përkthehet në një koncept, i cili është ndërsektorial me të gjitha nivelet e qeverisjes së mirë, veçanërisht të atyre që lidhen fort me shqetësimet mjedisore. Në këtë pikë të pasurit parasysht të potencialeve topografike të Shqipërisë; pikave të nxehta kryesore shqetësuese mbi mjedisin; të tokave bujqësore dhe zonave të mbrojtura, etj; do të na çojë drejt krijimit të një rrjeti zonash të reja prioritare për zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe krijimin e koridoreve të gjelbra, për të formuar më tej një strategji kombëtare që adreson këto çështje.

4.4 Konceptet Hapësinore

Përmes analizës dhe detajimit të çdo parimi mbi territorin shqiptar, konceptet hapësinore do të shpjegojnë në detaje secilin parim, për të orientuar politikën e lidhura me territorin dhe udhëzimet përkatëse, si për institucionet kombëtare, ato rajonale dhe lokale. Kombinuar me teknikat e vizualizimit, dhe duke krijuar materiale hartografike, këto koncepte hapësinore do të përfaqësojnë imazhe të qarta të zhvillimit të dëshiruar hapësinor (KUNZMANN, 1996). Është shumë e rëndësishme të përmendet se përfshirja e teknikave të vizualizimit dhe prodhimi i materialeve hartografike, mund të ndihmojë për të ngritur vëmendje për çështje të rëndësishme hapësinore, për të komunikuar mesazhe dhe për të nxitur veprime deri në nivelet më të ulëta të qeverisë (DUHR, 2007).

Në rastin e Shqipërisë, kjo do të thotë se në mënyrë që të ndërtohet një sistem modern i planifikimit kombëtar hapësinor është e rekomandueshme të lidhet baza e përditësuar rregullisht e të dhënave statistikore të INSTAT-it, me të dhënat fizike të GIS-it të AKPT / MZHUT, në mënyrë që të prodhohen në çdo kohë materiale hartografike dhe imazhet vizuale, të cilat do të ndihmojnë politikën moderne dhe vendimmarrjen.

• *Free Economic Areas* refers to designate areas, well equipped with infrastructure and services, in which companies are taxed very lightly, or not at all in order to encourage economic activity.

For the Albanian case, this could be translated referring to the models of Aliaj and Toto (Polis University, "Regional Planning" and "Sustainable Planning" studios). This approach considers main historic, natural and trunk infrastructure potentials, as instruments of corridor-oriented growth. Additional contribution to this gives the Ministry of Transport and the Ministry of Economy, Trading and Energetics, which have identified in 2007 seven economic areas/ industrial parks, including: Shkodra, Kopluk, Shëngjini, Lezha, Spital in Durrës, Elbasan and Vlora.

4. Natural Potentials and Green Corridors

• *Sustainable Development* stands for a good balance between the three components economy- environment- society, and promotes the preservation of natural and cultural heritage on long terms.

• *On the other hand green corridors* represent areas of habitat, which connect wildlife populations separated as a result of urban development and human activities.

• *On this last principle is very important to also consider the ecological component, that stands for those planning concepts, which will ensure a healthier relationship between the built environment and nature (McHarg, 1969).*





For the Albanian case this could be translated into a concept, which is crosscutting to all levels of good governance, especially to those strongly related with the environmental concerns. At this point considering the potentials of the Albanian topography, the main hotspots disturbing the environment and also the agricultural land and protected areas, will lead to the creation of a network of new priority areas with green extension and corridors, in order to frame a national green strategy.

4.4 Spatial Concepts

Through the analysis and detailing of each principle over the Albanian territory, spatial concepts will explain more in details each principle, for guiding spatially relevant policies and guidelines for national, regional and local institutions. Combined with visualization techniques, and by creating cartographic representations, these spatial concepts will represent clear images of the desired spatial development (Kunzmann, 1996).

It's very important to mention that incorporating visualizing techniques and producing cartographic representations, can help to shape attention for relevant spatial issues, to communicate messages and to stimulate action until the lower tiers of government (Duhr, 2007).

In the case of Albania this means that in order to build a modern system of national spatial planning it is highly recommended to connect the regularly updated statistical database of INSTAT, with the periodically updated physical GIS data of AKPT/ MZHUT, in order to produce at any time cartographic maps and visualized images that help modern policy and decision making.



Vizioni i Tiranës së Madhe: Në të Majtë- KCAP dhe MetroPolis, 2012; Në të Djathtë- ULMP, 2003
 Vision for the Greater Tirana: On the Left- KCAP and MetroPolis, 2012; On the Right- ULMP, 2003

4.5 Drejt një Vizioni të Zhvillimit Kombëtar Hapësinor

4.5.1 Rajonet dhe Zhvillimi Rajonal

4.5.2 Policentrizmi dhe Polet e Zhvillimit

Për shkak të lidhjes së ngushtë dhe të karakterit ndërdisiplinor që këto dy parime kanë midis tyre, ato do të trajtohen së bashku, duke nisur me rajonet dhe zhvillimin rajonal, për të përfunduar me identifikimin e poleve kryesore të rritjes dhe rajoneve policentrike.

Rajonet e Shqipërisë

Parimi i Rajoneve dhe Zhvillimit Rajonal është i bazuar në dy dokumente kryesore: i) Platforma e Co-Plan për Parlamentin mbi qeverisjen e mirë të territorit” (2003–2005), dokumentuar nga Aliaj në botimin “Misteri i Gjashtë” (2008); ii) dhe Platforma e Co-Plan për reformën administrative-territoriale (2014). Dokumenti i parë propozon riorganizimin e qarqeve sipas 7 baseneve kryesore të lumenjve të Shqipërisë. Konsolidimi i 2-3 pellgjeve krijon 3 rajone sipas perspektivës së BE-së për krijimin e NUTS-eve:

- Rajoni Verior (pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Drin dhe Mat)
- Rajoni Qëndror (pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Erzen dhe Shkumbin)
- Rajoni Jugor (pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Seman dhe Vjosë)

Propozimi i dytë i Co-Plan në vitin 2014 konsideron disa nga aspektet e ndarjes së mësipërme, që lidhen kryesisht me çështjet mjedisore dhe ndarjes në bazë basenesh, por konsideron gjithashtu një ekuilibër të mirë në lidhje me sipërfaqen e çdo rajoni dhe popullsisë së secilit, duke e çuar numrin e rajoneve të propozuara në 6:

- Rajoni i Drinit: 307,523 banorë dhe 465,320 ha;
- Rajoni Mat-Drin: 218,708 banorë dhe 504,712 ha;
- Rajoni Shkumbin-Erzen: 1,301,598 banorë dhe 487,510 ha;
- Rajoni Devollit: 246,845 banorë dhe 425,811 ha;
- Rajoni Semanit: 454,889 banorë dhe 356,545 ha;
- Rajoni Vjosës: 272,832 banorë dhe 589,641 ha.

Çdo koncept ka sigurisht avantazhet dhe disavantazhet e tij: I pari krijon ekonominë e shkallës dhe respekton e konsideron shqetësimet mjedisore në rritje, duke shmangur debatet mbi interesat elektorale. Megjithatë ai imponon ndryshime të mënyrës dhe kulturës së jetesës dhe ka nevojë për shumë ndryshime dhe investime në infrastrukturë e shërbime, veprime me kosto tepër të larta për buxhetin kombëtar.

Opsioni i dytë respekton disi kufijtë ekzistues të qarqeve, duke konsideruar edhe pellgjet ujëmbledhëse, por tenton të sjell qeveritë rajonale më afër komuniteteve dhe qeverive lokale, pa ndryshime të mëdha në drejtim të infrastrukturës dhe ofrimit të shërbimeve, sepse përdor të njëjtin model ekzistues infrastrukturor. Një tjetër avantazh i opsionit të dytë është se ai nxit një shpërndarje më të gjerë e demokratike të rajoneve policentrike.

4.5 Towards a National Spatial Development Vision

4.5.1 Regions and Regional Development

4.5.2 Polycentrism and Growth Poles

Because of the close relation and interdisciplinary character that these two principles have, they're analyzed together, starting from the regions of the country, and reaching to the identification of the main growth poles and polycentric regions.

The Regions of Albania

The principle of “regions and regional development” is based on two main documents: the platform of Co-PLAN for the Parliament 2003–2005, documented by Aliaj, “Misteri i Gjashtë” on 2008; and the platform of Co-PLAN 2014 for the administrative territorial reform. The first one proposes the reorganization of qarks, according to the 7 main river basins of Albania. The consolidation of 2-3 river basins creates 3 regions according to EU NUTS perspective:


- The Northern Region (Drini and Mati River Basins)
- The Central Region (Ishmi, Erzeni and Shkumbini river basins)
- The South Region (Semani and Vjosa river basins)

The second proposal of Co-PLAN on 2014 respects somehow this concept of river basins, but it also considers a good balance regarding the surfaces and population of each region, increasing the number of regions to 6:


- Drini Region: 307,523 inhabitants and 465,320 ha
- Mat-Drini Region: 218,708 inhabitants and 504,712 ha
- Shkumbin-Erzen Region: 1,301,598 inhabitants and 487,510 ha
- Devolli Region: 246,845 inhabitants and 425,811 ha
- Senani Region: 454,889 inhabitants and 356,545 ha
- Vjosa Region: 272,832 inhabitants and 589,641 ha

Each concept has advantages and disadvantages: the first one creates economy of scale and respects and considers the growing environmental concerns, avoiding debates over electoral interests. However the first one imposes changes of the way and culture of living and needs a lot of changes and investments on infrastructure and services with high costs for the national budget.

While the second option respects somehow the existing borders of qarks, considers also the river basins, but brings regional governments nearer the local communities and governments, without big changes in terms infrastructural and services provisions, because uses the same existing patterns. Another advantage of the second option is that it promotes a broader and more democratic distribution of polycentric regions.



Shqipëria në 3 Rajone, bazuar në basenet ujëmbledhëse të lumenjve; Shqipëria në 6 Rajone sipas Co-PLAN.
Albania in 3 Regions based on the Watershed Areas; Albania in 6 regions according to Co-PLAN.



- + Creates economy of scale;
- + Respects and considers the growing environmental concerns;
- + Imposes changes on the way and culture of living;
- + Needs a lot of investments on infrastructure and services.


Rajonet Policentrike

Pas trajtimit të konceptit me 6 rajone të propozuara nga Co-Plan, u analizuan disa tregues për secilin prej tyre për të vijëzuar në këtë mënyrë identitetet rajonale për secilën nga këto njësi. Në bazë të afërsisë brenda zonave funksionale ekonomike të këtyre rajoneve mund të shihet 6 polaritete kryesore, të cilat i kanë qendrat e tyre në: Shkodër, Kukës, Tiranë, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë. Modelet e këtyre rajoneve dhe polet e rritjes janë analizuar më tej në analizën mbi policentrizmin. Duke iu referuar kësaj analize policentrike dhe bërjes evidente të 6 poleve kryesore të rritjes, me përjashtim të Tiranës, e cila është zhvilluar në një sistem unazor, 5 qendrat e tjera paraqesin karakteristika të zhvillimit në formë radiale, duke krijuar lidhje të forta me qytetin kryesor bazë.

Nëse do të mernim këtë tip analize në konsideratë edhe kur i referohemi zonave ose rajoneve ndërkufitare, do të evidentonim se 5 zona kanë karakter unazor: rajoni me qendër liqenin e Shkodrës, rajoni me qendër liqenin e Ohrit, rajoni Adriatik, rajoni Jonian dhe rajoni me qendër historike Gjakovën. Gjithashtu dallohen edhe 3 lidhje lineare mes zonave/rajoneve ndërkufitare ku mund të përmendim: Vermosh-Plavë-Guci, Peshkopi-Dibër dhe Leskovik-Konicë. Rëndësia social-ekonomike dhe impakti që këto "Rajone Policentrike" dhe "Polet e Zhvillimit" kanë, janë mjaft të mëdha, ndaj edhe politikat e zhvillimit duhet të marrin parasysh edhe këto karakteristika.

Identitetet Rajonale

Në bazë të këtyre analizave, si dhe duke marrë në konsideratë aktivitetet kryesore ekonomike të çdo zone policentrike, identifikohen 6 identitete kryesore rajonale:
- Rajoni i Alpeve - ku kryeqendër është Shkodra. Konsiderohet si një rajon malor me potenciale ekonomike në zhvillimin e turizmit dhe prodhimit të energjisë. Ky rajon shihet gjithashtu si një portë hyrëse në lidhje me Malin e Zi dhe Kosovën;




- + Respects the existing borders of qarks;
- + Considers the river basins;
- + Brings regional governments nearer local communities and governments without big changes in terms of infrastructure and services provisions;
- + Promotes a broader and more democratic distribution of policentric regions.

Profillet Policentrike për secilin nga propozimet, Shqipëria me 3 dhe 6 rajone.
Polycentric Profiles for each proposal, Albania in 3 and 6 regions

- Rajoni i Arbrit - me kryeqendër Peshkopinë. Ka një prapavijë të fortë historike dhe tradicionale në formimin e kombit dhe të shtetit shqiptar. Ky rajon është i pasur në industrinë minierave, prodhimin e energjisë dhe shërben si portë lidhëse me Maqedoninë e Kosovën;
- Rajoni Metropolitan - me kryeqendër në Tiranë. Konsiderohet të jetë një hub ndërkombëtar dhe motorri kryesor ekonomik për vendin. Në këtë rajon janë të përqendruara institucionet kryesore qeveritare dhe shërbimet kryesore publike, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Rajoni i Voskpojës - me kryeqendër Korçën. Përfshin rajonin përreth liqenit të Ohrit dhe maleve të Korçës. Ky rajon është konsideruar të jetë një urë dhe portë lidhëse historike mes vendit tonë dhe Perëndimit e Lindjes (Via Egnatia). Ekonomia e këtij rajoni është bazuar kryesisht në zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë, sidomos pemëtarisë. Rajoni ka gjithashtu një identitet të fortë historik gjatë periudhës së mesjetës dhe rilindjes shqiptare;
- Rajoni i Myzeqesë - me kryeqendër Beratin, konsiderohet si “hambari” i kombit, për shkak të potencialit të madh për zhvillimin e bujqësisë. Por ky rajon është i pasur edhe me burime të naftës dhe të gazit, ndaj këto paraqiten si potenciale të tjera për zhvillimin e ekonomisë në këtë rajon. Gjithashtu një nga tre zonat shqipëtare që janë pjesë e UNESCO-s (Berati) është në këtë rajon, dhe zona e Skraparit ka gjithashtu potenciale turistike natyrore dhe kulturore;
- Rajoni i Jonit - me kryeqendër Gjirokastrën. Njihet për potencialin e tij të madh turistik, duke përfshirë “rivierën bregdetare” si dhe dy site të tjera që bëjnë pjesë në UNESCO (Gjirokastra dhe Butrinti). Ky rajon është gjithashtu i njohur edhe për potencialet e mëdha për zhvillimin e bujqësisë e blegtorisë.

Në përfundim, harta e përtuar nga identifikimi i 6 rajoneve dhe identiteteve të tyre rajonale është përdorur si një pikënisje për konceptimin e zhvillimit ekonomik të vendit dhe të planit hapësinor.



Polycentric Regions

After understanding the concept of the 6 regions of Co-PLAN several indicators were analyzed to help identifying the new regional identities. Based on the proximity within functional economic areas, there can be seen 6 main polarities, which go around: Shkodra, Kukës, Tirana, Korça, Vlora and Gjirokastra. The patterns of these regions and growth poles can be discovered on the Polycentrism analysis. Referring to this polycentric analysis and to the outline of the 6 main growth poles, with the exception of Tirana, which is developed on an annular system, the 5 other centers are developed on a radial system, connecting to the main core city.


When these analyses are confronted with the cross-border regions, 5 annular regions are identified: the Shkodra lake region, Gjakova region, Ohrid lake region, the Adriatic region and the Ionian Region. In addition 3 linear cross-border relations are also identified: Vermosh-Plava-Gucinje, Peshkopi-Dibra and Leskovik-Konit-sa. The social-economic importance and impact that these polycentric regions and growth poles have is quite big, therefore the development policies should consider these characteristics also.

Regional Identities

Based on these analyses, and also taking in consideration the main economic drives of each polycentric area, 6 regional identities were branded:

- The Alps Region, where Shkodra is the center, which is considered a mountainous region with economic potentials on tourism and energy production. It is also a gate to Montenegro and Kosovo;
- Arbri Region with the center Peshkopi, has a strong historic and traditional background in the formation of Albanian nation and state. It is rich on mining industry, energy production and serves as gate to Macedonia and Kosovo;
- Metropolitan Region with the center Tirana, is considered to be the international hub and economic drive for the country. In this region are concentrated the main governmental institutions and public services;
- Voskpoja Region with the center Korça, encompasses the region around Ohrid lake and Korça mountains. It is considered to be a bridge and a gate between West and East. Its economy is based on tourism and agriculture, and it has a strong historic identity during medieval age and Albanian revival;
- Myzeqeja Region with the center Berat, which is considered as “the granary” of the nation, because of its big potential on agriculture, but it is also rich on oil and gas resources and industry. One of three UNESCO sites is located in this region and the Skrapari area has also natural and cultural tourism potentials;
- Ionian Region with the center Gjirokastra is recognized of its huge potential on tourism, including the Ionian Riviera and two UNESCO sites (Gjirokastra and Butrinti). This region is also known for its farming potentials.


In conclusion to this, the map of the 6 regions and their identities are used as a starting point for the concept of economic development of the country and the spatial plan.



Rajonet Policentrike, Polet e Zhvillimit bazuar tek afërsia dhe funksionet.
 Polycentric Regions, Growth Poles referring to proximity and functions.

Infrastruktura Mbështetëse

Për sa i përket infrastrukturës kombëtare dhe rajonale që mbështet këtë organizim policentrik të vendit, në kuadrin kombëtar janë dy “koridore të rëndësishme paneuropiane” që kalojnë nëpër Shqipëri dhe kanë një impakt të konsiderueshëm: (i) Koridori “Blu”, ose “Via Adriatica”, ose Koridori i Bregdetit; (ii) dhe Koridori “VIII Paneuropian”, ose Koridori “Via Egnatia”. Por një koridor i tretë i rëndësishëm - “Rruga e Kombit” - është implementuar së fundmi falë vendimmarrjes ambicioze të autoriteteve shqiptare. Përpos këtij koncepti mbi infrastrukturën, ajo konsideron gjithashtu edhe pjesë të tjera të rrjetit infrastrukturor kombëtar, të cilat bëjnë të mundur lidhje më të mira dhe më të shpejta jo vetëm brenda për brenda secilit rajon, por edhe lidhje për rajonet midis tyre dhe me zonat ndërkuftare gjithashtu. Ky koncept konsideron “Korridorin i Adriatikut” si një linjë bazë infrastrukturore, nga e cila marin nismën (ose përfundojnë) një seri rrugësh të tjera, të cilat përshkojnë vendin në formën e rrezeve, duke lidhur pjesën perëndimore me atë lindore, dhe duke shkuar akoma më përtej, drejt zonave ndërkuftare, me të cilat vendi ynë ka lidhje



Rajonet Policentrike të Zonave Ndërkuftare, bazuar tek afërsia dhe funksionet.
 Cross Border Polycentric Regions referring to proximity and functions.


Back-Up Infrastructure

Regarding the national and regional infrastructure that supports this polycentric organization, on the national framework there are two main Paneuropean Corridors that pass through Albania and have a major impact: the Adriatic Corridor and Corridor VIII. A third corridor is added lately thanks to the ambitious decision making of the Albanian authorities, the Road of Nation. In addition to this, the concept considers also other important national roads, which make possible to connect all regions with themselves and with their core centers on the fastest and shortest way possible.

The concept considers the Adriatic Corridor as a base line and as a mother road. From the capital city several radial roads pass along the periphery of the country towards cross border regions, but the scheme introduces also two vertical access roads to break the isolation between several regions. This is the Central Albanian Axis from Puka to Memaliaj, and the Ring of Nation from Alps to Përmet.

të rëndësishme. Në këtë rast lexohen gjithashtu dy rrugë të rëndësishme vertikale, në formën e “unazave infrastrukturore”, përkatësisht të quajtura: (i) “Unaza e Kombit” (nga Shkodër-Alpet në Përmet-Sarandë); (ii) dhe më tej “Unaza Ballkanike”. Në pjesën qendrore të vendit, që është dhe zona më pak e integruar dhe më pak e zhvilluar, lind hapësira dhe nevoja për të implementuar të ashtuquajturin “Aksi Qëndror” (nga Puka në Memaliaj e deri në Kardhiq-Sarandë), i cili do të plotësojë këtë rrjet infrastrukturor me qëllimin e ndërlidhjes më të mirë territoriale të pjesës më të izoluar të vendit me skajet më të populluara e të zhvilluara. Ky sistem promovon avantazhet strategjike të Shqipërisë, si një portë dhe urë lidhëse midis detit Adriatik dhe “Koridorit të X Paneuropian” që kalon nga Beogradi në Shkup e Athinë, si korridori më i rëndësishëm Paneuropian në Ballkan.

Koncepti i mësipërm plotësohet më tej duke konsideruar edhe sistemin kombëtar hekurudhor. Dy janë veprimet kryesore që ky koncept prezanton: (i) së pari, përmirësimin e sistemit ekzistues, pjesa më e madhe e të cilit sot është e amortizuar; (ii) dhe së dyti, plotësimin e tij duke forcuar lidhjet me Malin e Zi dhe Maqedoninë, dhe duke krijuar lidhje me Kosovën e Greqinë, që është dhe mënyra më e shpejtë për t’u lidhur me sistemin hekurudhor Europian në vendet Ballkanike. Rigjenerimi dhe pasurimi i këtij rrjeti hekurudhor do të ndihmojë edhe në përmirësimin e transportit publik, do të nxisë më tej zhvillimin e turizmit në vend dhe do të përmirësojë gjithashtu performancën mjedisore të Shqipërisë.




Koridoret Kryesore Rrugore të Shqipërisë.
The main Corridors of Albania.

Such system promotes the strategic advantages of Albania as a bridge and gate between the Adriatic sea (and all the related Italian sea ports) and the Xth Paneuropean Corridor passing between Belgrade and Athens, as the most important Paneuropean Corridor in the Balkans.

This concept is complemented also with a vision considering the national railway system. This concept is based on two main actions:

First improving the existing network and strengthening the connection between Montenegro- Tirana in Albania- and Macedonia, which is the fastest way to connect with the European railway system in the Balkans.

The second action is the connection of the existing system with Kosovo, Macedonia, Greece and Italy through other nearest points. The connections with Macedonia and Greece are seen as strategic projects and very important interventions, because of the direct impact they have on making us part of the Balkan railway system, also opening opportunities for growing healthy relations with the rest of the Balkans and Europe. This full railway system will help to improve the environmental performance of Albania, will improve public transport and will also boost tourism industry in the country.




Sistemi Hekurudhor.
The Railway System.

4.5.3 Korridoret e Zhvillimit dhe Zonat e Lira Ekonomike

Leximi i Koridoreve Europiane

Duke u bazuar në prezencën e “Korridoreve Paneuropiane” në Shqipëri, dhe gjeo-strategjinë europiane de-facto të implementuar në Ballkan, është e qartë që çdo shtet përpiqet të forcojë marrëdhënien midis “Korridorit Adriatik” (duke përfshirë bregdetin dhe portet) dhe “Korridorit X”, duke investuar në korridore autostrada strategjike për lidhje të shpejtë dhe cilësore midis rajoneve kontinentale të Europës dhe pellgut Mesdhetar, me strategjinë për të maksimizuar transportin detar dhe tokësor. Një infrastrukturë e tillë e zhvilluar në dekadën e fundit duhet të jetë një model edhe për Shqipërinë. Prandaj propozohet zhvillimi i rrugës diagonale që fillon në rajonin metropolitan dhe Korridorin Adriatik drejt lindjes (Ballkani i brendshëm). Kjo nuk është vetëm strategjike për Shqipërinë, por promovon edhe bashkëpunim më të mirë mes perëndimit dhe shteteve ballanike.

Instrumenti i dytë është krijimi i “Korridoreve Unazore”. (i) Unaza e parë - është një prioritet kombëtar, sepse gjendet midis kufirit nacional dhe përgjatë luginës së kufirit lindor. Kjo është e rëndësishme sepse pas përqendrimit më të madh perëndimor, këtu ndodhet përqendrimi i dytë më i madh i popullsisë shqiptare brenda kufijve shtetërorë. Lidhje të tilla thejnë izolimin midis vendbanimeve urbane periferike lindore dhe kontribuojnë në efikasitetin e potencialeve turistike të Shqipërisë. (ii) Unaza e dytë - është jashtë territorit kombëtar, por kalon përmes territoreve shqipfolëse. Autoritetet shqiptare duhet të bashkëpunojnë me qeveritë e vendeve fqinje nëpërmjet projekteve kombëtare dhe ndërkuftare, për ta plotësuar dhe maksimizuar këtë korridor unazë që thuajse është ndërtuar pjesërisht, me interesa të përbashkët. (iii) Një instrument shtesë është edhe “Korridor i Shqipërisë Qendrore” që përpiqet gjithashtu të tejkalojë barrierat gjeografike, të thejë izolimin e të shkuarës dhe të promovojë përsëri potencialet turistike mes zonave të Kukësit dhe Gjirokastrës.




Gjeostrategjia Europiane (Koridori strategjik X).
European Geostrategy (the strategic Corridor X).

4.5.3 Development Corridors and Free Economic Areas

Reading of the European Corridors

Based on the presence of the main Paneuropean Corridors in Albania, and the de-facto European geo-strategy implemented in the Balkans, it's obvious that each country is trying to strengthen the relation between the Adriatic Corridor (including coast and ports) and the Corridor X by investing on strategic highway corridors for fast and qualitative connection between the continental regions of Europe and Mediterranean basin, with the strategy to maximize the sea and land transport. Such diagonal infrastructure that is developed on the last decades must be a model for Albania too. Therefore the development of diagonal routes starting from the metropolitan region and the Adriatic Corridor towards east (inland Balkans) is proposed. This is not only strategic for Albania, but also for Albanian speaking territories in the neighboring countries and it promotes better cooperation between west and Balkan countries.

The second instrument is the creation of radial road corridors. The first radial is a national priority, because it is within the national borders and along the valley of the eastern border. This is very important because after the biggest western concentration of population, here stays the second concentration of the Albanian population. Such connection breaks the isolation between the peripheral eastern urban settlements and contributes a lot to put in efficiency the touristic potentials of Albania. The second ring is outside the national borders, but it passes through the Albanian speaking territories. Albanian authorities must cooperate with the governments of neighboring countries through national and cross border projects to complete and maximize this ring corridor with mutual interests, which is also already partly built. An additional instrument is also the central Albanian Axis, which also tries to overcome the geographic barriers, break the isolation of the past and promote again touristic potentials between Kukës and Gjirokastra areas.



Lexime Konceptuale, Akset Diagonale dhe Unazore
Conceptual Readings, Diagonal Routes and Ring Routes Concepts.

Popullsia në Vite

Ky koncept shkon në një linjë me modelet e shpërndarjes ruralo-urbane të popullsisë së vendit. Analiza tregon se gjatë ekonomisë së centralizuar Shqipëria dominohej nga popullsia rurale dhe shpërndarja e favorshme e vendbanimeve në të gjithë territorin, edhe pse kjo imponohej nga mekanizma autoritare. Me njohjen e ekonomisë së tregut dhe lëvizjes së lirë, gjatë viteve 90-të, Shqipëria hyri në një proces radikal urbanizimi, ku popullsia u përqendrua në rrafshinën perëndimore, specifikisht në Shkodër, Tiranë, Elbasan, Berat dhe Vlorë, dhe luginën periferike lindore mes Kukësit, Peshkopisë, Pogradecit, Korçës dhe Gjirokastrës. Gjatë dekadës së parë të viteve 2000, urbanizimi vazhdoi duke u përqendruar në qytetet më të mëdha si Shkodra, zona metropolitane (Tirana, Durrësi, Elbasani), Fieri dhe Vlora, duke i shtuar përqendrimet lindore dhe pjesën e mbetur të popullsisë rurale.

Koncepti i kornizës së zhvillimit hapësinor dhe platforma e korridoreve infrastrukturale përipiqet të promovojë një balancim strategjik midis lindjes dhe perëndimit, veriut dhe jugut, dhe midis funksioneve ekonomike ndërkufitare. Kështu, popullsia mund të ndërmarrë aktivitete ekonomike në të gjithë vendin, dhe ku ekzistojnë tashmë burime natyrore, në mënyrë të pavarur nga qendrat e tyre të jetesës.

Nyjat, Portat dhe Rrjetet

Një lidhje e tillë mes zhvillimit hapësinor, infrastrukturës dhe demografisë përkrahet edhe nga analiza e korridoreve të zhvillimit dhe zona e ekonomisë së lirë. Hipoteza e kësaj pune kërkimore bazohet në deklaratën politike të qeverisë shqiptare dhe parlamentit, sipas së cilës ekonomia shqiptare është e bazuar tek turizmi, bujqësia, energjia dhe industria e minierave. Identifikimi i këtyre potencialeve ushqen vizionin kombëtar hapësinor. Përveç këtyre kategorive të performancës socio-ekonomike të vendbanimeve shqiptare, janë identifikuar tre modele tipologjike (pattern models) të zhvillimit ekonomik, përfshi: (i) nyjet, (ii) portat, (iii) dhe rrjetet:

- Nyja i referohet qendrës efektive, ku janë bazuar shërbimet kryesore dhe që shërben si një portë ndërkombëtare me Europën perëndimore dhe më gjerë. Në këtë perspektive, Tirana përfaqëson nyjen ndërkombëtare të shtetit;
- Porta i referohet lidhjes dhe marrëdhënies midis dy apo më shumë shteteve të kushtëzuara nga faktorët gjeografikë. Në këtë pikë, rajonet policentrike të Kukës-Dibër, Pogradec-Korçë, Durrës-Kavajë, dhe Vlorë-Gjirokastrë-Sarandë, përfaqëson 5 portat rajonale të shtetit;
- Rrjeti i referohet një grupi qendrash jetese, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën dhe formojnë zona funksionale ekonomike, brenda shtetit apo në një rajon ndërkufitar. Dy rajonet e tjera policentrike të Shkodrës-Lezhës dhe Vlorës-Fierit-Beratit përfaqësojnë rrjetet kombëtare-rajonale të Shqipërisë.

Përcaktimi i Koridoreve të Zhvillimit


Në vazhdim, ato janë korridore zhvillimi të identifikuara dhe zona ekonomike. Janë 5 tipologji kryesore të korridoreve të zhvillimit:

- Korridori Metropolitan (Durrës-Tiranë-Elbasan), ku janë bazuar shërbimet publike kryesore, dhe janë vendosur aeroporti dhe një nga portet më të rëndësishme detare;
- Korridori i Agro-Biznesit, ku bujqësia dhe biznese të tjera të lidhura me të janë prioritetet kryesore, jo vetëm për zhvillimin e zonës rajonale ekonomike por edhe për nga rëndësia kombëtare. Ekzistojnë dy korridore agro-biznesi në Shqipëri, të pozicionuara të dy në jug. (i) I pari, kalon përgjatë vijës Lushnjë-Fier-Ballsh-Vlorë, që është dhe toka më e pasur bujqësore në vend, e njohur kryesisht për perimet dhe drithërat; (ii) dhe i dyti kalon përgjatë zonës më të pasur me produkte frutore dhe pemishteve më të

Population in Years

This concept goes in line with the rural-urban distribution models of population in the country. The analysis show that during centralized economy Albania was dominated by rural population and fair distribution of living settlements all over the territory, although this was imposed by authoritarian mechanism. With the introduction of market economy and freedom of movement, during the '90s Albania entered a radical process of urbanization, where population was concentrated on the western plain, specifically in Shkodra, Tirana, Elbasan, Berat and Vlora, and on the eastern peripheral valley between Kukës, Peshkopi, Pogradec, Korça and Gjirokastra. During the first decade of 2000s, urbanization continued by concentrating on the bigger cities like Shkodra, the Metropolitan area (Tirana, Durrës, Elbasan), Fier and Vlora, drying up the eastern concentrations and the rest of rural population.

The spatial development framework concept and the platform of infrastructural corridors tries to promote a strategic balance between east and west, north and south, and cross border functional economic areas. Therefore the population can undertake economic activities all over the country, and where there already exist national resources, independently from their living centers.



Hubs, Gateways and Networks

Such relation between the spatial developments, infrastructure and demography is supported also by the analysis of the development corridors and free economic areas. The hypothesis of this research work is based on the political statement of the Albanian government and Parliament, that the Albanian economy is based mainly on tourism, agriculture, energy and mining industry. The identification of these potentials feeds the national spatial vision. In addition to these categories of the social- economic performance of the Albanian living settlements, there are identified three pattern models of economic developments: hubs, gateways and networks:

- The hub refers to the effective center, where the main services are based and which serves as an international gate to the Western Europe and broader. On this perspective Tirana represents the international hub of the country;

mëdha në Shqipëri, në vijën territoriale Përrenjas-Qafthanë-Pogradec-Maliq-Korçë-Bilisht;

- Korridori i Industrisë së Ndërtimeve dhe Mobiljeve, që kalon përgjatë vijës Krujë-Fushë/Krujë-Ishëm-Laç-Lezhë-Velipojë. Ai përfaqëson një aglomerat biznesesh të vogla dhe të mesme, të cilat janë vendosur aty për shkak të afërsisë me materialet e ndërtimit dhe tregut në rritje, sidomos në zgjatimin verior informal të metropolit.


- Korridoret e Turizmit Detar të Adriatikut dhe Jonit, përfaqëson zonat më të rëndësishme bregdetare të vendit, ku turizmi është forca shtytëse ekonomike, me një rëndësi strategjike kombëtare. Janë dy korridore me këto karakteristika: i) aksi qendror Golem-Kavajë-Rrogozhinë-Divjakë dhe ai jugor Dhërmi-Himara-Borsh-Finiq-Çukë-Sarandë;

- Korridoret Energjitike - Prodhimi i energjisë në Shqipëri është një çështje me shumë rëndësi. Që nga periudha e ekonomisë së centralizuar Shqipëria ka prodhur energji në mënyrë të pastër dhe të qëndrueshme duke përdorur burimet ujore në rajonin verior. "Pellgu i Lumit Drin" është korridori ekzistues kryesor i energjisë ujore. Ndërsa i dyti, është "Korridori TAP" që do të sigurojë energji gazi, duke balancuar nevojat e rajoneve jug-veri, dhe duke i shpërndarë burimet e prodhimit të energjisë në vend. Forma të tjera alternative të prodhimit të energjisë janë era dhe energjia diellore, të cilat duhet të zhvillohen akoma.

Zonat e Lira Ekonomike

Sipas zonave të zhvillimit të lirë ekonomik, janë konturuar 7 zona kryesore, të pozicionuara kryesisht në hapësirën midis qyteteve të kufirit strategjik dhe rajonet ndërkufitare (Shkodra-Podgorica, Kukës-Prizren-Gjakova, Pogradec-Ohër, Korçë-Selanik, Gjirokastër-Janinë, Durrës-Bari, Vlorë-Bari-Brindisi). Këto janë zona me akses të lehtë nga pikëpamja infrastrukturore, me leje të lehta zhvillimi dhe regjime fiskale stimuluese.

Strategjia merr në konsideratë edhe 7 zonat ekonomike / parqe industriale, që përfshijnë: Shkodrën, Koplkun, Shëngjnin, Lezhën, Spitalin në Durrës, Elbasanin dhe Vlorën; 3 aeroportet kryesore, 2 kombëtare (Kukës, Sarandë) dhe 1 ndërkombëtar (Tirana); si dhe 4 portet kryesore detare (Shëngjin, Durrës, Vlorë dhe Sarandë), secili prej tyre me një specializim sipas nevojave rajonale dhe kombëtare.



Skema e Ciklit Ekonomik
The Ekonomik Cycle Diagram

- The gateway refers to the connection and relations between two or more countries conditioned by the geographic factors. At this point the polycentric regions of Kukës-Dibra, Pogradec-Korça, Durrës-Kavaja, and Vlorë-Gjirokastra-Saranda represent the 5 regional gateways of the country;

- The network refers to a set of living centers, which complement each other and form functional economic areas, within the country, or on a cross border region. The two other polycentric regions of Shkodra- Lezha and Vlorë-Fier-Berat represent the national-regional networks of Albania.

Outlining Development Corridors

In continuation there are identified development corridors and free economic areas. There are 5 main typologies of development corridors:

- The Metropolitan Corridor (Durrës- Tirana- Elbasan), where the main public services are based, and where the airport and one of the most important sea ports are located;

- The Agro-Business Corridors, where the agriculture and other agriculture-related business are the very top priority, not only for the regional economic development, but also at a national importance. There are two agro-business corridors in Albania, both located on the south. The first one passes along Lushnja-Fieri-Ballsh-Vlorë, the richest agricultural land of the country, mainly known for its vegetables and grains production; and the second one goes through the richest fruit farming areas and the biggest orchards of Albania, Përrenjas- Qafthanë-Pogradec-Maliq-Korça-Bilisht;

- The Housing and Furniture Industry Corridor passes along Kruja- Fushë-Kruja-Ishëm-Laç-Lezha-Velipoja. It represents an agglomeration of small and medium size business, which are located there because of the proximity to the raw materials and the growing market, especially on the northern informal extensions of the metropolis;



- The Adriatic/Ionian Sea Tourism Corridors represent the most important coastal areas of the country, where tourism is the economic drive of a national importance. There are two corridors of such characteristics: the central axis of Golem-Kavajë-Rrogozhinë-Divjaka and the southern one Dhërmi-Himara-Borsh-Finiq-Çukë-Sarandë;

- The Energetic Corridors: energy production in Albania is a priority issue in the country. From the times of centralized economy until now, Albania has been producing energy on a clean and sustainable way using water resources mainly in the northern regions. The Drini river basin is the main existing water energy corridor, while the second one is the TAP (Trans Adriatic Pipeline), which will provide gas energy, balancing the needs of north-south regions, and diversifying sources of energy production for the country. Other alternative forms of energy production are wind and solar energy, which are still to be developed.


Free Economic Areas

Regarding the free economic areas, there are outlined 7 main areas mostly located on the space between the strategic border cities on the cross border regions (Shkodra- Podgorica, Kukës-Prizren-Gjakova, Pogradec-Ohrid, Korça-Thessaloniki, Gjirokastër-Ioannina, Durrës-Bari, Vlorë-Bari-Brindisi). These will be areas of easy-access regarding infrastructure, facilitated development permission and with stimulating fiscal regimes.

The strategy considers also the 7 economic areas/ industrial parks, including: Shkodra, Kopluk, Shëngjini, Lezha, Spital in Durrës, Elbasan and Vlorë; the 3 main airports, two national (Kukës, Sarandë) and 1 international (Tirana); and 4 main sea ports (Shëngjin, Durrës, Vlorë and Sarandë), each of which has a specialization according to the regional and national needs.



Potencialët Ekonomike; Njjet, Rrjetet dhe Portat.
 Economic Potentials; Hubs, Networks and Gateways.



Koridoret e Zhvillimit dhe Zonat e Lira Ekonomike.
 Development Corridors and Free Economic Areas.

Zhvillimi Ekonomik bazuar tek Bujqësia

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë sonë, duke kontribuar me rreth 21% të PBB-së (në vitin 2006). Familjet rurale (që jetojnë me bujqësinë) vazhdojnë të mbizotërojnë me mbi 50% të popullsisë dhe bujqësia përbën alternativën kryesore të zënies me punë të njerëzve në zonat rurale. Rritja mesatare reale në bujqësi gjatë pesë viteve të fundit është vlerësuar të jetë me rreth 3-3.5%/vit. Megjithatë, rritja e sektorit bujqësor është nën mesataren kombëtare dhe njëherësh, larg potencialeve reale. Kjo vjen si rezultat i problemeve, me të cilat përballet sektori, ku mbizotërojnë ato të lidhura me eksodin rural, sipërfaqen e kufizuar të fermave dhe pronësinë mbi tokën, marketingun e produkteve, ujitjen dhe kullimin, nivelin e ulët të teknologjive të përdorura, organizimin e dobët të fermerëve, nivelin e ulët të zhvillimit të industrisë agroushqimore, etj. Të gjitha sëbashku këto kushte dhe probleme ndikojnë negativisht mbi interesin për investime serioze për prodhimin e produkteve të ndryshme me natyrë agroushqimore.

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore zë rreth 24% (ose rreth 699,000 hektarë) të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Rreth 43% (ose 304,000 hektarë) e sipërfaqes bujqësore ndodhet në zonën fushore me cilësi përgjithësisht të mira prodhuese, rreth 34% (ose 239,000 hektarë) në zonën kodrinore dhe mbetja prej rreth 23% (ose 159,000 hektarë) është në zonën malore, e destinuar pothuajse tërësisht për kultivimin e pemëve frutore.

Bujqësia është e sunduar nga ferma me sipërfaqe të vogla (mesatarisht 1.13 hektarë) dhe të copëzuara në mesatarisht 3.9 parcela për fermë, me një madhësi mesatare prej 0.25 hektarësh. Parcelizimi i tokës bujqësore sjell një sërë vështirësish për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe ka bërë që përdorimi në shkallë të gjerë i mekanikës bujqësore të jetë i vështirë. Si rrjedhojë pasojat që vijnë nga ky fragmentarizimi i tokës janë:

- Alokim i joeficient i burimeve (fuqisë punëtore dhe kapitalit);
- Rritje e kostot së transportit;
- Humbje e kohës së fermerëve për rrugën nga shtëpia në parcelat përkatëse;
- Vështirësi dhe shpenzime edhe përsa i përket menaxhimit, mbikqyrjes dhe sigurisë;
- Ka shpërdorim të tokës pasi për secilën parcelë kërkohen gardhet përkatëse, kufinj të shtigjeve dhe rrugë;
- Në parcela aq të vogla nuk mund të rriten të gjitha llojet e prodhimeve.

Objektivat për Zhvillimin e Bujqësisë

Bujqësia është një nga potencialet kryesore të zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë, ndaj vendosja e objektivave dhe hartimi i politikave për të adresuar problematikat që ekzistojnë në lidhje me këtë fushë, si dhe për të realizuar një shfrytëzim më eficient dhe produktiv të tokave bujqësore, mbetet një nga prioritetet e Shqipërisë. Kështu ndër objektivat kryesore përmendim:

- Shkëmbimi i praktikave më të mira dhe krijimi i platformave për kërkim dhe zhvillim;
- Prodhimi i energjisë së biomasës, si një formë e rinovueshme e energjisë, praktikë që mund të promovohet sidomos në zonat e kontaminuara;
- Subvencionimi dhe përkrahja e praktikave të mira që lidhen me bujqësinë;
- Edukimi i fermerëve;
- Ulja e taksave për mjetet teknologjike;
- Rritja e taksave të importit;
- Krijimi i markave të produkteve bujqësore;
- Promovimi i prodhimeve bio;
- Rritja e aksesibilitetit të produkteve në tregje rajonale (krijimi i tregjeve rajonale);
- Rritja e aksesueshmërisë së tokave bujqësore;
- Vendosja e taksës për tokën e pashfrytëzuar.

Economic Development based on Agriculture

Agriculture is one of the main sectors of our economy, contributing with 21% of the GDP (2006). Rural families continue to dominate with over 50% of the population and agriculture constitutes to be the main occupation of people with jobs in rural areas. Average real growth in agriculture during the last five years is estimated to be around 3-3.5% / year. However, the growth of the agricultural sector is below the national average and at the same time, far from the real potentials. This comes as a result of the problems, which this sector is facing, related with the rural exodus, limited areas of farms and limited land ownership, poor marketing, poor irrigation and drainage, low level of technologies used, passive organization of poor farmers, low level of development of food industry, etc. All together these conditions and problems adversely affect the interest of serious investment for producing various agro-products.

The total surface of agricultural land occupies about 24% (or about 699,000 hectares) of the total surface of the country. About 43% (or 304,000 acres) of agricultural land is located in the lowland area, with generally good quality production, about 34% (or 239,000 acres) in the hilly areas and the remaining 23% (or 159,000 acres) is in the mountainous area, destined almost entirely for the cultivation of fruit trees.


Agriculture is mainly represented by small farms with a total surface (hectares 1:13 average) and is fragmented to an average of 3.9 plots per farm, with an average size of 0.25 hectares. Fragmentation of agricultural land brings a number of difficulties for the production and marketing of agricultural products, and has made large-scale use of agricultural machinery to be very difficult. As a result the main consequences arising from the fragmentation of agricultural and are:

- *Inefficient allocation of resources (labour and capital);*
- *Increased transport costs;*
- *Loss of time (farmers travel daily from their homes to their lands);*
- *The difficulty and expense in terms of management, surveillance and security;*
- *Misuse of agricultural land as each parcel needs its own fences, borders, paths and roads;*
- *In such small plots can not grow all kinds of products.*


Objectives for the Agricultural Development

Agriculture is one of the main potentials for the economic development of our country, so setting goals and policies to address the problems that exist and to achieve a more efficient and productive use of agricultural land, still remains one of the priorities of Albania. Thus the main objectives are:


- *Exchange of the best practices and the creation of platforms for research and development;*
- *Production of biomass energy, as a renewable form of energy, a practice that can be promoted especially in contaminated areas;*
- *Subsidy and support of the best practices related to agriculture;*
- *Education of farmers;*
- *Reduce taxes on technological machines and tools;*
- *Increased import tax;*
- *Creating brands of agricultural products;*
- *Promotion of organic products;*
- *Increasing the accessibility of products in regional markets (creation of regional markets);*
- *Increasing the accessibility of agricultural lands;*
- *Taxing the unused land.*



*Tokat Bujqësore dhe Rajonet Bujqësore.
Agricultural Lands and the Agricultural Regions.
(S.Haxhija, L.Allkja, "Regional Planning", Polis University, 2013)*




Qytete qe skane nevojte per brez te gjelber



Qytete te rrethuara plotesisht me brez te gjelber




Qytete qe rrethohen pjeserisht nga brezi gjelbert




*Konsolidimi i tokave Bujqësore; Prezantimi i Brezave të Gjelbër
Consolidation of the Agricultural Lands; Presenting the Green Corridors
(S.Haxhija, L.Allkja, "Regional Planning", Polis University, 2013)*



Specializimi per produktet bujqesore Prodhimi i biomass energy



Promovimi i produkteve bio Taksat mbi token e pashfrytezuara



Krijimi i tregjeve nderajonal



Objektivat për tokat Bujqësore të përkthyer në veprime territoriale.
Objectives for the Agricultural lands, translated into territorial actions.
(S.Haxhija, L.Allkja, "Regional Planning", Polis University, 2013)

Objektivat për tokat Bujqësore të përkthyer në veprime territoriale.
Objectives for the Agricultural lands, translated into territorial actions.
(S.Haxhija, L.Allkja, "Regional Planning", Polis University, 2013)

Zhvillimi Ekonomik bazuar tek Turizmi

Shqipëria ka potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e një turizmi që siguron zhvillim ekonomik afatgjatë dhe prosperitet social e mjedisor. Shqipëria sot konsiderohet një nga 10 ekonomitë me rritje më të shpejtë të turizmit krahasuar me GDP-në. Ajo rekomandohet sot si një nga 10 destinacionet kryesore aktuale të turizmit në botë. Vendi ka 450 km bregdet, nga të cilat 300 km në detin Adriatik, dhe 150 km në detin Jonian. Aty gjenden rreth 24 zona potenciale, shumica ende të virgjëra, për zhvillim cilësor turizmi. Ndërkohë më shumë se gjysma e sipërfaqes së vendit janë zona malore me mbi 600 m mbi nivelin e detit, dhe aty ndodhen edhe 15 zona të tjera që kanë gjithashtu potencial për zhvillimin e turizmit. Prandaj, konkluzioni kryesor këtu mbetet realizimi i një sistemi aksesi kombëtar përmes një rrjeti pragmatik rrugor, i ndjeshëm ndaj mjedisit dhe pejzazhit, sipas skemës radial-unazore të transportit të propozuar.

Por përveç potencialit të zonave turistike të “diellit dhe rërës”, Shqipëria ka mjaft potenciale të tjera në brendësi të vendit, përfshi:

- (i) Tre liqene (Shkodër, Ohër dhe Prespë), një rrjet liqenesh të vegjël (Dumre, Lurë, etj) dhe dhjetra liqene artificiale të ndërtuara gjatë komunizmit. Vendi ka 15 parqe kombëtare, zona të ndjeshme ekologjike-emeralde, dhe zona të tjera pyjore kudo.
- (ii) Ekziston një trashëgimi e pasur arkeologjike e periudhave Ilire, Romake, Helene, Bizantine, Veneciane, Otomane, etj, përfshi: Butrintin (UNESCO), Apolloninë, Bylis dhe Durrësin. Ka edhe mjaft manastire, kisha dhe kështjella e fortifikime mesjetare, etj. Vendi ka dy qytete muze: Berat dhe Gjirokastrën (UNESCO), dhe mjaft të tjera me cilesi të veçanta arkitektonike.
- (iii) Kultura shqiptare ka larmi besimesh fetare, folklori, traditash dhe kostumesh popullore; shumëllojshmëri punimesh artizanale e kulinarie; njerëzit janë miqësorë e mikpritës me të huajt dhe përgjithësisht johin gjuhët e huaja. Klima është e mirë me diell dhe me një sezon relativisht të gjatë veror.

Pra potencialet janë të jashtëzakoshme. Ajo që ka munguar është sensibilizimi i popullsisë, ngritja e kapaciteteve vendore publike e private, dhe mungesa e vizionit dhe politikave në shkallë kombëtare. Këtu konkluzioni hapësinor është se Shqipëria duhet të diversifikojë menunë e saj turistike përtej zonave të plazheve dhe sezonit veror, duke promovuar një menu destinacionesh dhe itinerarësh në brendësi të vendit, që mund të kultivohen përmes instrumentave të planifikimit hapësinor. Kjo do të thotë që krahas planifikimit të rajoneve turistike si: Riviera, Alpet, Ohër-Prespë, dhe Metropoli; duhet të planifikohen edhe të paktën 6 itinerare turistike me karakter kulturor-pejzazhistik-historik të tilla si: itinerari Myzeqesë; itinerari i kulturës Bektashi, itinerari i “Ali Pashës”, itinerari i “Skënderbeut”, itinerari “Via Egnatia”, itinerari i “Rrugës së Kombit”, etj. Kjo stimulon zhvillim ekonomik lokal në zonat e periferike e braktisura, dhe rikthimin e popullsisë.

Në aspektin hapësinor Shqipëria përballet sot me sfidën e kapaciteteve të reduktuara fizike për akomodimin e kërkesës në rritje për turizëm. Sipas INSTAT, në Shqipëri:

- (i) Numri i vizitorëve total që hyjnë në vend përmes të gjitha mjeteve të transportit (ajër, tokë, det) është 10 fishuar nga 300 mijë në 1995, në 3,3 milionë në 2013;
- (ii) Numri i vizitorëve në hotele është rritur nga 140 mijë në 1995, në 220 mijë në 2013, nga të cilët numri i të huajve është 3 fishuar nga 40 mijë në 120 mijë;
- (iii) Ndërkohë netët e qëndrimit të vizitorëve në hotele janë dyfishuar nga 200 mijë në 1995, në 400 mijë netë në 2013. Nga këto, numri i netëve të qëndrimit të vizitorëve të huaj në të njëjtën periudhë ka evoluar dy herë e gjysëm (nga 90 mijë në 220 mijë netë). Pjesa tjetër janë pushues shqiptarë;
- (iv) Kjo kërkesë në rritje është shoqëruar nga shtimi i kapaciteteve akomoduese nga 60 hotele me 2,000 shtretër në vitin 1995; në 300 hotele të licensuara dhe 10,000 shtretër në vitin 2013; duke 5-fishuar kapacitetet në dy dekada.

Economic Development based on Tourism

Albania has valuable potentials for the tourism development, that ensures long-term economic development and social-environmental prosperity. Albania is considered nowadays as one of 10 fastest growing economies, compared to its own GDP, and it is recommended as one of the world's top 10 touristic destinations. The country has 450 km coastal line, of which 300 along the Adriatic sea, and 150 along the Ionian sea. On these areas are located 24 areas of qualitative touristic potentials, mostly on virgin and undeveloped territories. On the meantime, more than half of the country's surface is mountainous, above 600m from the sea level, and on these areas we find 15 more areas of touristic potentials. So based on these facts, the main conclusion is the implementation of a national system of access and a pragmatic network of roads, sensitive towards environmental values and to the unique landscape, on basis of a ring-radial transportation and circulation system.

Despite the considerable potentials of the “sun & sand” type of tourism, Albania has other potentials inside its own territory, including:

- (i) Three lakes (Shkodër, Ohër, Prespa), a network of small lakes (Dumre, Lurë, etc.), and many artificial reservoirs built during the communism time. The country has also 15 national parks, and 25 emerald-ecologic sensitive areas, and lots of forests everywhere;
- (ii) There exists a rich archeological heritage of Ilirian, Greek, Roman, Byzantine, Venetian, Ottoman character, including: Butrinti (UNESCO), Apollonia, Bylis, Durrës, etc. But there are also many monasteries, churches, mosques, castles and fortifications of medieval age, including two museum cities: Berat and Gjirokastra (UNESCO), and many others of special architectural character;
- (iii) Albanian culture has a rich variety of religions, folklore, traditions and costumes; a diversity of craft works and culinary; people are hospitable and friendly with foreigners, and also speak foreign languages. The climate is good and sunny for long summer time.

So the potentials are incredible, but what has been missing is the sensibilization of population; capacity building for the local public and private actors; and lack of national spatial visioning and policies. The spatial conclusion here is that Albania must diversify and extend its own touristic menu, beyond coastal areas and summer seasons, by promoting combined products of destinations and itineraries at inland regions; which could be cultivated through instruments of spatial planning. Meaning that, despite the territorial planning of strategic touristic regions, like: Riviera, the Alps, Ohër-Prespa, and Metropolis; we must also plan at least six identified touristic itineraries with cultural-landscape-historic character, such as: “Via Egnatia” itinerary, “Scanderbeg” itinerary, “Ali Pasha” itinerary, “Bektashi culture” itinerary, “Myzeqeja” itinerary, “The Nation's Road” itinerary, etc. This stimulates local economic development and return of local people to the peripheral-abandoned areas.

At spatial dimensions, Albania is confronting today the challenge of limited physical capacities for the accommodation of the growing demand on tourism. According to INSTAT Albania:

- (i) The number of total visitors that enter our country by different means of transport (land, air, sea) has increased 10 times out of 300 thousand in 1995, to 3.3 million in 2013;
- (ii) The number of visitors in hotels has grown from 140 thousand in 1995, to 220 thousand in 2013; while the number of foreigners has tripled out of 40 thousand, to 120 thousand visitors;
- (iii) The number of visitors' nights-stay in hotels are doubled from 200 thousand in 1995, to 400 thousand nights in 2013. Out of them, the number of stay-nights for the foreigner visitors has been grown 2.5 times for the same period. Others are local albanian visitors;
- (iv) Such growing demand is associated by the increase of accommodation capacities from 60 hotels and 2,000 beds in 1995, to 300 hotels and 10,000 beds in 2013; which means a 5-time increase of capacities in 2 decades.

Konkluzioni këtu është se vendi ka një sfidë të madhe hapësinore që kërkon ngritjen urgjente të kapaciteteve akomoduese, dhe të paktën 2-3 fishimin e tyre në vitin 2030. Në shifra kjo do të thotë që vendi duhet të shtojë të paktën edhe 15-20 mijë shtretër të tjerë për të kapur një treg prej të paktën 7 milionë vizitorësh në vitin 2030, dhe për të komplementuar ose konkuruar me vendet fqinjë, të cilat kanë një treg të konsoliduar falë traditës prej disa dekadash. Por kjo duhet realizuar pa shkaktuar “fluska” të reja krize imobiliare dhe duke respektuar mjedisin dhe pejzazhin si aset unikal i vendit. Për këtë instrumentat zhvillimorë realizohen përmes: (i) rehabilitimit, rifunksionalizimit dhe ripërdorimit maksimal të fshatrave historike, të zonave tradicionale, dhe të vendbanimeve ekzistuese ose informale, sesa hapjen e zonave të reja për zhvillim; (ii) nxitjen e investimeve cilësore për një numër të kufizuar zonash hotelerie dhe fshatrash turistike me standard të lartë, të cilat duhet të shërbejnë si magnet dhe agupunkturë për energjizmin e zhvillimit dhe punësimit lokal, si dhe rritjen e kërkesës nga vizitorë elitare. Kjo mund të stimulojë edhe rritjen e investimeve të huaja në këtë infrastrukturë.

Sa i takon infrastrukturës të aksesit ndërkombëtar Shqipëria ka një sfidë tjetër hapësinore për të thyer izolimin e trashëguar dhe për të stimuluar hapjen dhe turizmin. Nga analiza e aksesit ndërkombëtar të tregut ekzistues 3 milionësh të vizitorëve del se:

- (i) udhëtimet nga deti janë 2 fishuar - kjo vjen kryesisht nga emigrantët e shumtë shqiptarë në vendet e BE-së, dhe nga përmirësimi i porteve dhe cilësisë së trageve vitet e fundit, etj.;
- (ii) udhëtimet nga ajri janë 6 fishuar - për shkak të ndërtimit të aeroportit të ri ndërkombëtar në Tiranë, rritjes së cilësisë së shërbimit përmes konçesionit privat; dhe prezantimit të konkurrencës përmes linjave ajrore private e me kosto të ulët, etj.;
- (iii) Udhëtimet nga toka janë 15 fishuar - për shkak të emigracionit të madh shqiptar në Greqi, rritjes së mirëqenies; të vizitorëve kryesisht shqiptarë nga Kosova, Maqedonia e Serbia; si dhe të fluksit në rritje nga vendet ish-komuniste tashmë antare të BE-së, si: Poloni, Çeki, Slovaki, Hungari, etj.

Konkluzioni në aspektin hapësinor këtu është se Shqipëria duhet të fokusohet në mënyrë progresive tek sigurimi i një zinxhiri eventesh e ngjarjesh me karakter ekonomik-kulturor-turistik në gjithë territorin, përmes infrastrukturës strategjike brenda vendit dhe në rajonin fqinj. Në këtë aspekt vendi duhet të përdorë më mirë edhe potencialet bujqësore dhe blegtorale, të cilat në kombinim me format e tjera të turizmit mund të plotësojnë ciklin, duke i dhënë zhvillim edhe agro-turizmit, kulinarisë dh bio-produkteve, duke promovuar më tej produktet vendase.

Në këtë kontekst, disa nga ndërhyrjet strategjike hapësinore për të promovuar dhe shtyrë më tej zhvillimin e turizmit në vend janë:

- (i) përmirësimi i infrastrukturës kufitare dhe aksesit rrugor për të përballuar dhe lehtësuar ritmin në rritje të hyrjeve, sidomos në sezonin veror dhe të festave kombëtare dhe fetare. Kjo lehtëson ruajtjen e tregut të brendshëm dhe shqiptarëve në emigracion; tregun e territoreve shqip-folëse të Kosovës, Maqedonisë dhe vendeve të tjera të Evropës Juglindore;
- (ii) aktivizimin e 2 aeroporteve rajonale në Kukës dhe Sarandë, për të afruar destinacionet si Riviera dhe Alpet me tregun në rritje të vendeve të BE-së dhe Amerikës së Veriut, të cilët kanë fuqi paguese më të mirë, por aktualisht humbin interesin për këto zona, pasi hyrja aktuale vetëm përmes Tiranës humb kohë;
- (iii) përdorimin e infrastrukturës fqinje-rajonale për të përfituar nga turizmi ndërkufitar duke përfshirë porte, aeroporte, dhe rrugë e pika hyrëse kufitare. Në mënyrë të veçantë aeroportet: Podgoricë, Prishtinë, Ohër, Janinë, Korfuz; dhe portet në Bari, Brindisi, Ankona, Trieste, Koper. Kjo duhet shoqëruar me aktivizimin e një linje bregdetare që shërben gjithë portet, plazhet e molet kryesore të bregdetit Shqiptar. Si dhe të një linje bregdetare lundrimi që shërben portet kryesore përgjatë bregdetit Adriatik-Jonian, nga porti Koper (Slloveni), deri në Patra (Greece).

Conclusion here is that Albania has another challenge, which needs urgent capacity development on accommodation, by at least 2-3 times growth in 2030. In figures, it means that the country must expand its capacity with at least 15-20 thousand new beds, aiming to support a demand of 7 million visitors per year by 2030; and complementing and/or competing with neighboring countries with historic consolidation of turistic demands.



However, this must be done without causing new real-estate “bubbles” and in conformity with unique environmental and landscape values. For this purpose the main planning and development instruments will be: (i) rehabilitation, revival, ricontextualization, and maximal reuse of the historic villages and traditional areas of the existing settlements and informal developments – instead of opening new development areas, with costs on territorial consumption; (ii) encouraging qualitative investments for a limited number of areas of serious and good quality hotels and resorts on small scale, which can serve as magnets or have an agupuncture effect for energysing local development and employment, as well as demand increase from the elitarian visitors. This can stimulate also the increase of foreign investments in such specialised infrastructure and working culture.

As regarding the infrastructure of international access, Albania has another challenge in order to break down the inherited isolation of communication. The analysis of the access for the existing demand of 3 million visitors shows:


- (i) Sea-travellings are doubled, thanks to the high volume of the Albanian emigrants in EU “western” countries; as well as from the improvements of ports and ferry services during the last years;*
- (ii) Air-travelling has increased 6 times, thanks to the construction of the new international airport in Tirana; the increase of quality of service because of concession privatization, and because of the introduction of competition by the private sector and low-cost flights;*
- (iii) Land-travelling has increased 15 times, mainly because of the huge emigration in Greece; of the regional visitors from other Albanian speaking territories (Kosova, Macedonia, Serbia) and the region in general; as well as the increasing influxes of visitors from “eastern” EU countries like: Poland, Czech Republic, Slovakia, Hungary, etc.*

A conclusion on the spatial character is that Albania must focus progressively on ensuring the chain of events and activities of economic-cultural-touristic character all over the territory; including the use of: religious festivals, bio- and local products, and agrotourism activities; as well as a more strategic use of infrastructure within and in the neighbouring countries:

- (i) improving border infrastructure and road-access, in order to confront and ease the growing rhythm of entries, especially during summer season or on national-religious days. This facilitates the protection of the internal demands and of the Albanian emigrants; the demand of other Balkan countries, and especially that of other Albanian speaking territories;*
- (ii) activating 2 regional airports in Kukës and Saranda, in order to reach directly and by saving time the main national touristic destinations like: Riviera and the Alps; and connecting them with the EU, Japanese and North American markets;*
- (iii) using regional-neighboring infrastructure in order to benefit from the “crossborder” tourism, including borders, roads, ports and airports, especially the airports of Podgorica, Prishtina, Ohrid, Ioannina, Corfu; and ports of Bari, Brindisi, Ancona, Trieste and Koper. This must be followed by the activation of a national sea-line along the Albanian coast, which will ensure the connection of different sea-side cities and towns by the sea; as well as an Adriatic-Jonian route along the western Balkan coast, from Koper (Slovenia) to Patra (Greece), connecting all the countries.*



Vizioni i Rajonit të Rivierës Shqiptare, MetroPolis + Sealine, 2014
 Vision on the Riviera Region, south of Albania, MetroPolis + Sealine, 2014



4.5.4 Potencialet Natyrore dhe Korridoret e Gjelbërt

Rreziqet dhe Potencialet Kryesore

Nuk mund të ketë rritje ekonomike pa zhvillim të qëndrueshëm, prandaj çështjet që lidhen me mjedisin dhe qëndrueshmërinë janë shumë të rëndësishme në çdo analizë hapësinore. Nga pikëpamja gjeografike, Shqipëria është një vend me një terren dominant kodrinor-malor, prandaj ekzistojnë 3 karakteristika kryesore topografike të bazuara në lartësitë mesatare: fushat, kodrat dhe malet. Një topografi e tillë mund të jetë një avantazh apo barrierë për zhvillimin e shtetit.

Në aspektin e çështjeve ambientale, janë identifikuar zonat kryesore kombëtare problematike dhe “hot spots” dhe ato janë të pozicionuara kryesisht në rrafshinën perëndimore të vendit, për shkak të efekteve të urbanizimit, mungesës së infrastrukturës së mbeturinave të ngurta dhe shërbimeve në një shoqëri konsumiste në rritje, dhe për shkak të problemeve të trashëguara nga e kaluara në lidhje me shkarkimet industriale dhe humane, kolapsin e industrisë, etj, të cilat kanë ndotur shumë zona dhe lumenj. Probleme të tjera ambientale lidhen me ndotjen dhe pakësimin e sipërfaqeve pyjore, erozionin në male, ndotjen për shkak të industrisë minerare dhe ekzistencës së zonave të minuara për shkak të aksioneve ushtarake të Luftës së Dytë Botërore, izolimit gjatë komunizmit dhe konfliktit në Kosovë. Por Shqipëria ka edhe potenciale të shkëlqyera përsa i përket pejzazhit dhe itinerareve historike natyrore. Kjo mund të jetë e rëndësishme për edukimin e ndjeshmërisë ambientale dhe kulturore, si dhe për rritjen ekonomike nëpërmjet turizmit dhe kultivimit e identitetit kombëtar.

Për këtë arsye janë identifikuar 6 itinerare kombëtare dhe ndërkuftare:

1. Itinerari i Alpeve (veriu)
2. Itinerari Skënderbej (Diber-Krujë-Lezhë)
3. Itinerari Rruga Egnatia (Durrës-Elbasan-Pogradec)
4. Itinerari Bektashi (Berat-Skrapar-Permet)
5. Itinerari i Rivierës Joniane (Vlorë-Himarë-Sarandë)
6. Itinerari Ali Pasha (Tepelenë-Gjirokaster-Janinë)

Por potenciale të tjera pejzazhistike më të vogla dhe itinerare kombëtare historike mund të gjenden në çdo rajon, apo zonë specifike. Për t`iu adresuar këtij problemi, duhet zhvilluar një strategji e veçantë. Zgjidhja e një çështjeje të tillë do të arrihet duke kombinuar në një rrjet tokën bujqësore dhe zonat e mbrojtura ekzistuese, me zgjatime dhe korridore të reja të gjelbërta, me synim krijimin e një strategjie kombëtare të gjelbërt, e cila kuron problemet ekzistuese ekologjike, përmirëson cilësinë e jetës dhe ndihmon në marketimin e Shqipërisë së të ardhmes me standarte më të larta.

Zonat e Mbrojtura dhe Zonat Emerald

Për momentin janë listuar 54 zona të mbrojtura, të cilat kategorizohen në 6 grupe: (i) Rezervë Strikte Natyrore; (ii) Park Kombëtar; (iii) Monument Natyror; (iv) Rezervë Natyre e Manaxhuar; (v) Peizazh i Mbrojtur; (vi) Zonë e Mbrojtur i Një Burimi të Manaxhuar. Shqipëria ka gjithashtu 25 zona ekologjike emerald, të cilat prezantojnë edhe një perpjekje të vendit tonë për të aksesuar projekte të BE-së, si p.sh. Natura 2000.

Shtimi dhe konsolidimi i zonave të gjelbërta dhe atyre emerald synon të paktën të trefishojë hapësirën e gjelbërt në Shqipëri, ndërsa zonat e mbrojtura ekzistuese rriten nga 15% në 30% të territorit kombëtar, që shkon edhe në linjë me direktivat e BE-së. Ky proces konsolidimi do të kontribuojë në radhë të parë për mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve, por gjithashtu edhe për mbrojtjen e tokave bujqësore ndaj urbanizimit, duke krijuar kufij të qartë në shembullin e korridoreve të gjelbërta, midis kategorive të ndryshme të përdorimit të tokës.

4.5.4 Natural Potentials and Green Corridors

Main Threats and Potentials

There cannot be economic growth without sustainable development, therefore the issues of environmental concern and sustainability are very important on any spatial analysis. From the geographic point of view Albania is a country dominated by hilly-mountainous terrain, therefore exist three main topographic characteristics based on the average altitudes: plains, hills and mountains. Such topography could be an advantage, or a barrier for the development of the country.

On terms of environmental concerns, there were identified the main national hotspot areas and they're mainly located on the western plain area of the country, because of the urbanization effect, lack of solid waste infrastructure and services in a consumerist growing society, and because of inherited problems of the past from the industrial and human discharges, which have polluted many rivers and sea areas. Other environmental problems are related with the shortage of forest surfaces, erosion on the mountains, pollution because of mining and the existence of mining areas due to the military actions of the Second World War, and isolation during communism and conflict in Kosovo. But Albania has also amazing potentials of landscaping and natural historic itineraries. This could be important for the education of environmental and cultural sensitivity, as well as for the economic growth through tourism and cultivation of national identity.

For this reason 6 national and cross border itineraries are identified:



1. Alps Itinerary
2. Skanderbeg Itinerary
3. Via Egnatia Itinerary
4. Bektashi Itinerary
5. Ionian Riviera Itinerary
6. Ali Pasha Itinerary

But other smaller landscape potentials and historic national routes can be found on each region, or specific area. In order to address such problematic, a special strategy was developed. Combining in a network agricultural lands, existing protected and emerald areas, with new green extensions and corridors, aiming to create a national green strategy, which cures the existing ecological problems, improves quality of life and helps branding a future Albania of high standards, will be the answer of such issue.


Protected and Emerald Areas

At the moment there are 54 listed protected areas, which categorize into 6 main groups: (i) Strict Nature Reserve; (ii) National Park; (iii) Nature Monument; (iv) Managed Nature Reserve; (v) Protected Landscape; (vi) Protected Area of Managed Resources. There are also 25 ecological emerald areas, which represent an effort to prepare Albania to access EU projects, like Natura 2000.

The extension and consolidation of Green and Emerald areas aims to at least triple the green space in Albania, while the existing protected areas increase from 15% to 30% of the national territory, which also goes in line with the EU directives. This consolidation process will also make up for the protection of these areas at first place, and secondly for the protection of the agricultural land against the urbanization, outlining clear borders on the example of green corridors, between these categories of land use.



Terreni Shqipëtar dhe Lartësitë Mesatare; Hopsotet Kombëtare
Albanian Terrain and Average Altitudes; National Hotspots.



ALPS ITINERARY

- SHKODËR
- KOPLIK
- KËLMËND
- VERMOSH
- THEFTI
- PLAVË
- GUCINË
- VALBONË
- LËRIBIBAJ
- BAJRAM CURRI
- BULIAN
- HAS
- KUKËS
- PRIZREN
- GJIRKOVË

SKANDERBEG ITINERARY

- KAFË OJ RRODINI
- PREZE
- VOJË
- PETRELE
- PELLUMBAS
- DËJT
- KRUIJA
- QANËSTANAMA
- LAÇ
- MILOT
- IULEZ
- BURREL
- BULOZHA
- DIBËR
- LEZBË
- SHENGIN
- RAMA E HEBRIN
- VËLIPËRË
- UÇINI

VIA EGNATIA ITINERARY

- DURRËS
- KAVAJA
- BIRGODHINA
- PEGIN
- TIRANA
- ELBASAN
- GJIRAR
- POLIS
- LIBRAZHID
- FERIZADIS
- QAFTHANË
- POGRADEC
- OHRID
- STRUGA
- PRESPA
- KURÇA
- DARBIDA
- VOSKOPJUA
- ERECKA

BEKTASHI ITINERARY

- 3 UJAT
- LESKOVIK
- PERMET
- KEÇYRE
- GJAVË
- FRASHER
- ÇORVODE
- POLÇAN
- KUÇOVË
- URVAJAGRORE
- JAYZEDE
- DIVJAKE
- KARAVASTA



ALI PASHA ITINERARY

- DARRINIA
- POGON
- ZAGORI
- ÇUJUP
- TEPELINE
- LUKATERRI
- GJIRKASTËR
- LURBOVË
- DRIPULL
- KAKAVIË

IONIAN RIVIERA ITINERARY

- MARTA
- JIORA
- RADHIME
- ORIKUM
- KARABURUN
- DHERMI
- HIMARA
- BOSH
- LUKOVË
- FHIQ
- JARANDA
- DELVINE
- KSAMIL
- BUTRIT
- VONOSPOL


Itineraret Kryesore Kombëtare Alternative dhe Panoramike.
Main Alternative and Panoramic National Itineraries.



TOKE E URBANIZUAR DHE KULLOTA ____ Zona e urbanizuar, Laç-qyrsaçi, karakterizohet nga banesa 2-3 kate, dhe kulla të vjetra. Përreth ka kullota dhe toka me pemë të ndryshme. Kullotat kanë një shtrirje të gjerë dhe përbëjnë ushqimin bazë për bagëtinë dhe dhentë e zonës.



TOKE ME SHKURRE DHE ME PYJE ME FLETË TË NDRYSHME ____ Zona nuk është e banuar. Karakterizohet nga veprimi masiv i erozionit. Lepuri i egër dhe ujku, janë dy kafshët kryesore të zonës.



OBJEKTIVAT KRYESORE

OBJEKTIVAT DYTESORE

TERRITORI NATYROR

- 1. Mbrojtja e territorit nga rreziqet natyrore dhe nga aktivitetet njerezore
- 2. Përcaktimi i zonave të reja në mbrojtje
- 3. Identifikimi i itinerareve natyrore

- 1. Shtimi i bimesise dhe punimeve fortifikuese kunder erozionit
- 2. Rivleresimi i minierave
- 3. Administrimi dhe kthimi i zonave pergjate rrjedhes se Drinit, ne pasuri natyrore te mbrojtur, duke e dhene prioritet zhvillimit per arsye turistike
- 4. Mbrojtja e zonave natyrore te inerteve & restaurimi i zonave te demtuara

TERRITORI BUJQESOR

- 1. Mbrojtja e territorit bujqesor
- 1. Zhvillimi i kulturave bujqesore dhe blegtorise

- 1. Konsolidimi i tokave bujqesore dhe kullotave ne entitete me te medha ekonomike
- 2. Krijimi i nje tregu te perbashket dhe te organizuar per shitjen e prodhimeve bujqesore dhe blegtorale

TERRITORI URBANIZUAR

- 1. Përcaktimi i kufijve të territorit të urbanizuar
- 2. Forcimi i tipareve karakteristike të identitetit lokal të çdo zone të banuar
- 3. Ruajtja, rehabilitimi dhe promovimi i pasurive historike dhe kulturore

- 1. Shmangia e shperhapjes urbane, permes menaxhimit dhe administrimit me te mire te terrioreve urbane
- 2. Promovimi i nje zhvillimi urban permes logjikes se policentrizmit ne zone
- 3. Fuqizimi i dy pikave fokale permes karakterit te tyre historik e kulturor

INFRASTRUKTURA

RRJETI RRUGOR

- 1. Kategorizimi i rrugeve, sipas cilesise dhe gjendjes se tyre
- 2. Plotimesi i sistemit rrugor ne segmentet ku ai mungon

- 1. Zgjerimi dhe permiresimi i rrugeve kryesore dhe me me shume fluks
- 2. Krijimi i nyjeve infrastrukturore midis nderprerjes se rrugeve kryesore

RRJETI HEKURUDHOR

- 1. Rehabilitimi dhe venia ne pune e rrjetit hekurudhor

- 1. Krijimi i nje stacioni te ndermjetem prane zones

RRJETI UJOR


- 1. Shfrytëzimin me qellim lundrimin, e rrjedhes se Drinit te Bashkuar

- 1. Shfrytëzimi i lundrimeve per arsye turistike dhe perisazhstike
- 2. Ndertimi i moltit dhe përcaktimi i itinerarit të lundrimit


ITINERARET KEMBESORE

- 1. Krijimi i nje rrjeti rruges kembesore qe lidhin zonat urbane dhe ekonomike, me potencialet turistike dhe natyrore

- 1. Përfshirja e koridoreve kembesore ne itineraret turistike



Rrjeti Ekzistues i Zonave të Mbrojtura- Zona Ekologjike Emerald- dhe Tokave Bujqësore
 Existing Network of Protected Areas- Emerald Areas- and Agricultural Lands



Zgjerimi dhe Konsolidimi i Zonave të Mbrojtura dhe Ekologjike Emerald; Koridoret e Gjelbërta.
 Extension and Consolidation of Green & Emerald Areas; Green Corridors.

Koridoret e Gjelbërta, Raste “Zoom In”

Për të shpjeguar më mirë dhe me më shumë detaje këtë strategji rrjetesh dhe korridoresh, janë përpunuar dy raste studimi:

- I pari është “Korridori Natyral i Alpeve Shqiptare” dhe lidhja e “Parkut të tri kombeve” me zhvillimin poli-centrik midis Shkodrës-Podgoricës-Kukësit-Prizrenit. Ky është një shembull sesi potencialet hidrografike, parqet kombëtare dhe sistemet natyrore mund të punojnë së bashku si një rrjet i gjelbërt i qëndrueshëm. Ky rrjet siguron gjithashtu kushte më të mira për lëvizje të lirë përmes përmirësimit të infrastrukturës, integron korridoret ekonomike në rajon pa dëmtuar potencialet natyrore dhe promovon zhvillimin e ekoturizmit dhe pejzazhit natyror.


- Rasti i dytë është ai i hapësirës midis Shqipërisë jugore dhe Greqisë veri-perëndimore, ku korridori natyral dhe historik i Ali Pashës midis Tepelenës, Gjirokastrës dhe Janinës mund të jetë një stimul i fortë ekonomik dhe turistik për rajonin mes parkut të Vikos, Hotovës, Labërisë dhe Butrintit.

Green Corridors, “Zoom In” cases


In order to explain better and in more details such strategy of networks and corridors, two case studies were elaborated:

- The first case is the Albanian Alps Natural Corridor and the relation of the Park of three nations with the in-between Shkodra-Podgorica and Kukës-Prizren polycentric developments. This is an example of how hydrographic potentials, national parks and protected areas of three countries can be part of one natural system and work together as a sustainable green network. This network provides also better conditions for free movement through the improvement of infrastructure, integrates economic corridors on the region without harming the natural potentials and promotes the development of eco-tourism and landscaping.

- The second case is that of the space between southern Albania and north-western Greece, where the natural and historic corridor of Ali Pasha between Tepelena, Gjirokastra and Ioannina could be a strong economic and touristic incentive for the region between the natural parks of Vikos, Hotova, Labëria and Butrinti.



Rrjeti i Koridoreve të Gjelbërta për Rajonin Verior Shqipëtar.
Green Corridors Network for the Northern Region of Albania.




Rrjeti i Koridoreve të Gjelbërta për Rajonin Jugor Shqipëtar.
Green Corridors Network for the Southern Region of Albania.

4.5.5 Shqipëria 2030, një Vizion Hapësinor për Shqipërinë

“Shqipëria 2030” tenton të përshkruajë politikat e zhvillimit për 15 vitet e ardhshme, bazuar në skenarin e zhvillimit të katër shtyllave kryesore ekonomike: (i) turizmi, (ii) bujqësia, (iii) energjia, (iv) dhe industria minerare. Kjo arrihet duke marrë në konsideratë instrumenta të ndryshme hapësinore, që përfshijnë:

- Kontrollimin e rritjes së qendrave urbane kundër shpërhapjes dhe informalitetit, duke konsoliduar zonat e urbanizuara, rajonet metropolitane dhe qendrat urbane komplementare;
- Identifikimin e zonave prioritare industriale dhe ekonomike, për të mbështetur punësimin dhe rritjen ekonomike;
- Rritjen e konkurrencës rajonale të shtetit duke forcuar nyjet kombëtare, rrjetet kombëtare dhe rajonale dhe portat rajonale;
- Identifikimin dhe përbushjen e rëndësisë kombëtare dhe rajonale të rrugëve, porteve detare, aeroporteve dhe energjisë;
- Identifikimin e 6 rajoneve kryesore të vendit, të cilat janë specializuar bazuar në burimet e tyre socio-ekonomike;
- Identifikimin dhe forcimin e rajoneve policentrike dhe ndërkufitare, polet e zhvillimit dhe zonat e ekonomisë së lirë, duke synuar vendosjen e një modeli të ri ekonomik të bazuar në një balancim më të mirë dhe që korrigjon efektet e urbanizimit radikal, pabarazitë dhe izolimin;
- Njohjen dhe kultivimin e potencialeve të mëdha të vendit në lidhje me peizazhin, itineraret historike dhe natyrore, ekoturizmin, etj;
- Përbushjen e pikësnyimeve të zhvillimit kombëtar duke marrë në konsideratë të veçantë territoret fqinje shqip-folëse, si dhe duke u koordinuar me Ballkanin perëndimor dhe rajonin e detit Adriatik, duke mos harruar procesin e integritimit në BE;
- Përmirësimin e efikasitetit socio-ekonomik dhe efektivitetin duke siguruar akses të integruar dhe të parbartë midis qendrës dhe periferisë, bazuar në një sistem unazor radial. Duke arritur kështu një objektiv të rëndësishme, duke e transformuar Shqipërinë nga një ekonomi e izoluar, në një aktor rajonal dhe europian të ekonomisë.





Bujqësia, Masivi Qëndror Malor dhe Polet e Zhvillimit.
Agriculture, Mountains and Growth Poles.

4.5.5 Albania 2030, a Spatial Vision for Albania


Albania 2030 describes the development policies for the coming 15 years, based on the growth scenario of the four main economic pillars: tourism, agriculture, energy and mining. This is achieved by taking in consideration several spatial instruments, including:

- Controlling the growth of urban centers against sprawl and informality, by consolidating urbanized areas, metropolitan regions and complementary urban centers;
- Identification of industrial and economic priority areas to support employment and economic growth;
- Increasing the regional competitiveness of the country by strengthening the international hub, national and regional networks and regional gateways;
- Identification and completion of national and regional importance infrastructure of roads, sea ports, airports and energy;
- Identification of 6 main regions, which are specialized based on their social-economic resources;
- Identification and strengthening of polycentric and cross border regions, growth poles and free economic areas, aiming to establish a new economic model which is based on a better regional balance and corrects the effects of radical urbanization, disparities and segregation;
- A special focus on environmental issues and sustainable development by identifying projects of hotspots rehabilitation, protection of forestry and green space, extension and consolidation of “green Albania”;
- Recognition and cultivation of the big potentials of the country as regarding landscaping, historical and natural routes, eco-tourism etc.;
- Achieving national development goals by considering with special importance the neighboring Albanian speaking territories as well as coordinating with western Balkans and Adriatic sea region, not forgetting the process of EU integration;
- Improving the social-economic efficiency and effectiveness by providing integrated and equal access between the center and periphery based on a ring radial system. Therefore achieving an important objective, transforming Albania from an isolated economy, on a regional and European actor of economy.



Rrjeti i Lidhjeve para viteve '90-të; Rrjeti i Lidhjeve sipas Vizionit të Shqipëria 2030.
Connectivity before '90s; Connectivity according to Albania 2030 Vision.

ALBANIA 2030, NATIONAL SPATIAL DEVELOPMENT VISION / VIZIONI I ZHVILLIMIT KOMBËTAR HAPËSINOR



KAPITULLI 5: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për më shumë se 2 dekada Shqipëria ka ndryshuar nga një shoqëri ekstremisht e planifikuar, në një prej ekonomive më liberale të Europës. Kjo ka gjeneruar energji pozitive, por ka krijuar edhe mjaft probleme dhe efekte negative, përfshi urbanizimin agresiv, informalitetin masiv, ndotjen e mjedisit, ineficencën e investimeve, etj.

Deri më tani reformat e planifikimit kanë qenë të fokusuar në nivelin urban, dhe nuk patur veprime konkrete për sa i takon politikave territoriale kombëtare të planifikimit dhe zhvillimit hapësinor. Por ndërsa Shqipëria i ka hyrë procesit të integritit të plotë në BE, kjo situatë shkon ndesh me orientimet e ESDP (European Spatial Development Program) dhe ESPON (European Spatial Planning Observation Network). Në këtë mënyrë shumica e problemeve të krijuara gjatë kësaj periudhe, mund të adresohen nën autoritetin e politikave kombëtare dhe planifikimit hapësinor kombëtar.

Me qëllim që të ndryshojë situata, autoritetet duhet urgjentisht të fillojnë një proces për të ushtruar kompetencën e dizenjimit dhe miratimit të një "Plani Hapësinor Kombëtar Zhvillimi" dhe një "Dokument Politikash", por për të ndërmarrë këtë hap atyre u duhet një metodologji, mjete e teknika, si dhe ekspertizë. Ky dokument kërkimor përpiqet të japë një kontribut paraprak që mund të ndihmojë në këtë drejtim.

Gjetjet dhe rezultatet e këtij kërkimi mund t'u shërbejnë institucioneve publike e private të interesuara rreth kësaj teme për të hapur një debat e për të demistifikuar mungesën e eksperiencës dhe njohurive. Përmes kësaj pune autoritetet mund të kuptojnë më mirë:

- Çfarë është planifikimi hapësinor?
- Cilat janë mjetet teknike dhe grafike për të përgatitur një plan hapësinor?
- Cilat janë disa nga idetë dhe inspirimet e para fillestare për të zhvilluar një plan të tillë për Shqipërinë?

Natyrisht një plan kombëtar hapësinor dhe një dokument politikash do të kishin nevojë për një konsensus të gjerë dhe një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të sa më shumë aktorëve. Për këtë qëllim qeverisë i duhet patjetër të ndërtojë një sistem kombëtar gjeografik informacioni (GIS), duke kombinuar të dhëna topografike nga fotografitë ajrore, me të dhënat statistikore të INSTAT. Përmes kësaj, mund të hartohen

CHAPTER 5: CONCLUSIONS AND RECOMMENDATIONS

For more than two decades Albania has changed from an extremely planned society to one of the most liberal economies of Europe. This has generated enough creative energy, but has also created a lot of problems and externalities, including radical urbanization, massive informality, environmental degradation, inefficiency of investments, etc.

So far planning reforms have been focused at urban-city level, and there has been no concrete actions as regarding national territorial policies of spatial planning and development. But as Albania has entered the final phase of EU integration, such situation goes against the guidelines and intentions of ESDP (European Spatial Development Program) and ESPON (European Spatial Planning Observation Network). At this point, most of the created problems so far can be addressed only under the authority of the national spatial planning and by policy instruments.

Aiming to change the situation, authorities must urgently address and initiate a process by exercising the competency of designing and approving a "National spatial development plan" and "Policy Document". But in order to undertake such step they need a methodology to base the work on, tools and techniques, as well as expertise. This research document tries to give a preliminary contribution that hopefully helps for this purpose.

The findings and results of this research can serve to the interests of public and private institutions, and can be used as a base to open a debate to demystify the lack of experience and knowledge. Through this research authorities might also reflect on question like:

- What does spatial planning mean?*
- Which are the technical and graphical tools in order to prepare a spatial plan?*
- Which are some of the first ideas and preliminary inspirations, in order to develop a specific spatial plan for Albania?*

Of course, such national spatial plan and policy document will need a broad consensus and wide participation of as many stakeholders possible. For this purpose the government needs to establish a national system

mjaft harta tematike, të cilat ndihmojnë për të kuptuar problemet reale dhe rekomandojnë zgjidhjet e nevojshme. Mbi këtë bazë institucionet e specializuara të planifikimit mund të zhvillojnë një plan kombëtar hapësinor për vendin.

Tani është koha që Shqipëria të lëvizë nga kuadri i zhvillimit hapësinor të trashëguar nga ekonomia e centralizuar që promovoi kulturën e vetë-izolimit, drejt një shoqërie të re, e cila është e hapur dhe konkurrese ndaj tregjeve rajonale dhe globale.

Ndaj nga një koncept i mbyllur (në formë 8 tete) i infrastrukturës kryesore të aksesit kombëtar, i cili karakterizonte vendin para viteve '90-të; vizioni hapësinor i zhvillimit në këtë studim promovon zhvendosjen drejt një sistemi radial-unazor, duke filluar nga rajoni i kryeqytetit drejt poleve të rritjes periferike dhe zonat ndërkufitare të interesave përkatëse.

I gjithë rrjeti i infrastrukturave dhe shërbimeve duhet të orientohet drejt një koncepti të tillë, ku radialet përmirësojnë lidhjet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe unazat rrisin efikasitetin dhe inkurajojnë prosperitetin ekonomik të territoreve shqip-folëse dhe ndërkufitare, brenda e jashtë territorit shtetëror.

Një rekomandim tjetër, është zbatimi i konceptit të 6 rajoneve administrative sipas modeleve të qarta social-ekonomike dhe me identitete të specializuara. Bazuar mbi këtë koncept:

- Rajonet e Voskopojës dhe ai Metropolitan do të jenë të fokusuar në infrastrukturën dhe shërbimet strategjike rajonale dhe ndërkombëtare;
- Rajonet e pjesës veriore dhe jugore të vendit do të fokusohen në zhvillimin e turizmit detar dhe malor;
- Ndërsa dy rajonet e tjera të mbetura do të përqendrohen në aktivitetet kryesore ekonomike, si bujqësia, industria minerare dhe energjitika.

Rekomandimi final është vetë “manifesti” dhe “harta finale” e vizionit kombëtar hapësinor “Shqipëria 2030”, e cila sjell për vendin një perspektivë të zhvillimit të paktën për 15 vitet e ardhshme.

- Kjo perspektivë duhet të promovojë një ekonomi të qëndrueshme, duke u bazuar në katër shtylla ekonomike: Bujqësi, Energji, Turizëm, Miniera, përmes aplikimit të instrumenteve të policentrizmit dhe poleve të zhvillimit;
- Ajo duhet të stimulojë përcaktimin e qartë dhe fuqizimin e korridoreve të specializuara ekonomike, natyrore dhe kulturore, si dhe të zonave të zhvillimit të lirë ekonomik, në funksion të rajonalizimit dhe zhvillimit rajonal;
- Zhvillimi infrastrukturor (rrugë, porte, aeroporte) duhet të balancohet me zhvillimin ekologjik, dhe të kompensohet me shtimin dhe konsolidimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura dhe ekologjike emerald, si dhe me krijimin e një rrjeti kombëtar të gjelbër, përmes një fushate kombëtare veprimi, për krijimin e një identiteti të ri kombëtar.

Një rekomandim final me rëndësi i Manifestit “Shqipëria 2030” për kërkim të mëtejshëm, është se shumica e praktikave të planifikimit hapësinor kombëtar bazohen zakonisht në skenare entuziaste (pozitive) zhvillimi, të cilat nuk janë domosdoshmërisht më realitet. Për më tepër vizione të tilla mund të jenë vërtetë inspiruese për të inkurajuar shoqërinë, por mund të jenë edhe jo realiste e të përealizueshme. Kjo mund të dëmtojë vetë reputacionin e instrumentit të planifikimit hapësinor kombëtar midis aktorëve të interesuar. Për këtë arsye, po pranohet gjithnjë e më shumë nga të gjithë se paralel me skenaret “pozitivë”, duhet zhvilluar edhe i ashtuquajtur “Skenari i Planit B”, ose një metodologji e planifikimit hapësinor kombëtar që bazohet tek “vlerësimi i rrisqeve” dhe “skenaret e shkatërrimit ose fatkeqësive në nivel global-rajonal”, si për shembull: ngrohja globale, rritja e nivelit të detit, përmblytjet, katastrofat sizmike, luftrat dhe destabilizimi social, epidemitë pandemike, etj. Kjo natyrisht është një tjetër fazë e kërkimit dhe politikë-bërjes

of geographic information (GIS), combining topographic data and aerial images, with the statistical data of INSTAT. Thanks to such combination thematic maps can be produced, and those can help to understand the real problems and recommend necessary solutions. On basis of that, the specialized planning institutions can develop a national spatial plan for the country.

Nowadays it is time that Albania moves ahead, away from the inherited spatial development framework of the centralized economy, which unfortunately promoted the culture of self-isolation and self-reliance. Instead, Albania must reposition itself towards a new society, which is open, complementary and competitive towards regional and global markets.

Therefore the country must break out of the closed infrastructural framework of the '80-s (an 8 “eight” shape network with Tirana in the center), towards a spatial development vision that shifts by promoting a ring-radial system, starting from the metropolitan region, towards growth poles of the country's periphery and cross-border regions of common interests with the neighbors.

All infrastructural and services network must also be orientated towards such concept: (i) where radials improve national and international connections; (ii) while rings increase efficiency and promote economic prosperity of the Albanian-speaking territories, within the Albanian territory and in the neighboring countries as well.

Another recommendation is the implementation of the concept of Co-PLAN with six administrative regions, according to clear social-economic models, and specialized identities. Based on this proposal:

- Voskopoja and Metropolitan regions – will be focused on strategic services and infrastructure of regional and international importance;
- Northern and Southern regions – will be focused on sea and mountainous tourism development;
- Last two remaining regions – will be concentrated on the main economic activities like: agriculture, mining industry, and energy.

The final recommendation is the “Manifesto” in itself and its main final conceptual map of “Albania 2030”. The vision brings a country perspective for at least 15-20 coming years.

- Such vision aims to promote a stable growing economy, based on 4 main economic pillars: agriculture, energy, tourism, and mining; by applying instruments of polycentrism and growth poles;
- It also stimulates clear determination and empowering of the specialized economic, natural and cultural corridors; as well as of the “free economic development areas”, in functional regionalism and regional redevelopment;
- Infrastructural development (roads, ports, airports) must be balanced under the “ecological development” concept, and compensated by the increased surfaces of green and emerald areas, creating a green network, throughout of a national action campaign that might help the creation of a new identity for Albania.

An important final recommendation of “Albania 2030” Manifesto for further research is based on the findings that most of the national spatial planning practices are usually based on positive (happy) development scenarios, which might not always be the case. Furthermore such visions could be good to push society move ahead with enthusiasm, but often are not too realistic. This could harm seriously the usefulness and trust of stakeholders over such important planning instrument. For this reason, actually it is becoming quite acceptable, that parallel with positive development scenarios, we must also develop the so called “Plan B Scenario”, or the national spatial planning methodologies based on “risks assessment” and “global-regional disaster scenarios”, such as: global warming, increase of sea level; flooding, seismic activities, wars, de-stability and infective pandemics etc. This is for sure another stage of research and policy making for Albania, but “Albania

nga sot, por Manifesti "Shqipëria 2030" ilustron këtë gjë me një shembull të thjeshtë të pasojave dhe vendimeve politike në rastin e një situatë të kombinuar efektsh negative të përmbytjes për shkak të ngritjes së nivelit të detit, hapjes së portave të hidrocentraleve në veri të vendit, dhe motit të keq me reshje. Plani parashikon në këtë rast: (i) investime për ndërtimin e sistemit të digave që mbrojnë tokat bujqësore të ultësirës perëndimorë; (ii) ngritjen e një sistemi robotik sinjalizuesish në rast emergjence gjë që jo vetëm ndihmon autoritetet në Tiranë që të ndërmarrin vendimet e duhura në kohë, por gjithashtu ndërmer veprime e misione konkrete të shpëtimit të jetës ndaj popullsisë lokale në rrezik.

"2030" provides on this stage a simple example of the consequences and policy decisions in the case of combined negative effects of flooding from sea level increase, opening of gates of the power stations in the north of Albania, and also from the bad weather and heavy. The Manifesto foresees: (i) investments in building dams to protect western agricultural lands and urbanized areas; (ii) the establishment of robotic emergency signaling systems, which do not only help decision makers take decisions in time, but also undertakes life saving missions to help local population.

Vlerësimi i Rreziqeve: Ngrohja Globale, Ngritja e Nivelit të Ujërave dhe Përmbytjet
Risk Assessment: Global Warming, Rising Water Levels and Flooding
D. Buza, I. Tavanzhiu, A. Di Raimo, Polis University, 2014

ALBANIA 2030 — NGROHJA GLOBALE: NGRITJA E NIVELIT TË UJRAVE DHE PËRMBYTJET

Ngrohja Globale është rritja e temperaturës mesatare të atmosferës, oqeanëve dhe mbulesës së Tokës. Planeti është ngrohur dhe ftohur shumë herë gjatë 4.65 miliardë vjetëve të vet. Një nga dukuritë që vjen si rrjedhim i ngrohjes globale është dhe PËRMBYTJET.

Shkak: - shkërrirja e akullnajave
- çrregullimet e rreshjeve në periudha të caktuara të vitit

Çfarë janë PËRMBYTJET?

Përmbytjet janë rreziku më i zakonshëm mjedisor në të gjithë botën, pas sëmundjeve dhe aksidenteve automobilistike.


Përse ndodhin?
Për shkak të përhapjes gjeografike të gjërë të fushave lymore (që përmbyten) dhe brigjeve detare të ulëta.

Tërheqjes së njerzve për krijimin e qendrave të banimit pranë tyre.
Shkalla e rrezikshmërisë nga përmbytjet varet nga:
- Thellësia dhe shpejtësia e ujit
- Kohëzgjatja e përmbytjes
- Prurjet e ngurta (sedimente, kripëra, mbeturina, kimikate) të mbaritura.
- Ndërtimeve informale


SIMULIMET KOMBETARE

KUFIRI I ZONAVE TË PËRMBYTURA TE SHOPIRISË (1-5m) zonat e impaktuara

Rishti okultore të rreziqeve dhe rritja e nivelit të lumenjve do të bëjnë përmbytjet në të rëndë. Në 2000, përkatësisht rritja e nivelit të detit do të masë 30-40 cm, duke përmbytur këthu komplet zonën bregdetare.




SI ndodhin dukuritë?







IMAZHE DHE IDE PER QENDREN E NDERHYRJES SE SHPEJT



STRATEGJIA KOMBETARE





Detajimi i Planit Hapësinor në Rastin e një Koridori Infrastrukturore Rrugor (Rruga e Kombit)
Detailing of the Spatial Plan of a Specific Road Infrastructure Corridor (Road of Nation)
E. Janku, B. Aliaj, Polis University, 2012



UNIQUE LANDSCAPE



INDUSTRIAL HERITAGE



TRADITIONAL HOUSES



BAR-RESTAURANTS



FOLK COSTUMES



PEJSAZH UNIK



DIZAJN- STIL



RESORTE



RESTORANT-KARBURANT



MENYRE JETESE

REFERENCAT / REFERENCES

1. Aliaj, B.; Shutina, D.; Dharmo, S. (2010): "Between Energy and the Vacuum: Co-PLAN and Urban Planning in Albania", Tirana, Albania.
2. Aliaj, B. (2008): "Misteri i Gjashtë: Cili është kurthi që mban peng zhvillimin dhe integrimin e ekonomisë shqiptare me botën moderne?", Tirana, Albania.
3. Aliaj, B. (2004): "Albania, a short history of housing and urban development models during 1945-1990", "Making Cities Work", Tirana, Albania.
4. Alterman, R. (2001): "National-Level Planning in Democratic Countries: An International Comparison of City and Regional Policy-making", Liverpool University Press, Liverpool.
5. Belhedi, A. (2005): "Epistemologie de la géographie: La chorématique", Tunis. (<http://epigeo.voila.net/chorématique.htm>)
6. Communities and Local Government (2006): "The Role and Scope of Spatial Planning: Literature Review".
7. Commission of the European Communities- CEC (1999): "Report on Community Policies and Spatial Planning. Working Document of the Commission Services", Brussels: European Commission.
8. Corner, J. (1999) "Recovering Landscape, Essays in Contemporary Landscape Architecture", Princeton University Press, New York, USA.
9. CPG / Editorial Group (2006): "The Territorial State and Perspective of the European Union Document: Towards a Stronger European Territorial Cohesion in the Light of the Lisbon and Gothenburg Ambitions", Brussels, Belgium.
10. Department of Arts, Heritage and the Gaeltacht (2011): "A National Landscape Strategy for Ireland".
11. Çobo, E.; Toto, R. (2010): "Planifikimi i territorit- Nga ligji në reformë", "Politikndjekës apo Politikbërës 1: Alternativa mbi zhvillimin urban, manaxhimin e territorit dhe të mjedisit", Polis Press, Co-plan, Tirana.
12. Toto, R. (2012): "Raport i Situatës së Planifikimit të Territorit në Shqipëri", "Politikndjekës apo Politikbërës 2: Analiza dhe Rekomandime për qeverisjen territoriale në Shqipëri", Polis Press, Co-plan, Tirana, Albania.
13. Dühr, S. (2007) "The Visual Language of Spatial Planning: exploring cartographic representations for Spatial Planning in Europe".
14. European Commission (1997): "Compendium of European planning systems. Regional Development Studies", Report 28, Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg.
15. European Commission (1997): "Compendium of European Spatial Planning".
16. ESPON (2011): "Nordic- Baltic ESPON Conference for Planners and Policy-makers: Transnational perspectives on spatial planning- Experiences from the Nordic- Baltic countries", Stockholm, Sweden.
17. Faludi, A. (2010): "Cohesion, Coherence, Cooperation: European Spatial Planning Coming of Age?".
18. Faludi, A. (2010): "The Performance of Spatial Planning, Planning Practice & Research".
19. Forman, R.T (2008): "Urban Regions. Ecology and Planning Beyond the City", Cambridge University Press, Cambridge.c
20. GCSP- Geneva Center for Security Policy (2006): "Program on the Geopolitical Implications of Globalization and Transnational Security: Definitions of Globalization, a Comprehensive Overview and a Proposed Definition".
21. Kuzmann, K.R (1996): "Euro-megalopolis or themepark Europe? Scenarios for European Spatial Development", International Planning Studies.
22. McHarg, Ian L. (1969): "Design with nature", (Wiley Series in Sustainable Design).
23. Ministeries van VROM, LNV, VenW, EZ en OCW (2006): "Nota Ruimte en de Uitvoeringsagenda Ruimte", The Netherlands.
24. Ministry of Infrastructure and the Environment (2012): "35 Icons of the Dutch Spatial Planning", The Hague.
25. Ministry of Infrastructure and the Environment (2011): "Summary National Policy Strategy for Infrastructure and Spatial Planning: Making the Netherlands competitive, accessible, livable and safe", The Hague, The Netherlands.
26. Özkan, Ö. (2008): "Strategic Way of Design in Rem Koolhaas' Parc de la Villette Project", Middle East Technological University.
27. PLUREL (2010): "National Spatial Planning Policies and Governance Typology", Report.
28. Rodrigue, J.P.; Comtois, C.; Slack, B. (2013) "The Geography of Transport System", Third Edition, New York, USA.
29. UNECE (2008): "Spatial Planning- Key Instrument for Development and Effective Governance with Special Reference to Countries in Transition", Report ECE/HBP/146, Geneva, Switzerland.
30. UNDP; ILD Peru; Government of Albania (2007): "Albania: transition to the rule of law and inclusive market economy", Lima, Peru.
31. Vincent Nadin, Dominic Stead (2008): "European Spatial Planning Systems, Social Models and Learning", Delft University of Technology, The Netherlands.
32. Waldheim, C. (2006): "The Landscape Urbanism Reader", Princeton University Press, New York, USA.
33. Waterhout, B. (2008): "The Institutionalization of European Spatial Planning", PHD Thesis, TU Delft, The Netherlands.
34. Wilbanks, T. (2007): "The Research Component of the Community and Regional Resilience Initiative (CARRI)", Presentation at the Natural Hazards Center, University of Colorado-Boulder.
35. Zepf M.; Andres L. (2011): "New articulations and new challenges in spatial planning".



ISBN: 978-9928-175-45-8